

Dr. Migena Kapllani

Letërsia me zgjedhje 12 Udhëzues për mësuesin

Shtëpia Botuese & Shtypshkronja FILARA
Tiranë, 2018



2018

BOTIME SHKOLLORE



Titulli i librit:

LETËRSIA ME ZGJEDHJE12
UDHËZUES PËR MËSUESIN

Autorë:

Dr. Migena Kapllani

Korrektor:

Ekleva Progonati

Arti grafik:

Studio grafike **FILARA**

Punoi:

Gazmir Myteberi

Botimi i parë FILARA

Tiranë, 2018

© Shtëpia Botuese, **FILARA**

Shtypur në shtypshkronjën **FILARA**

Adresa:

Rruga "Sabaudin Gabrani"
Ish - kombinati "Misto Mame" Tiranë

Tel: 04 225 88 01

Cel: 069 33 30 983

Cel: 069 66 99 693

E-mail: filarabotime@yahoo.com

website: www.filarabotime.com

Librin e mësuesit, planin mësimor mund
ta shkarkoni në formatin Word, PDF
falas nga faqja jonë e internetit
www.filarabotime.com

**Letërsia me zgjedhje12
Udhëzues për mësuesin**

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
I. Përmbajtja tematike e tekstit - Letërsia me zgjedhje 12	5
II. Plani mësimor analitik vjetor	7
III. Plani sintetik sipas tremujorëve	8
IV. Plani tematik	
• Tremujori i parë	9
• Tremujori i dytë	11
• Tremujori i tretë	13
V. Modele të planifikimit ditor dhe modele testesh përmbledhëse	
• Tremujori i parë	15
• Model testi përmbledhës. Tremujori i parë	48
• Tremujori i dytë	53
• Model testi përmbledhës. Tremujori i parë	86
• Tremujori i tretë	91
• Model testi përmbledhës. Tremujori i parë	116

NDËRTIMI DHE VLERËSIMI I PORTOFOLIT TË TË NXËNIT

Udhëzues metodik në ndihmë të mësuesve për zhvillimin e procesit mësimor në lëndën e Letërsisë me zgjedhje 12

Parathënie

Të nderuar kolegë,

libri që po ju paraqitet nuk është një libër mësuesi, ashtu siç përdoret zakonisht në gjuhën profesionale. Në kohën e sotme, kur konkurrenca e tregut ka nxitur shtëpitë botuese të hedhin në treg së bashku me tekstin mësuesor për nxënësit edhe tekstin për mësuesin, nuk është e vështirë të gesh metodika dhe libra udhëzues gjithandej.

Me të drejtë mësuesi i ndodhur në një “vërshim” të tillë të informacionit mund të gjendet i hutuar. Pyetjes se cila prej këtyre metodikave është më e përshtatshme, ai nuk mund t’i përgjigjet lehtë. Teksti mësuesor që keni në duar dhe shoqëruesi i tij, “Udhëzues metodik” nuk synojnë të japin të gjitha përgjigjet për pyetjet dhe problemet që dalin në orën e mësimit.

Procesi i të nxënësit është sa dinamik, aq edhe i paparashikuar, sa i ngjashëm, aq edhe i ndërlikuar. Për këtë arsye nuk mund të quhet një “libër mësuesi”. Ai është vetëm një udhërrëfyes i hartuar nga një prej kolegëve tuaj, që me punën disaveje në mësimit dhe letërsisë, ka arritur të grumbullojë një përvojë të cilën dëshiroj ta ndajmë së bashku. Askush nuk mund të mëtojë se zotëron dijen e mjaftueshme apo ka përvojën e nevojshme për t’u dhënë të tjerëve “mësime” apo se si të bëjnë një orë mësimi. As qëllimi nuk është ky. Lidhur me këtë do të përmendja një thënie të Carl Rogers: **“Unë nuk besoj që dikush do t’i ketë mësuar ndonjëherë diçka dikujt tjetër. Dëshoj në vlerën e mësimit dhe mësimit. E vetmja gjë që di, është se kush do të mësojë, mëson. Një mësues i mirë, të shumtën, mund të jetë dikush që t’i bën më të lehta gjërat, është ai që e mbush tavolinën dhe u provon të tjerëve se është tërheqëse, nxitëse, e mrekullueshme; dhe i fton të hanë.”**

Libri përmban planin sintetik vjetor të lëndës, modelin e një plani vjetor të lëndës ndërtuar mbi bazën e udhëzimeve dhe trajnimeve të zhvilluara nga MASR, si dhe disa modele mësimore dhe teknika që do t’u vijnë në ndihmë mësuesve të rinj që e kanë nisur punën e bukur të mësimit duke zgjedhur një lëndë që përbën një prej shtyllave formuese të brezit të ri.

Mësuesit me përvojë do të gjejnë në këtë libër një ndërthurje të tradicionales me bashkëkohoren në procesin e të nxënësit; një shkrirje të përvojave më të mira të krijuara nga tradita jonë mësimore me përvojat e vendeve të ndryshme. Do të gjejnë diçka nga puna e tyre, përvojat e tyre të materializuara në një libër.

Përmes këtij udhërrëfyesi do t’u modelohen disa orë mësimi sipas nismës së re “Tre lëndë në gjashtë orë”, duke ndihmuar në organizimin e procesit të të nxënësit në 90 minuta.

Brezat e së ardhmes duhen edukuar me ndjenjën e dashurisë për të mësuarit, ata duhet të kenë interesa të gjithanshme dhe të kenë dëshirë të ushqejnë mendjen e tyre gjatë gjithë jetës. Platoni e ka thënë një gjë të tillë në mënyrë të shkëlqyer: **“Qëllimi i edukimit është ta bëjë individin të dojë të bëjë atë që ai duhet të bëjë.”**

Shpresojmë se së bashku do të arrijmë qëllimin, i cili shprehet në ato faqe të tekstit të nxënësit dhe është pjesë e strategjisë së arsimit në vendin tonë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Me respekt autori!

Maj, 2018

I. Përmbajtja tematike e tekstit - Letërsia me zgjedhje 12

FOLKLORI DHE FOLKLORISTIKA SHQIPTARE

1. Folklori dhe rëndësia e studimit të folklorit
2. Folkloristika shqiptare

Ndikimi i shkrimtarëve

1. **Jeronim de Rada** - *Këngët e Milosaos*
 - Studim teksti - "Takimi i të rinjve"
2. **Gavril Dara (I Riu)** - *Kënga e sprasme e Balës*
 - Studim teksti - "Kënga e Beratit"
3. **Naim Frashëri** - *Bukuria*
 - Studim teksti - "Bukuria"

Lirika popullore

1. **Ninullat dhe zakonet e lindjes**
 - Studim teksti - "Ninullë"
2. **Zakonet dhe këngët e dasmës**
 - Studim teksti - "Këngë dasme"
3. **Ritet dhe këngët e motmotit**
4. **Këngët e Dashurisë** (Dashuria në poezinë popullore)
5. **Këngët e Dashurisë** (Kulti i dashurisë dhe kultit të bukurisë)
 - Studim teksti - Lirikë erotike popullore

Ndikimi i shkrimtarëve

1. **Lasgush Poradeci** - *Lirika e dashurisë*
 - Studim teksti - "Kroi i fshatit tonë" ose studime teksti - "Baladë"
2. **Dritëro Agolli** - *Lirika*
 - Studim teksti 1 - "I përndjekuri i dashurisë"
 - Studim teksti 2 - "Poemë për babanë dhe për vete"

Lirika popullore

6. Këngët e vajit

Ndikimi i shkrimtarëve

1. **Andon Zako Çajupi** - *Lirika e dashurisë te Çajupi*
 - Studim teksti 1 - "Dashuria"
 - Studim teksti 2 - "Vaje"

Lirika popullore

7. Këngët e lirikës shoqërore

Epika popullore

1. **Epika heroike legjendare**
 - Studim teksti - "Kënga e kalasë"
2. **Këngët legjendare të rinjohjes** - *Rinjohja e burrit me gruan*
 - Studim teksti - "Ymer Aga"

3. Këngët legjendare të rinjohjes - *Rinjohja e vëllait me motrën*

- Studim teksti - “Kënga e Gjon Pretika”

4. Këngët legjendare të vëllait të vogël

- Studim teksti - “Kostandini e Dhoqina”

Ndikimi i shkrimtarëve

1. Ismail Kadare - *Kush e solli Doruntinën*

- Studim teksti 1 - “Kush e solli Doruntinën” (kapitulli I)
- Studim teksti 1 - “Kush e solli Doruntinën” (kapitulli VI)

Epika popullore

5. Cikli i Kreshnikëve - Muji dhe Halili

- Studim teksti 1 - “Martesa e Mujit”
- Studim teksti 2 - “Ajkuna qan Omerin”
- Studim teksti 3 - “Gjergj Elez Alia”

6. Cikli i Kreshnikëve dhe origjinaliteti i tij

Ndikimi i shkrimtarëve

1. Gjergj Fishta - *Lahuta e Malcisë*

- Studim teksti 1 - Kënga VIII - “Ali Pashë Gucia”

Epika popullore

7. Epika historike

Proza popullore

1. Llojet e dhe përmbajtja e përrallave**2. Arti dhe vlera e përrallave**

- Studim teksti - “Valltarja me fustanellë”

Ndikimi i shkrimtarëve

1. Mitrush Kuteli - *Rrëfimet dhe rrëfenjat*

- Studim teksti 1 - “Rinë-Katerinëza”
- Studim teksti 2 - “Furrxhiu i hapsanikëve”

2. Ernest Koliqi - *Moderniteti i prozës së Ernest Koliqit*

- Studim teksti 1 - “Nusja e mrekullueshme”
- Studim teksti 2 - “Kërcimtarja e Dukagjinit”

3. Lumo Skëndo (Mit’hat Frashëri)

- Studim teksti - “Plaku i Ylynecit”

4. Martin Camaj - *Poetika e Martin Camajt*

- Studim teksti 1 - “Elegji e parë”
- Studim teksti 2 - “Dranja”

Proza popullore

2. Proverbat dhe gjëgjëzat**3. Folklori dhe e qeshura**

II. Plani mësimor analitik vjetor - Letërsia me zgjedhje 12

34 javë x 2 orë/javë = 68 orë

4 orë - Folkloristika

2 orë - Folklori dhe rëndësia e tij

2 orë - Folkloristika

14 orë - Lirika popullore

2 orë - Ninullat dhe zakonet e lindjes

2 orë - Zakonet dhe këngët e dasmës

2 orë - Ritet dhe këngët e motmotit

6 orë - Këngët e dashurisë

2 orë - Këngët e vajit

11 orë - Epika popullore

6 orë - Këngët legjendare

4 orë - Cikli i Kreshnikëve

1 orë - Epika historike

5 orë - Proza popullore

2 orë - Llojet dhe përmbajtja e përrallave

1 orë - Vlerat dhe rëndësia e përrallave

1 orë - Proverbat dhe gjëgjëzat

1 orë - Folklori dhe e qeshura

18 orë - Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori1 orë - *Jeronim de Rada* - Këngët e Milosaos2 orë - *Gavril Dara* - Këngët e Sprasme e Balës1 orë - *Naim Frashëri* - Bukuria1 orë - *Lasgush Poradeci* - Lirika e dashurisë2 orë - *Dritëro Agolli* - Lirika2 orë - *Andon Zako Çajupi* - Vajet dhe Dashuria2 orë - *Ismail Kadare* - Kush e sollti Doruntinën1 orë - *Gjergj Fishta* - Lahuta e Malcisë2 orë - *Mitrush Kuteli* - Rrëfimet dhe Rrëfenjat2 orë - *Ernest Koliqi* - Moderniteti i prozës së Ernest Koliqit1 orë - *Lumo Skëndo* - Plaku u Ylynecit1 orë - *Martin Camaj* - Dranja

1 orë - Përsëritje e njohurive

2 orë - Ese/ Shkrim hulumtues

3 orë - Dramatizime

4 orë - Projekte lëndore

3 orë - Vlerësim i njohurive

3 orë - Punë me portofolin

PLANI SINTETIK SIPAS TREMUJORËVE

	NJOHURI TË REJA	PËRPUNIM NJOHURISH						ORË GJITHSEJ (njohuri të reja+përpunim njothurish)
		Përsëritje e njohurive	Punë me portofolin	Vlerësim	Punë kërkimore / Ese	Projekt lëndor		
Tremujori i parë	20 orë	0 orë	1 orë	1 orë	1 orë	1 orë	24 orë	
Tremujori i dytë	19 orë	1 orë	1 orë	1 orë	2 orë	0 orë	24 orë	
Tremujori i tretë	14 orë	1 orë	1 orë	1 orë	1 orë	2 orë	20 orë	
Gjithsej	53 orë	2 orë	3 orë	3 orë	4 orë	3 orë	68 orë	

PLANI TEMATIK – TREMUJORI I PARË

NR.	LLOJI I TEMËS	LINJA	TEMA MËSIMORE	SITUATAT E TË NXËNIT	KOMPETENCAT	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
1.	Njohuri të reja	Folklori dhe folkloristika	Folklori dhe rëndësia e studimit të folklorit	Bashkëbisedim: Çështje folklori?	Të folurit; Të dëgjuarit	Teskti mësimor dhe materiale të tjera folklorike
2.	Njohuri të reja		Folklori dhe rëndësia e studimit të folklorit			
3.	Njohuri të reja		Folkloristika shqiptare	Bashkëbisedim: Studimi dhe mbledhja e folklorit	Të folurit; Të shkruarit	Teskti mësimor dhe materiale të tjera folklorike
4.	Njohuri të reja		Folkloristika shqiptare			
5.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Jeronim de Rada – Këngët e Milosaos Studim teksti: Takimi i të rinjve	Analizë: Rilindja Shqiptare dhe ndikimi nga folklori	Të folurit; Të dëgjuarit	Teskti mësimor dhe “Këngët e Milosaos”
6.	Përpunim i njohurive		Punë me portofolin – 1	Vlerësimi dhe Vetëvlerësimi	Të folurit; Të shkruarit	Portofoli vetjak dhe detyrat.
7.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Gavril Dara – Kënga e Sprasme e Balës Analizë e veprës	Analizë – Koment: Heroi lirik i romantizmit shqiptar dhe ndikimi i tij nga këngët epike folklorike	Të folurit; Të shkruarit	Teskti mësimor dhe “Kënga e sprasme e Balës”
8.	Njohuri të reja		Gavril Dara – Kënga e Sprasme e Balës Studim teksti: Kënga e Beratit			
9.	Përpunim i njohurive	Shkrimi hulumtues/ Ese	Shkruani një shkrim hulumtues rreth këtyre ngjashmërive dhe ndikimit të zakoneve dhe kulturës popullore, sidomos asaj arbëreshe në veprat “Këngët e Milosaos” dhe “Kënga e sprasme e Balës”.		Të shkruarit; Të dëgjuarit	Teskti mësimor
10.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Naim Frashëri – Bukuria	Analizë – Koment: Lirika erotike e Naim Frashërit dhe ndikimi nga folklori	Të shkruarit; Të dëgjuarit	Teskti mësimor dhe materiale të tjera
11.	Njohuri të reja	Lirika popullore	Ninullat dhe zakonet e lindjes	Bashkëbisedim: <i>Ninullat dhe këngët e djepit</i>	Të shkruarit; Të dëgjuarit	Teskti mësimor dhe materiale të tjera
12.	Njohuri të reja		Ninullat dhe zakonet e lindjes			

13.	Njohuri të reja		Zakonet dhe këngët e dasmës	Bashkëbisedim: <i>Dasma dhe zakonet e saj</i>	Të folurit; Të dëgjuarit	Materiale nga nxënëxhit Teksti mësimor
14.	Njohuri të reja		Zakonet dhe këngët e dasmës			
15.	Njohuri të reja		Ritet dhe këngët e motmotit	Bashkëbisedim: <i>Ritet dhe këngët e motmotit</i>	Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera.
16.	Njohuri të reja		Ritet dhe këngët e motmotit			
17.	Përpunim i njohurive	Projekt lëndor	Karnavalet e shkollës – Paraqitja e projektit dhe ndarja e detyrave	Diskutim rreth tematikës së projektit dhe zhvillimit të tij.	Të folurit; Të dëgjuarit	Materiale nga nxënëxhit Teksti mësimor
18.	Njohuri të reja	Lirika popullore	Këngët e dashurisë	Bashkëbisedim: <i>Dashuria në poezinë popullore</i>	Të folurit; Të dëgjuarit	Teksti mësimor
19.	Njohuri të reja		Këngët e dashurisë			
20.	Njohuri të reja		Këngët e dashurisë	Koment – Analizë: <i>Kulti i dashurisë dhe i bukuri në poezinë popullore</i>	Të folurit; Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera
21.	Njohuri të reja		Këngët e dashurisë			
22.	Njohuri të reja		Studim teksti: Lirika erotike popullore	Diskutim: <i>Lirika e dashurisë</i>	Të folurit; Të shkruarit Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera
23.	Njohuri të reja		Studim teksti: Lirika erotike popullore			
24.	Përpunim i njohurive		Vlerësim i njohurive – 1	Testim me shkrim	Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera

PLANI TEMATIK – TREMUJORI I DYTË

NR.	LLOJI I TEMËS	LINJA	TEMA MËSIMORE	SITUATAT E TË NXËNIT	KOMPETENCAT	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
1.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Lasgush Poradeci – Lirika erotike Studim teksti: <i>Kroj i fshatit tonë ose Baladë</i>	Analizë: <i>Ndikimi i folklorit në krijimtarinë e Poradecit</i>	Të folurit; Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe poezi nga Lasgush Poradeci
2.	Njohuri të reja		Dritëro Agolli – Lirika Studim teksti 1 – I përmjekuri i dashurisë	Analizë-Koment: <i>Ndikimi i krijimtarisë popullore në lirikën e Dritëro Agollit dhe elementet e saj.</i>	Të folurit; Të dëgjuarit Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga krijimtaria e D. Agollit
3.	Njohuri të reja		Dritëro Agolli – Lirika Studim teksti 2 – Poemë për babanë dhe për vete			

4.	Njohuri të reja	Lirika popullore	Këngët e vajtit	Bashkëbisedim: <i>Koncepti për vdekjen në traditën popullore</i>	Të folurit; Të shkruarit të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera
5.	Njohuri të reja		Këngët e vajtit			
6.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Andon Zako Çajupi – Lirika e dashurisë Studim teksti 1 – Dashuria	Analizë: <i>Lirika erotike e Çajupit dhe ndikimi i saj nga folklori; Cikli "Dashuria" dhe "Vajet".</i>	Të folurit; Të shkruarit të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga krijimtaria e Andon Zako Çajupit
7.	Njohuri të reja		Andon Zako Çajupi – Lirika e dashurisë Studim teksti 2 – Vajet			
8.	Përpunim i njohurive	Punë kërkimore /Ese	Lirika e Çajupit dhe lidhjet e saj me krijimtarinë popullore	Diskutim	Të shkruarit	Materiale të përgatitura nga nxënësit
9.	Njohuri të reja	Epika popullore	Epika legjendare – Këngët e murosjes	Diskutim dhe analizë: <i>Legjendat dhe këngët epike legjendare</i>	Të folurit; Të shkruarit të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera
10.	Njohuri të reja		Epika legjendare – Këngët e murosjes Studim teksti: Kënga e kalasë			
11.	Njohuri të reja	Epika popullore	Këngët legjendare të rinjohjes Studim teksti: Ymer Aga	Analizë – Koment: <i>Këngët legjendare të rinjohjes dhe interpretimi i simbolikës së tyre.</i>	Të folurit; Të shkruarit të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera
12.	Njohuri të reja		Këngët legjendare të rinjohjes Studim teksti: Gjon Pretika			
13.	Njohuri të reja		Këngët legjendare të vëllait të vogël	Studim teksti – Analizë: <i>Interpretimi simbolik i këngës legjendare të Kostandinit dhe Dhoqinës</i>	Të folurit; Të shkruarit të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori ose edhe studime të tjera
14.	Njohuri të reja		Studim teksti: Kostandini dhe Dhoqina			
15.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Ismail Kadare – Kush e solli Doruntinën - Studim teksti 1	Analizë dhe studim teksti: <i>Legjenda e lashtë dhe trajtimi i saj në letërsinë bashkëkohore</i>	Të folurit; Të shkruarit të dëgjuarit	Teksti, vepra e Kadaresë "Kush e solli Doruntinën", materiale nga interneti (drama televizive) etj.

16.	Njohuri të reja		Ismail Kadare – Kush e sollë Doruntinën - Studim teksti 2	Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori ose edhe studime të tjera
17.	Njohuri të reja	Epika popullore	Cikli i Kreshnikëve – Muji dhe Halili Studim teksti 1: Martesa e Mujit	Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori ose edhe studime të tjera
18.	Njohuri të reja		Cikli i Kreshnikëve – Muji dhe Halili Studim teksti 2: Vajtimi i Ajkunës	Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori ose edhe studime të tjera
19.	Njohuri të reja		Cikli i Kreshnikëve Studim teksti 3: Gjergj Elez Alia	Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori ose edhe studime të tjera
20.	Njohuri të reja		Cikli i Kreshnikëve dhe origjinaliteti i tij	Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori ose edhe studime të tjera
21.	Përpunim i njohurive	Përsëritje	Përsëritje e njohurive	Bashkëbisedim	Të dëgjuarit Të folurit;	Materiale nga teksti mësimor
22.	Përpunim i njohurive	Punë kërkimore	Identiteti i ciklit të Kreshnikëve dhe origjina e tij.	Diskutim – Analizë	Të shkruarit	Materiale të përgatitura nga nxënësit
23.	Përpunim i njohurive		Vlerësim i njohurive – 2	Test me shkrim	Të shkruarit	Materiale të përgatitura nga nxënësit
24.	Përpunim i njohurive		Punë me portofolin – 2	Vlerësim – Vetëvlerësim		Materiale të përgatitura nga nxënësit

PLANI TEMATIK – TREMUJORI I TRETË

NR.	LLOJI I TEMËS	LINJA	TEMA MËSIMORE	SITUATAT E TË NXËNIT	KOMPETENCAT	BURIMET DHE MJETET MËSIMORE
1.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Gjergj Fishta – Lahuta e Malcisë Studim teksti: Kënga VIII – Ali Pashë Guçia	Analizë: <i>Ndikimi i folklorit në eposin kombëtar “Lahuta e Malcisë”</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori
2.	Përpunim i njohurive	Punë kërkimore	<i>Koncepti i nderit në krijimtarinë popullore përshkon edhe personazhet e poemës së Fishtës dhe Darës.</i>	Diskutim – Analizë – Vlerësim	Të shkruarit	Materiale të përgatitura nga nxënësit
3.	Njohuri të reja	Epika popullore	Epika historike	Analizë – Koment: <i>Këngët e epikës historike dhe konteksti i tyre.</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori
4.	Njohuri të reja		Epika historike			

5.	Njohuri të reja	Proza popullore	Llojet dhe përmbajtja e përrallave	Diskutim: <i>Përrallat dhe vlerat e tyre</i>	Të dëgjuarit Të folurit;	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori
6.	Njohuri të reja		Arti dhe vlerat e përrallave			
7.	Njohuri të reja		Studim teksti: Valltarja me fustanellë	Analizë – Studim teksti i një përralle mbështetur në informacionin e marrë.	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	
8.	Përpunim i njohurive	Përsëritje	Përsëritje e njohurive			
9.	Njohuri të reja	Ndikimi i shkrimtarëve nga folklori	Mitrush Kuteli – Rrëfimet dhe rrëfenjat Studim teksti 1 : Rinë-Katerinëza	Analizë – Koment: <i>Rrëfimet dhe rrëfenjat e Mitrush Kutelit</i>	Të dëgjuarit Të folurit; Të shkruarit	Teksti mësimor dhe materiale nga krijimtaria e Mitrush Kutelit.
10.	Njohuri të reja		Mitrush Kuteli – Rrëfimet dhe rrëfenjat Studim teksti 2 : Hanxhiu i hapsanikëve			
11.	Njohuri të reja		Ernest Koliqi – Moderniteti i prozës së Koliqit Studim teksti 1: Nusja e mrekullueshme	Analizë dhe koment: <i>Proza moderne e Koliqit dhe ndikimi nga folklori</i>	Të folurit; Të shkruarit Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale nga krijimtaria e Ernest Koliqit – “Hija e Maleve”
12.	Njohuri të reja		Ernest Koliqi – Moderniteti i prozës së Koliqit Studim teksti 2: Kërcimtarja e Dukagjinit			
13.	Njohuri të reja		Lumo Skëndo Studim teksti 1: Plaku i Ylyncit	Analizë – Koment: <i>Interpretimi alegorik i tregimit. Ndërthurja e reales me irealen.</i>	Të folurit; Të shkruarit Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale nga krijimtaria e Lumo Skëndos
14.	Njohuri të reja		Martin Camaj – Dranja Studim teksti: Dranja (madrigale)	Analizë – Koment: <i>Interpretimi alegorik i madrigaleve.</i>	Të folurit; Të shkruarit Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale nga krijimtaria e Martin Camajt – “Dranja”
15.	Njohuri të reja	Proza popullore	Proverbat dhe gjëgjëzat	Bashkëbisedim: <i>Urtësia popullore në krijimin e proverbeve dhe humorit.</i>	Të folurit; Të shkruarit Të dëgjuarit	Teksti mësimor dhe materiale të tjera nga folklori

16.	Njohuri të reja		Folklori dhe e qeshura				
17.	Përpunim i njohurive		Vlerësim i njohurive – 3	Test me shkrim	Të shkruarit		
18.	Përpunim i njohurive	Përpunim i njohurive	Projekt lëndor	Paraqitje e projektit	Të shkruarit Të dëgjuarit	Materiale të përgatitura nga nxënësit	
19.	Përpunim i njohurive		Projekt lëndor				
20.	Përpunim i njohurive		Punë me portofolin – 3	Vlerësimi dhe vetëvlerësimi	Të folurit	Materiale të përgatitura nga nxënësit	

V. Modele të planifikimit ditor - Letërsia me zgjedhje 12

JAVA I

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Folklori dhe rëndësia e tij		Situatat e të nxënit: Ç'është folklori?	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: -përcakton kuptimin për folklorin dhe folkloristikën; -vlerëson rëndësinë e studimit të folklorit si një pasuri kombëtare, shpirtërore dhe artistike;		Fjalë kyç: folklor, folkloristikë, tipari kolektiv, tipari anonim, sinkretizmi etj.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> krijime të ndryshme folklorike; libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); fleta e punës për detyrën e portofolit. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Arti 	

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	15 min
2.	Informacioni i ri	Folklori dhe folkloristika	10 min
3.	Punë e drejtuar	Diskutim - Vlerat e folklorit	25 min
4.	Punë e pavarur	Mendo - Krijo dyshe - Diskuto	25 min
5.	Reflektim	Përgatitja për punën e portofolit	10 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi¹:

- **Motivimi:**

- Lexohet fragmenti i shkëputur nga vepra e Kadaresë “Autobiografia e popullit në vargje” ose një fragment tjetër që nxit bisedën rreth folklorit.
- U kërkohet nxënësve përmes bashkëbisedimit të rikujtojnë nga vitet e kaluara çfarë është folklori, cilat janë krijimet folklorike dhe llojet e folklorit.
- Bashkëbisedimi mund të zhvillohet me librin hapur dhe nxënësit mund t’i referohen atij në çdo kohë.

Shënim:

Në rast se për kushtet e klasës / shkollës apo nivelit të nxënësve nuk është e mundur të sigurohen materialet ndihmëse apo informacionet e kërkuara më lart, mund të punohet me materialin e tekstit

1. Nxënësit janë njohur edhe më parë me folklorin dhe kanë një informacion rreth tij, ndaj mësimi fillon me bashkëbisedimin rreth asaj që mbajnë mend nxënësit.

mësimor të nxënësit. Mësuesi orienton bashkëbisedimin ose e nxit atë duke përgatitur pyetjet e aparatit pedagogjik të tekstit.

2. Informacioni i ri²:

- Nisur nga njohuritë që kanë nxënësit, mësuesi mund të bëjë plotësimin dhe saktësimin e tyre, duke shtuar informacionin për tiparet e folklorit.

3. Diskutimi³:

- U kërkohet nxënësve të diskutojnë rreth vlerave të folklorit duke pasur parasysh materialin dhe informacion e dhënë në tekst.

- Diskutohet rreth krijimeve të sjella nga nxënësit ose rekomandohen ato krijime që janë studiuar në klasën e dhjetë, si për shembull “Cikli i Kreshnikëve” ose legjendën e murimit në kala etj.

Pyetje për diskutim:

- Çfarë vlerash njohëse ose historike kanë këto krijime?
- A mund të merren ato si fakte historike?
- Cilat janë vlerat e tyre letrare dhe estetike?

Punohet rubrika “Pyetje dhe diskutime”

- Si e kuptoni karakterin anonim të folklorit?
- Pse themi se kënga popullore jeton në shumë variantet?
- A mund të merret si folklorik një krijim, i cili sapo ka dalë për herë të parë nga krijuesi i tij fillestar, nga një individ? Pse?

Gjatë këtij diskutimi preket edhe tematika e zhvillimit të krijimeve folklorike sot si edhe dukuria e turbofolkut.

ORA E DYTË

4. Mendo - krijo dyshe - diskuto⁴:

- Si një strategji e mundshme është puna në grup ose në çift për të punuar detyrat 4 dhe 5.
- Nxënësve u jepet e përgatitur fleta e veprimtarisë në klasë ose orientohet të përgatitet në fletoret e tyre si më poshtë për të punuar ushtrimin 5:

Të përbashkëtat	Të veçantat
Krijimet folklorike variante	
Citim nga këngët	Citim nga këngët

5. Përgatitja e punës për detyrën e portofolit:

- Nxënësit do të orientohen se si duhet të përgatitin një skedë për të mbledhur dhe dokumentuar një

2. Informacioni i ri do të përqendrohet te veçoritë e folklorit dhe dallimin mes tiparit anonim dhe kolektiv, si dhe sinkretizmit .

3. Gjatë diskutimit do të përfshihen të gjithë nxënësit, nëse ata e kanë lexuar krijime folklorike ose mbajnë mend këngë të mësuara më parë. Mësuesi mund të sigurojë krijime folklorike si këngë, përralla ose legjenda, të cilat mund të konkretizojnë mendimet e tyre për diskutim.

krijim folklorik.

- Sqarohen nxënësit se si duhet ta përgatisin materialin në formë të shkruar apo të regjistruar sipas mundësive dhe afatin kohor të dorëzimit të tij.
- Nxënësit informohen për mënyrën e vlerësimit të punës së portofolit me pikë sipas tabelës së mëposhtme.

Vlerësimi i punës për portofolin⁵:

- Realizimi i detyrës sipas të gjitha kërkesave dhe kritereve të vendosura: - 50 pikë
- Respektimi i etikës dhe profesionalizmi në realizimin e detyrës: - 20 pikë
- Dorëzimi i detyrës në kohën e përcaktuar: - 10 pikë
- Realizimi i shkrimit reflektues për ndikimin e detyrës: - 20 pikë

Konvertimi i pikëve në nota⁶:

NOTA		4	5	6	7	8	9	10
PIKËT		0 - 24	25 - 44	45 - 54	55 - 64	65 - 74	75 - 84	85 - 100

6. Vlerësimi:

Për vlerësimin e nxënësve mund të përdoren kritere të ndryshme, por në tabelën e mëposhtme, sugjerohet një model vlerësimi.

Pikët ose vlerësimi me shprehje / Nota	Përshkrimi i rezultateve të arritjes
Shumë mirë / 9 -10	<ul style="list-style-type: none"> • Jep shembuj specifikë në diskutimet në klasë; • Sjell shembuj të krijimeve të ndryshme folklorike në klasë; • Gjen tiparet dalluese të një krijimi folklorik; • Realizon gjatë orës së mësimit detyrën e klasës me shkrim;
Mirë / 7 - 8	<ul style="list-style-type: none"> • Ndhmon me të paktën një shembull në diskutim në klasë; • Jep të paktën një citim të përshtatshëm për fletën e veprimtarisë; • Përfundon veprimtarinë me shkrim në klasë;
Mjaftueshëm / 5 -6	<ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në diskutimin në klasë duke u përpjekur të japë mendimin e vet për temën dhe diskutimin; • Citimet nga teksti në fletën e veprimtarisë nuk janë të përshtatshme dhe nuk mbështetin temën e përcaktuar;
Dobët / 4	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ndihmon me shembuj në diskutimet dhe nuk merr pjesë në zhvillimin e procesit të të nxënës;

Shënim!

Për orën e ardhshme të mësimit, javën tjetër nxënësit orientohen ku të punojnë në tekstin mësimor dhe çfarë do të duhet të parapërgatitin për të sjellë në klasë.

Ata duhet të kërkojnë në burime të ndryshme, internet, libra apo tekste mësimore dhe të sjellin në klasë një informacion rreth Thimi Mitkos dhe botimeve “Visaret e Kombit”.

**Detyra për portofol:
Mbledhja e folklorit**

4. Gjatë orës së dytë, mund të vazhdohet me detyrat apo veprimtaritë e orës së parë, nëse ato nuk kanë përfunduar. Nëse gjithçka është realizuar sipas parashikimit, mund të kalohet te puna në çift ose në grup.

5. Mësuesi është i lirë të vendosë kritere të tjera shtesë ose të përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet mudi i çdo nxënësi.

6. Kjo është vetëm një tabelë orientuese, pasi mësuesi mund të zgjedhë vetë se çfarë sistemi vlerësimi mund të përdorë.

JAVA II

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Folkloristika shqiptare		Situatat e të nxënit: Studimi dhe mbledhja e folklorit	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: - përcakton përfaqësuesit kryesorë të folkloristikës; - vlerëson rëndësinë e studimit të folklorit; - gjyon rreth veprave dhe rëndësisë së mbledhësve të folklorit.		Fjalë kyç: folklorist, folkloristikë, mbledhës të folklorit, historia e folkloristikës etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme folklorike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12).		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Vlerësimi i njohurive	Pyetje - përgjigje	10 min
3.	Informacioni i ri	Historia e folkloristikës shqiptare	10 min
4.	Punë e drejtuar	Lexim i drejtuar	20 min
5.	Punë e pavarur	Punë në dyshe Diskutim - Rëndësia e mbledhjes së folklori	30 min
6.	Reflektim	Përgatitja për punën e portofolit	10 min
7.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**• **Motivimi:**

Ora e mësimit mund të fillojë me leximin e një pjese apo krijimi folklorik të sjellë nga nxënësi ose të përzgjedhur nga mësuesi.

• U kërkohet nxënësve përmes bashkëbisedimit të rikujtojnë njohuritë e orës së kaluar duke vlerësuar apo sqaruar konceptet e dhëna.

• Bashkëbisedimi zhvillohet me librin hapur dhe nxënësit mund t'i referohen atij në çdo kohë.

2. Vlerësimi i njohurive:

- Në varësi të detyrave të dhëna gjatë orës së kaluar, kërkohet të lexohen ato nga nxënës të ndryshëm dhe të vlerësohen prej të tjerëve duke dhënë mendime rreth tyre.

- Mësuesi vlerëson kryerjen e detyrave dhe bën vlerësimet apo sugjerimet sipas rastit. Gjatë kësaj ore mund të vlerësohen edhe punët e portofolit për disa prej nxënësve që mund të kenë sjellë krijimet e mbledhura.

3. Informacioni i ri:

• Nëse nga nxënësit janë sjellë në klasë krijime folklorike të mbledhura, ora e mësimit fillon

me vlerësimin e metodologjisë së mbledhjes së tyre. Më pas kalohet në sqarimin e koncepteve sipas fjalëve kyçe:

- **Folklorist** - mbledhës i folklorit.
- **Folkloristika** - shkenca e mbledhjes dhe studimit të folklorit.
- **Historia e folkloristikës** - tërësia e veprave dhe autorëve që janë marrë me mbledhjen e folklorit.

4. Leximi i drejtuar:

- Për të plotësuar dhe saktësuar konceptet e dhëna në informacionin e ri, do të punohet nga nxënësit duke lexuar materialin e dhënë në tekstin e nxënësve.

- **Punohet rubrika “Pyetje dhe diskutime”**

Punohen ushtrimet 1 - 2.

1. Çfarë studion folkloristika? Kur janë fillimet e saj?

2. Përmendni disa prej mbledhësve të hershëm të folklorit.

- Argumentoni pse puna e tyre ka rëndësi kombëtare dhe patriotike.

ORA E DYTË

5. Mendo - krijo dyshe - diskuto:

- Si një strategji e mundshme është puna në grup ose në çift për të punuar detyrat 1, 2 dhe 3 të rubrikës.

“Interpretime dhe analiza”

1. Vëreni me kujdes gjëgjëzat mbledhur nga Thimi Mitko.

a. Me çfarë mjetesh stilistikore janë ndërtuar ato?

- *“Një plak me mjekër ngulur ndë dhet, e këmbë përpyetë!”* (mjete stilistik - metafora) - (preshti në kopsht)

- *“Ka s’është e brirë ka,*

gomar s’është e samar ka,

ngado shkon, argjend lëshon!” (mjete stilistik - paradoksi dhe metafora) - (kërmilli)

- *“Një fushë me ve, shkon kali hamëshuar e s’i shkel!”* (mjete stilistik - metafora) - (qielli me yjet dhe hënë)

b. Pse është përdorur në to ngjyrimi humoristik?

- Gjëgjëzat kanë ngjyrimin humoristik, pasi ato përdoren për të krijuar situata gazmore dhe argëtim.

c. Shpjegoni këto gjëgjëza duke zhvilluar një konkurs në formë loje në klasë. A do të krijohet situatë gazmore në klasë? Pse?

Shënim: Mësuesi këtë lojë mund ta zhvillojë edhe në fillim të orës së mësimit për të tërhequr vëmendjen dhe për të rritur motivimin.

2. Krahasoni këto proverba të mbledhura në kohë të ndryshme.

a. Çfarë vini re në ndërtimin dhe në gjuhën e tyre?

-Përveç ndryshimeve gjuhësore, mësuesi duhet të orientojë nxënësit për të vënë re ndryshimet në kohë që shfaqen përmes ndikimit në të të elementeve dhe fakteve kulturore dhe historike.

Për shembull:

Proverbat e mbledhura nga Bardhi kanë më shumë ngjashmëri me proverbat italiane ose latine si më poshtë:

Kush ve kadalë, ve shëndoshë. (Krahaso: *Chi va piano, va sano e va lontano.* It.);

Ose, gjuha e përdorur në proverbat e Bardhit reflekton stadin e zhvillimit të gjuhës shqipe dhe në to gjejmë dëshmi të evoluimit të saj, si për shembull: përdorimi i “ë”-së patheksuar; fjalë të vjetra ose me ndikim latin si fjala: fosë - grope (nga it. Fossa - gropë); etj.

Ose ndryshimi të proverba e fundit, ku fjala “luftë” në proverbën e Bardhit është zëvendësuar me fjalën “dasmë” të Mitko, që është tregues i ndikimeve kulturore dhe historike.

b. Ç’ndryshim moshe kanë midis tyre?

I shkruani ato në gjuhën e sotme shqipe.

Puna me shkrim për t’i përshtatur në gjuhën e sotme standarde ka si qëllim që nxënësi të vërejë ngjashmëritë mes gjuhës së Bardhit, Mitkos dhe gjuhës së sotme, por edhe të kuptojë ndryshimet e gjuhës dhe zhvillimin e saj. Gjithashtu, kjo tregon edhe për vlerën e këtyre thënieve që nuk e kanë humbur, edhe pse kanë kaluar gati 5 shekuj.

3. Fragmentet e mëposhtme të shkëputura nga Eposi i Kreshnikëve, “Martesa e Halilit”, janë mbledhur nga njerëz dhe në kohë të ndryshme.

a. Cila prej këtyre motërzimeve (varianeteve) ju duket më e bukur?

b. Çfarë e bën atë të tillë?

c. Pse njëri prej varianteve është më i gjatë? Me çfarë mjetesh e ka zgjatur rapsodi që e ka kënduar?

Qëllimi i kësaj detyre është që nxënësi të reflektojë rreth konceptit të zhvillimit të varianteve dhe ndikimit individual në krijimin e tyre.

Gjithashtu, tërhiqet vëmendja se sa më shumë të pasurohet një krijim, aq më i bukur bëhet ai dhe aq më shumë i reziston kohës.

Në krijimin e 1937 vihen re elemente rrëfimtare dhe përsëritje që i japin këngës më shumë bukuri, krijojnë atmosferë dhe rritin intensitetin e ndjenjës.

5. Përgatitja e punës për detyrën e portofolit:

- Nxënësit do të orientoohen se si duhet të përgatitin esenë duke i sqaruar për kriteret e saj.
- Sqarohen nxënësit se si duhet ta përgatisin materialin në formë të shkruar apo elektronike, duke vendosur ndoshta edhe një numër të caktuar fjalësh.
- Nxënësit informohen për mënyrën e vlerësimit të punës së portofolit me pikë sipas tabelës së mëposhtme.

Vlerësimi i punës për portofolin¹:

Skema e vlerësimit:

ARGUMENTI	STRUKTURA E ESEË	PASURIA GJUHËSORE	LARMIA SINTAKSORE	SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE	PIKËT TOTALE
30 pikë	10 pikë	20 pikë	20 pikë	20 pikë	100 pikë

Konvertimi i pikëve në nota²:

NOTA		4	5	6	7	8	9	10
PIKËT		0 - 24	25 - 44	45 - 54	55 - 64	65 - 74	75 - 84	85 - 100

6. Vlerësimi:

Për vlerësimin e nxënësve mund të përdoren kritere të ndryshme, por në tabelën e mëposhtme sugjerohet një model vlerësimi.

Pikët ose vlerësimi me shprehje / Nota	Përshkrimi i rezultateve të arritjes:
Shumë mirë / 9 -10	<ul style="list-style-type: none"> • jep shembuj specifikë në diskutimet në klasë; • sjell shembuj të krijimeve të ndryshme folklorike në klasë; • gjen tiparet dalluese të një krijimi folklorik; • realizon gjatë orës së mësimit detyrën e klasës me shkrim.
Mirë / 7 - 8	<ul style="list-style-type: none"> • ndihmon me të paktën një shembull në diskutim në klasë; • jep të paktën një citim të përshtatshëm për fletën e veprimtarisë; • përfundon veprimtarinë me shkrim në klasë.
Mjaftueshëm / 5 -6	<ul style="list-style-type: none"> • merr pjesë në diskutimin në klasë, duke u përpjekur të japë mendimin e vet për temën dhe diskutimin; • citimet nga teksti në fletën e veprimtarisë nuk janë të përshtatshme dhe nuk mbështetin temën e përcaktuar.
Dobët / 4	<ul style="list-style-type: none"> • nuk ndihmon me shembuj në diskutimet dhe nuk merr pjesë në zhvillimin e procesit të të nxënës.

Shënim: Për orën e ardhshme të mësimin, javën tjetër nxënësit orientohen ku të punojnë në tekstin mësimor dhe çfarë do të duhet të parapërgatitin për të sjellë në klasë.

Ata duhet të kërkojnë në burime të ndryshme, internet, libra apo tekste mësimore dhe të sjellin në klasë një informacion rreth Thimi Mitkos dhe botimeve “Visaret e Kombit”.

Detyrë shtëpie:

Gjeni në botime të ndryshme folklorike apo në libra të tjerë me përmbledhje folklorike, dy motërzime të këngëve të ndryshme. I shkruani ato në fletore dhe nënvizoni e shpjegoni ndryshimet.

1. Mësuesi është i lirë të vendosë kritere të tjera shtesë ose të përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet mudi i çdo nxënësi.

2. Kjo është vetëm një tabelë orientuese, pasi mësuesi mund të zgjedhë vetë se çfarë sistemi vlerësimi mund të përdoret.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Jeronim de Rada - Këngët e Milosaos • Punë me portofol		Situatat e të nxënit: Rilindja Shqiptare dhe ndikimi nga folklori	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: -përcakton veçoritë dhe ndikimin e folklorit në krijimtarinë e De Radës; -vlerëson ndikimin e folklorit në poemën lirike “Këngët e Milosaos”; -grykon rreth veprës së De Radës dhe ndikimin e saj nga folklori arbëresh.		Fjalë kyç: Letërsia e Rilindjes, De Rada, ndikimi nga folklori, Këngët e Milosaos, etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme folklorike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12) • Këngët e Milosaos.		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Përsëritje e njohurive	Pyetje - përgjigje për Rilindjen Kombëtare Shqiptare	15 min
3.	Punë e pavarur	“Ruaje fjalën e fundit për mua”	25 min
4.	Vlerësimi i portofolit	Vlerësim / Vetëvlerësim	40 min
5.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**• **Motivimi:**

Kjo orë mësimore do t’i kushtohet ndikimit të letërsisë së Rilindjes Kombëtare nga folklori. Nxënësit janë njohur në klasën e njëmbëdhjetë me këtë letërsi dhe përfaqësuesit e saj, kështu që procesi mësimor fillon me leximin e një prej pjesëve të kësaj letërsie p.sh. me fragmentin e dhënë nga “Këngët e Milosaos” ose pjesë tjetër.

• U kërkohet nxënësve përmes bashkëbisedimit të rikujtojnë njohuritë e vitit të shkuar rreth Rilindjes dhe veçorive të kësaj letërsie.

• Vlerësimi i detyrave të dhëna orën e kaluar dhe i detyrës për portofol do të realizohet në pjesën e dytë të orës së mësimimit, pra në 45-minutëshin e dytë.

2. Përsëritje e njohurive:

Në këtë pjesë të orës së mësimimit fokusohen temat dhe çështjet e mëposhtme:

1. Epoka historike e Rilindjes Kombëtare dhe fazat e zhvillimit të saj:

- Kushtet historike të Shqipërisë gjatë shekullit XIX.
- Fazat në të cilat u zhvillua Rilindja Kombëtare.
- 2. Dokumentet kryesore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare
 - Enqiklika.
 - E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët.
 - Shqipëria çka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet.
- 3. Romantizmi shqiptar dhe karakteristikat e tij
 - Tiparet e Romantizmit Shqiptar.
 - Shkrimtarët kryesorë.
 - Veprat kryesore më të rëndësishme të Romantizmit Shqiptar.

Më pas kalohet te poema e De Radës, për të cilën mund të punohet fragmenti i dhënë, por pasi të jenë risjellë edhe njëherë në vëmendje konteksti dhe përmbajtja e saj përmes pyetjeve si më poshtë:

Pyetje rreth “Këngët e Milosaos”:

1. Cilat janë temat kryesore dhe nëntemat e poemës?
2. Çfarë konfliktesh pasqyron autori në të? Si zgjidhen ato?
3. Çfarë veçorish ka stili i De Radës në portretizimin e personazheve?
4. Si realizohet uniteti i kësaj poeme?
5. Cili është sfondi historik ku zhvillohen ngjarjet e poemës?

A i përgjigjet realiteti i pasqyruar dhe personazhet që veprojnë në poemë sfondit historik?

3. Punë e pavarur:

- Teknika “*Ruaje fjalën e fundit për mua*” përdoret për të bërë komentin dhe vlerësimin e fragmentit të dhënë në tekst “Takimi te burimi”.
 - Secili nxënës pasi lexon disa vargje apo gjithë këngën jep mendimin e vet për përmbajtjen, veçoritë stilistikore, si dhe ndikimin e saj nga folklori.
 - Në fund, mësuesi ose në rastin më të mirë një nxënës tjetër bën saktësime, sqarime dhe/ose plotësime për mendimet e dhëna dhe njëkohësisht edhe vlerësimin e tyre.
 - Mësuesi drejton punën për përgjigjen e pyetjeve si më poshtë:

1. Si ka ndikuar folklori në motivin e kësaj kënge?

- Takimi në *kroin e fshatit* është një prej motiveve të huazuara nga folklori. Kjo i jep këngës më shumë ndjeshmëri, si dhe më shumë emocion. Por njëkohësisht është edhe një vendtakim i përshtatshëm për kohën dhe kontekstin kulturor shqiptar.

2. Idili i dashurisë që lind në krua përshkruhet nga autori me një mjeshtëri të rrallë artistike. Për ta kuptuar më mirë këtë këngë, ndajeni në katër pjesë:

- a. Tregoni çfarë thuhet në secilën pjesë.
- b. I vendosni një titull secilës pjesë sipas temës që ajo trajton. Për të punuar këtë detyrë mund të sugjerohet kjo tabelë:

Pjesë nga kangjeli (kënga)	Titulli
Pjesa I - 1- 8 (vargjet)	Përshkrimi i natyrës romantike
Pjesa II - 9-19 (vargjet)	Portretizimi i vajzës
Pjesa III - 20-30 (vargjet)	Dialogu me vajzën
Pjesa IV - 31 - 38 (vargjet)	Lindja e ndjenjës së dashurisë

Po kështu vazhdohet më tej për të individualizuar portretizimin e Rinës ku duhet të vihen re disa prej tipareve të saj të shprehura në mënyrë artistike.

- e përveshurë, e lartë - epitete; (tipare fizike)
- me një të ndrojtur hare - epitet metaforik; (tiparet shpirtërore, psikologjike)

Detyrë shtëpie:

Gjeni dhe shkruani vargjet që shprehin lindjen e ndjenjës së dashurisë te të rinjtë.

Çfarë mbresash ju ngjallin ato? Cila është figura stilistikore mbi të cilën janë ndërtuar?

ORA E DYTË

4. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i detyrave për portofolin

Gjatë orës së dytë do të punohet me detyrat e portofolit që kanë përgatitur nxënësit në këtë periudhë, si dhe do të jepen sqarimet për vlerësimin e portofolit.

Në javët e kaluara janë dhënë dy detyra portofoli, kështu që mësuesi do t'u japë mundësi nxënësve që i kanë përgatitur ato, t'i paraqesin dhe nxënësit e tjerë të vlerësojnë punën duke vendosur kriteret e përcaktuara.

Nëse nxënësit e tjerë nuk i kanë përgatitur detyrat, kjo është një mënyrë për t'u treguar se si duhet të punojnë, duke ju dhënë sqarime, orientime dhe njëkohësisht i vlerësuar ata që kanë punuar.

Nëse ka disa nxënës që kanë përgatitur këto materiale, mund të vlerësohen dhe diskutohen disa prej këtyre detyrave në klasë dhe pjesa tjetër të vlerësohet individualisht.

Është e rëndësishme që nxënësve t'u komunikohen rregullat, kriteret, modelet, si dhe mënyrat se si duhet të punojnë dhe dokumentojnë punën e tyre.

Vlerësimi i punës për portofolin:

Mësuesi është i lirë të vendosë kriteret e tjera shtesë ose t'i përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet munda i çdo nxënësi.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Gavril Dara - Kënga e sprasme e Balës		Situatat e të nxënit: Heroi lirik i romantizmit shqiptar dhe ndikimi i tij nga këngët epike folklorike	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: - përcakton veçoritë dhe ndikimin e folklorit në krijimtarinë e Darës; - vlerëson ndikimin e folklorit në poemën lirike “Kënga e sprasme e Balës”; - gjykon rreth vlerave të poemës dhe ndikimin e saj nga folklori arbëresh.		Fjalë kyç: Heroi lirik, Gavril Dara, ndikimi nga folklori, Kënga e sprasme e Balës etj.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • krijime të ndryshme folklorike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • Kënga e sprasme e Balës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Përsëritje e njohurive	Pyetje - përgjigje për Rilindjen Kombëtare Shqiptare	15 min
3.	Informacioni i ri	Ndikimi i folklorit në motivet e poemës	25 min
4.	Punë e pavarur	“Ditari dy/tripjesësh”	35 min
5.	Vlerësimi dhe detyrat e shtëpisë		10 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

• **Motivimi:**

• Për këtë orë mësimi mësuesi mund t’i motivojë nxënësit ose të fillojë orën e mësimimit me ndonjë lexim nga poema, fragment apo edhe me një diskutim të shkurtër rreth kësaj vepre.

Në rast se nxënësit nuk e njohin autorin dhe veprën, është mirë të bëhet kjo paraqitje, por pa u ndalur shumë në hollësi të jetës, vetëm si një kontekst kulturor, historik, letrar dhe social.

Shkurtimisht jepet edhe fabula e saj dhe personazhet.

2. Përsëritje e njohurive:

Në këtë pjesë të orës së mësimi fokusohen temat dhe çështjet e mëposhtme:

1. Epoka historike e Rilindjes Kombëtare dhe fazat e zhvillimit të saj:

-Kushtet historike të Shqipërisë gjatë shekullit XIX.

-Letërsia e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe arbëreshët.

2. Subjekti dhe personazhet e poemës:

-Epoka e “motit të madh” dhe poema e Darës.

-Ngjarjet historike dhe ngjarjes e poemës.

-Personazhet.

Ky bashkëbisedim zhvillohet rreth njohurive që kanë nxënësit paraprakisht ose edhe duke i paraqitur ato në formën e një bashkëbisedimi.

3. Informacioni i ri - Ndikimi i poemës nga folklori

Ky informacion i ri mund të punohet, duke i lënë nxënësit ta lexojnë materialin e dhënë në tekstin mësimor dhe duke renditur motivet si më poshtë:

-motivi i rrëmbimit dhe shpëtimit të vajzës;

-tiparet e heronjve;

-zënia e pusisë;

-motivi i besës së dy të rinjve;

-motivi i zgjidhjes së martesës;

-lënia e amaneteve (porositë e heronjve);

-mbirja e bimëve në varret e heronjve.

Këto motive mund të trajtohen të ndërthurura me subjektin, kurse argumentimi i tyre mund të bëhet nga nxënësit pasi të kenë lexuar materialin e ri në tekst.

Për këtë mund të përdoret edhe fletorja e shënimeve, në mënyrë që nxënësit të mund të përdorin këtë analizë gjatë punës në orën e dytë, në “Punën e pavarur”.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

- Teknika “Ditari dy/ tripjesësh” përdoret për të bërë komentin dhe vlerësimin e fragmentit të dhënë në tekst “Beteja e Valkalit”.

- Secili nxënës, pasi lexon disa vargje apo gjithë këngën jep mendimin e vet për përmbajtjen, veçoritë stilistikore si dhe ndikimin e saj nga folklori mbështetur te motivet e dhëna më lart, duke përcaktuar se cili prej këtyre motiveve duket në këtë fragment.

- Çdo nxënës punon individualisht në tekst, duke e ndarë fletën e fletoren në dy pjesë. Në njërin prej tyre shënon komentin e vet, apo mendimin e vet mbështetur në ushtrimet dhe detyrat e tekstit dhe më pas, në pjesën tjetër shënon mendimet, komentet, vlerësimet e dhëna nga shokët, të cilët i diskutojnë ato në klasë gjatë orës së dytë të mësimi.

- Në rast se do të përdoret ditari tripjesësh, në pjesën e tretë do të mbahen shënime për mendimet apo sugjerimet e dhëna nga mësuesi. Kështu, gjatë kësaj ore, nxënësi është përfshirë dhe njëkohësisht ka marrë informacionin e plotë për fragmentin.

- Mësuesi drejton punën për përgjigjen e pyetjeve si më poshtë:

Ditari dy/tripjesësh:

Mendimet e nxënësit	Sugjerimet dhe mendimet e shokëve	Komenti i mësuesit

1. Lexoni tekstin dhe ndajeni atë në dy pjesë.

a. Për secilën prej tyre vendosni një titull të përshtatshëm sipas rrëfimit.

Pjesa I - Përshkrimi i fushëbetejës

Pjesa II - Përshkrimi i heronjve

b. Përmbledhni rrëfimin e secilës pjesë në një paragraf të shkurtër.

2. Portretizoni të dy heronjtë për të cilët rrëfëhet në këtë fragment.

- Identifikoni mjetet letrare me të cilat është arritur ky përshkrim.

PORTRETIZIMI I HERONJVE			
NIK PETA		PAL GOLEMI	
Potretizimi	Mjetet stilistike	Portretizimi	Mjetet stilistike
Ish i bardhë si qiri, kryet rënë i kish mbi supe, flokët i ngisnin përdhe, gjaku i rridhte pika-pika qafës s’hapur si një shegë, jeta mbledhur ish në sy.	Ish i bardhë si qiri, qafës s’hapur si një shegë, (krahasim) kryet rënë i kish mbi supe, flokët i ngisnin përdhe, gjaku i rridhte pika-pika (metafora)	Pranë murgjarit ushtar me dhjet’shigjeta në gji shtrirë ish si ka i therur. Me dhëmb’ flamurin shtrëngonte, kordhën e mbante në grusht e me ballin kthyer qiellit edhe vdekjen e përbuzte.	Me dhjet’shigjeta në gji (hiperbola) shtrirë ish si ka i therur. (krahasim) vdekjen e përbuzte (metaforë)

3. Ku duket ndikimi i poezisë popullore në këtë fragment?

- Identifikoni motivet që janë marrë nga folklori dhe konkretizoni ato me vargje.

Lënia e amaneteve

“Lëri t’vdekurit në vend.
Lem’ të fle përgjithmonë
Te ky shtrat i nderit tim,
mu tek eshtrat e të vvarëvet,
e të vvarëvet nga kjo dorë
që gjithmon’ do m’jen’kurore.
Na këtë flamur e mbretit
Të m’i thuash këto fjalë:
“Pal Golemi edhe i vdekur
I tmerroi armiqt’ me sy.....

Motivi i dhënies së unazës së martesës

-Niku u nis e do mënojë,
po ti, nënë, mos e prit
pse për birëthin, që humbe,
ai një bijëz të ka lënë,
ty ta ka truar përjetë!

Vdekja e njëkohshme e dy njerëzve të dashuruar ose të afërm

-Këtë unazë ta dërgoi
Niku yt, se t'u martua,
t'u martua me një plakë,
me një plakë keq të zezë
e ti, e bukur t'i martohesh"

Mbirja e pemëve në varret e luftëtarëve

Ajo u zverdh e na vështroi
E u kthye dhe, sa e pa
Shtrirë t'vdekurin mbi dhe,
dhe një britmë e në krahë
e ftohtë si bora ra.

Jan' dy varre në Vajkal;
Fle te njëri Pal Golemi
E mbi të mbiu një lis
Me gjith' gjethet në blerim.
Fle te tjetri Niku i Petës,
Vasha e Lalës i fle pranë,
si, si u deshën përmbi dhe;
ashtu duhen dhe nën dhe;
Atje mbiu një qiparis,
Mbiu dhe një mollë e bardhë!
Kur të thahet qiparisi,

MOTIVET	KONKRETIZIMI ME VARGJE
---------	------------------------

Puna e pavarur vazhdon edhe përmes diskutimit të detyrave për analizën dhe interpretimin si në ushtrimet më poshtë:

1. Në këngën popullore "Mbeçë, more, shokë mbeçë", flitet për vdekjen e një nizami, larg vendit.

– A gjeni ngjashmëri mes këtij amaneti dhe atyre të dhënë nga heronjtë në poemën e Darës?

Po ka ngjashmëri dhe kjo duket edhe nga analiza e motivit të amanetit në pyetjen më lart.

– Çfarë ndryshimesh ka bërë autori?

Autori ka marrë këtë motiv, por e ka përpunuar, duke i dhënë atij karakterin e një motivi patriotik, pasi në të vihet re dashuria për atdheun e lirë dhe fakti që heronjtë nuk kanë rënë si nizamë, por për vendin e vet.

– Cili është funksioni i këtyre ndryshimeve?

Funksioni ka të bëjë me qëllimin që i ka vënë autori gjithë veprës: lartësimi i "motit të madh" dhe idealit të lirisë.

2. Nik Peta, në amanetin e tij përmend unazën.

-Kërkoni në Kanunin e Lek Dukagjinit ose pyesni në familjet tuaja dhe shpjegoni kuptimin që ka ajo.

Unaza është simboli i bashkimit dhe lidhjes në martesë. Gjithashtu ajo simbolizon përkatësinë, sipas kanunit, gruaja ishte pronë e burrit dhe vetëm ai kishte të drejtë t'i jepte leje të martohet, kur mund të ndodhnin fatkeqësi që çonin në ndarjen nga jeta të bashkëshortit.

-Pse *unaza* ka një rëndësi kaq të madhe?

Si simbol i lidhjes së përrjetshme, unaza bëhet një element shumë i rëndësishëm i martesës dhe jetës bashkëshortore.

-Po sot cili është kuptimi i shkëmbimit të *unazës* në ceremoninë e dasmës?

Edhe sot, shkëmbimi i unazës është simbol i këtij bashkimi, që sipas riteve qoftë fetare, qoftë familjare, shërbejnë për të dhënë në mënyrë simbolike këtë bashkim.

3. Çfarë mesazhi shpreh mbyllja e poemës: *fatalitetin e vdekjes apo shpresën për jetë?*

- Argumentoni përgjigjen tuaj, duke zhvilluar një diskutim në klasë.

Shënim: Rekomandohet që këto tematika të sillen në klasë nga vetë nxënësit përmes diskutimeve dhe shkëmbimit të kulturave, duke nxitur tolerancën dhe bashkekzistencën e kulturave të ndryshme.

Detyrë shtëpie¹:

STUDIM HULUMTUES:

Rilexoni edhe njëherë këngët e fundit të poemave “Këngët e Milosaos” dhe “Kënga e sprasme e Balës”.

Vëreni mënyrat e ndryshme stilistike në përshkrimin e në çasti të njëjtë: *personazhet kryesore në çastin e fundit të jetës, pasi kanë rënë në luftë për mbrojtjen e atdheut; detajet e ndryshme stilistike; çastin psikologjik të personazheve; mënyrën e të vështruarit të raporteve jetë/vdekje, fatalitet/shpresë.*

Shkruani një shkrim hulumtues rreth këtyre ngjashmërive, ndikimit të zakoneve dhe kulturës popullore, sidomos asaj arbëreshe.

¹ Kjo detyrë do të punohet në një orë të veçantë, në varësi të planifikimit vjetor dhe kërkesës që ka programi. Vlerësimi i saj mund të përfshihet në vlerësimin e vazhduar ose edhe në formën e vlerësimit përmbledhës për tremujorin e parë. Këtë vendim e merr mësuesi në varësi të nivelit dhe mundësive që ofron mjedisi i klasës dhe shkollës.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Lirika popullore - Ninullat • Studim teksti - Ninulla		Situatat e të nxënit: Ninullat dhe këngët e djepit	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi: - përcakton kuptimin për lirikën popullore dhe format e saj; - vlërëson rëndësinë e këngëve të djepit sipas tematikës; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve dhe djepit.		Fjalë kyç: ninulla, këngët e djepit, dëshirat e nënës, vlera e ninullave etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • ninulla.		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi - Krijimet lirike folklorike	10 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	20 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	15 min
4.	Punë e pavarur	Ditari dypjesësh	25 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	15 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**• **Motivimi:**

• *Kjo orë mësimore mund të zhvillohet mbështetur në njohuritë nxënësve rreth folklorit të cilat janë trajtuar në klasën X. Mësimi mund të fillojë edhe me leximin e ndonjë lirike folklorike apo ninulle si edhe mund të kërkohen nga vetë nxënësi të sjellin krijime të tilla.*

• Për të nxitur interesin dhe vëmendjen e nxënësve mund të kërkohet prej tyre të japin mendimin se çfarë dinë për ninullat dhe vlerat e tyre.

2. Informacioni i ri:

Në këtë pjesë të orës së mësimimit, nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme materialin e tekstit, duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

„**v**“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;

- „ - “ vendoset në fund të informacionit, i cili është ndryshe me atë që e dini ju;
 „ + “ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;
 „ ? “ informacion që për ju është i paqartë ose doni të dini diçka më shumë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst në formën e një diskutimi pasi të jetë lexuar dhe punuar materiali teorik informativ.

Pyetje dhe diskutime

1. Ninullat janë krijime popullore lirike që u kushtohen fëmijëve.

- Cila është përgjithësisht struktura e tyre?
- Si realizohet në to tipari *sinkretik* i folklorit?

2. Pse themi se te ninullat, nënat shprehin mendimet e tyre për jetën?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë mund të punohet me studimin e tekstit (ninullave) të dhëna në librin e nxënësit. Mësuesi është i lirë që të trajtojë edhe ndonjë këngë tjetër lirike (ninullë) sipas dëshirës apo mundësisë që ka apo edhe materiale që mund t’i kenë sjellë vetë nxënësit.

KUPTOJMË DHE ANALIZOJMË

1. Pasi të keni lexuar me kujdes këto dy ninullat, identifikoni në secilën prej tyre vargjet ku shprehen:

- a. Dëshirat e nënës për fëmijën e vet.
- b. Urimet e nënës për fëmijën.

	Dëshirat	Urimet
Vajza	Ti m’u rritsh si kokrra e thanës! Nina ninë, po të përkundi, Me të marrë i bardhi gjumi, Për me të rritë Zotyn i lumi; Do me të rritë e do me të shndritë, Për sahat e për dekikë.	Për m’u bamun vajzë e mirë Nana të don e të rahaton, Të rahaton e të ven me fjetë, E ti, bi, kjosh me jetë!
Djali	Flej se gjumi të ban mirë. Të ban mirë e të rahaton, Shtatin, bir, ta pushon.	M’u bafsh, bir, plak i vjetër! Sa dekika qi ka sahati, Njashtu, djalë, t’u rritët ty shtati. flej, o djalë, ti flesh i bardhë, e gjithkund t’u dhashtë mbarë!

2. Cili është përfytyrimi i nënës për gjumin? Çfarë mjeti stilistikor është përdorur?
3. A vëreni ndonjë ndryshim mes mënyrës se si nëna i këndon *djalit* dhe si i këndon *vajzës*?
 - Nëse po, shpjegoni arsyen e këtij ndryshimi.

5. Diskutim:

- Në traditën shqiptare, para lindjes së një fëmije, urohet **“Me një djalë”**, pra, për të pasur një fëmijë mashkull.
- Zhvilloni në klasë një diskutim duke argumentuar përmes fakteve të ndryshme, pse familjet shqiptare, para së gjithash dëshirojnë që fëmija i parë të jetë mashkull (djalë - çun).
- A lidhet kjo me traditën apo është thjesht një urim i thjeshtë?

Detyrë për portofol:

Ceremonia e vënies së emrit për një fëmijë të porsalindur shoqërohet me rite dhe zakone, përmes të cilave çdo familje, krahinë apo kulturë feston ardhjen në jetë të një pjesëtari të ri. Përmes tyre shprehen urimet, dëshirat, mendimet dhe mbi të gjitha i jepet mirëseardhja një jete të re.

Përshkruani shkurtimisht këtë traditë në familjen tuaj, duke pyetur prindërit, gjyshërit apo edhe të moshuar të tjerë të familjes. Për këtë mund të përdorni kujtimet se si është festuar në familjen tuaj ardhja juaj në jetë ose e ndonjë pjesëtari tjetër të familjes suaj (motër, vëlla, kushëri etj.). Mundohuni të përqendrohni te çastet më të rëndësishme të këtyre festimeve apo ceremonive.

JAVA VI

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Zakonet dhe këngët e dasmës • Studim teksti - Këngë dasme		Situatat e të nxëniet: Dasma dhe zakonet e saj	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi: -përcakton kuptimin për lirikën popullore dhe format e saj; -vlerëson rëndësinë e këngëve të dasmës sipas tematikës; -grykon rreth vlerave letrare të këngëve të dasmës.		Fjalë kyç: Këngët e dasmës, nusja, dhëndri, martesë, ceremonia e dasmës etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • këngë dasme.		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi - Dasma dhe tradita shqiptare	20 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	10 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	15 min
4.	Punë e pavarur	Ditari dypjesësh	20 min
5.	Reflektim	Shkrim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

- **Motivimi:**
 - Ora e mësimet mund të fillojë duke lexuar materialin informues në rubrikën “Zgjerohet njohuritë” që bën fjalë për dasmën shqiptare dhe zakonet e saj.
 - Për të nxitur interesin dhe vëmendjen e nxënësve mund të kërkohet prej tyre të japin mendimin se çfarë dinë ata për ceremoninë e martesës dhe ritet e saj sipas traditës së tyre familjare.

2. Informacioni i ri:

Në këtë pjesë të orës së mësimet nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme materialin e tekstit, duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

- „√“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;
- „-“ vendoset në fund të informacionit, i cili është ndryshe me atë që e dini ju;
- „+“ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;
- „?“ informacion që për ju është i paqartë ose doni të dini diçka më shumë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst në formën e një diskutimi, pasi të jetë lexuar dhe punuar materiali teorik informativ.

Pyetje dhe diskutime

1. Ceremonia e dasmës të shqiptarët i ngjan një spektakli të mirorganizuar. Ajo zhvillohet sipas riteve të përcaktuara ku secili pjesëmarrës e di shumë mirë rolin e vet.

- Përcaktoni disa prej riteve kryesore të kësaj ceremonie.
- Gjeni dhe ilustroni për secilin rit nga një këngë të zonës suaj.
- A ruhen ende këto rite në ceremonitë e dasmave në ditët e sotme?

2. Lexoni vargjet e mëposhtme të një kënge dasme.

- Në cilën fazë të dasmës mund të këndohet kjo këngë?
- Cila është vlera e këshillave që i jep nëna vajzës?
- Çfarë kuptojmë për marrëdhëniet familjare në këtë këngë?

3. Në këngën e mëposhtme i këndohet çastit kur lajnë dhe ndërrojnë dhëndrin.

Për çfarë po e përgatit këtu nëna djalin: për ceremoninë e dasmës apo për burrërinë?

- Si perceptohet në shoqërinë shqiptare martesja: si një status social apo kurorëzim i ndjenjës?
- Po sot, cili është roli i institucionit të martesës?
- Çfarë vlere ka përdorimi i refrenit *trim more* në këtë këngë?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë do të punohet me studimin e tekstit të një kënge dasme. Për këtë do të punohen detyrat e dhëna në tekst, duke i lënë më tepër hapësirë mendimit të lirë të nxënësve.

KUPTOJMË dhe analizojmë

1. Si përjetohet në këtë këngë largimi i vajzës (nuses) nga shtëpia?

2. Kjo këngë është ndërtuar në formën e një dialogu mes nuses dhe njerëzve të familjes së saj.

- Cila është vlera artistike e përdorimit të dialogut në një krijim lirik?
- Çfarë tregon ngurrimi i nuses për t'u larguar nga shtëpia?
- Shpjegoni vlerën që ka refreni i kësaj kënge: “*E nisun jam të dalë s’po kam*”.

Analizojmë tekstin

1. Analizoni në këtë këngë detajet të cilat japin dinamikën e çasteve të largimit të nuses nga shtëpia.

Shqyrtoni simbolikën që merr në këtë këngë myhyri (unaza) dhe gjerdani kundrejt vëllait dhe motrës.

2. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, për martesën flitet në Librin III si më poshtë.

LIBRI I TRETË

MARTESA

NYE I NJIMBDHETËT

Percaktimi e mëndyrët e Martesës.

28. Percaktimi i Martesës në Kanun.

M'u martue më kanun do'me thanë m'u ba shpi, me i a shtue shpis nji rob ma teper, sa per krah të punve, sa per të shtuem të fmive.

29. Mëndyrat e Martesës.

- a. Martesa me kunorë, e pelqyeme kah Feja e kanuja e Lekës
- b. Gruja e mbajtne mbi kunorë, kundra Fejet e kanujet të Lekës;
- c. Gruja e vajza e grabitme, e jasht-zakonshme kah Feja e kanuja;
- d. Martesa me provë kundra Fejet e kanuiet.

- Krahasoni mënyrat e martesës sipas Kanunit, me ato që përcakton sot Kodi i Familjes.
- Çfarë ndryshimesh vini re?
- Si ka ndryshuar koncepti i martesës nga koha e Mesjetës deri në ditët tona?

5. Shkrim i lirë:

-Studiuesi dhe mbledhësi i Kanunit, At Shtjefën Gjeçovi, mendon se *martesa sipas Kanunit asht nji kontratë ekonomike dhe jo dashnije.*

- Po ju si mendoni: *A është martesa thjesht një bashkim ligjor?*
Shkruani një shkrim argumentues-hulumtues me temë.

Shënim: Kjo detyrë mund të realizohet në klasë, por mund të trajtohet edhe si një punë kërkimore hulumtuese.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: • Ritet dhe këngët e motmotit • Vlerësimi i detyrave të shtëpisë		Situatat e të nxëniet: Ritet dhe këngët e motmotit	
Rezultatet e të nxëniet Nxënësi: -përcakton kuptimin për ritet dhe këngët e motmotit; -vlerëson rëndësinë e këngëve të motmotit; -grykon rreth vlerave letrare të këngëve dhe riteve përkatëse.		Fjalë kyç: Këngët e motmotit, kolendrat, dita e verës, rusicat, karnavalet etj.	
Burimet: • Krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • këngë rituale të ndryshme		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi - Ritet e motmotit	20 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	10 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	15 min
4.	Punë e pavarur	Diskutimi i detyrave të shtëpisë	30 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	10 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**• **Motivimi:**

Ora e mësimin mund të fillojë, duke lexuar materialin informues në rubrikën “Zgjerohet njohuritë” që bën fjalë për ditën e verës. Por mësimi mund të fillojë edhe me diskutimin për një festë tradicionale të zonës apo edhe një ceremoni që njihet mirë nga nxënësit, duke respektuar vlerat tradicionale dhe kulturore të çdo grupi etnik apo kulturor.

• Për të nxitur interesin dhe vëmendjen e nxënësve mund të kërkohet prej tyre të japin mendimin se çfarë dinë ata për ritet e motmotit dhe përse përdoren apo nëse përdoren ende rite të tilla.

Pyetje dhe diskutime**1. Ritet dhe këngët e motmotit kanë qenë kënduar në zanafillë prej të rriturve.**

- Pse sot ato kanë përfunduar si lojëra fëmijësh?

- Cili ka qenë qëllimi i këtyre riteve?
- Çfarë informacioni na japin këto këngë për zhvillimin e vetëdijes shoqërore dhe kulturës?

2. Përmendni disa prej festave tradicionale dhe riteve që zhvillohen në familjen tuaj.

- Përpiquni të shpjegoni kuptimin e këtyre riteve.
- Ndaluni tek elementët kryesorë të çdo riti: *uji* dhe *zjarri*.

3. Diskutoni për këngët dhe ritet e motmotit të krahinës suaj.

- A praktikohen këto rite edhe sot?
- Nëse nuk praktikohen ose praktikohen pak, pse?
- A ka krijime të reja sot?

2. Informacioni i ri:

Në këtë pjesë të orës së mësimi, nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme materialin e tekstit duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

- „**v**“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;
- „-“ vendoset në fund të informacionit, i cili është ndryshe me atë që e dini ju;
- „+“ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;
- „?“ informacion që për ju është i paqartë ose doni të dini diçka më shumë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst në formën e një diskutimi pasi të jetë lexuar dhe punuar materiali teorik informativ.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë do të punohet me diskutimin dhe vlerësimin e detyrave të dhëna orën/javën e kaluar për ninullat ose për shkrimin e lirë, i cili u trajtua në orën e mëparshme.

Mësuesi këtë orë e përdor edhe për të vlerësuar punën e portofolit të nxënësve të ndryshëm.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: Projekti lëndor		Situatat e të nxënit: Karnavalet e shkollës	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: - përgatit materiale për këngët rituale për Karnavalet; - mbledh informacion rreth zhvillimit të ceremonisë së Karnavaleve; - harton planin e veprimtarisë; - organizon punën dhe koordinon bashkëpunimin mes grupeve për zhvillimin e veprimtarisë.		Fjalë kyç: karnavalet, festime, tradita, maskat, karnavalet e shkollës etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për Karnavalet; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • këngë rituale të ndryshme për karnavalet.		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

MODEL MËSIMOR - PROJEKT LËNDOR**FUSHA:** GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**LËNDA:** LETËRSI ME ZGJEDHJE**KLASA:** XII**TEMA:** KARNAVALET E SHKOLLËS**QËLLIMI:** AFTËSIMI I NXËNËSVE PËR TË ORGANIZUAR NJË VEPRIMTARI PRAKTIKE MËSIMORE DHE ARGËTUESE DUKE VËNË NË ZBATIM NJOHURITË DHE INFORMACIONET E MARRA GJATË PROCESIT MËSIMOR**REZULTATET E PRITSHME TË TË NXËNIT:**

- **diskuton** rreth ideve për organizimin e veprimtarisë dhe ndarjes së punës në grupe;
- **hulumton** informacione, vlerësime, qëndrime rreth veprimtarisë dhe materialeve në tërësi;
- **përgatite paraqet me gojë dhe me shkrim** punimet e tij/saj përgjithësuere për veprimtarinë dhe organizimin e saj;

VEPRIMTARITË PËR ARRITJEN E REZULTATEVE:

NR.	VEPRIMTARIA (ORË MËSIMORE)	VLERËSIMI	PERSONI PËRGJEGJËS	AFATI
1.	Organizimi i punës dhe ndarja e grupeve	15%	Mësuesi/ja dhe nxënësit	Tremujori i parë
2.	Grumbullimi i materialeve dhe informacioneve	25%	Mësuesi/ja dhe nxënësit	Tremujori i dytë
3.	Paraqitja e veprimtarisë dhe organizimi i saj	60%	Nxënësit	Tremujori i tretë

VLERËSIMI:

Nxënësit do të vlerësohen gjatë këtij projekti për punën e kryer, duke pasur parasysh rëndësinë dhe vlerën e saj në përputhje me objektivat dhe qëllimet e vendosura në fillim të projektit.

- Për organizimin dhe ndarjen e punës, si edhe për idenë për veprimtarinë nxënësit do të vlerësohen me 15% të pikëve ose 15 pikë nëse do të përdoret sistemi i vlerësimit me 100 pikë.
- Për përgatitjen e skedave dhe të mbledhjes së materialit të rekomanduar përgatitjen e veshjeve apo maskave, nxënësi do të vlerësohet me notë me peshën 25%;
- Për përgatitjen dhe dhënien e veprimtarisë, nxënësi do të vlerësohet me notë me peshë 60%.

Shënim: Meqenëse puna do të ndahet dhe organizohet në grupe, është e rekomanduar që për secilin nxënës brenda grupit të kërkohet informacioni i detajuar rreth punës së tij, në formën e një relacioni.

Ndarja e punës sipas grupeve:

- Hartimi i skenarit për veprimtarinë.
- Puna për kostumet.
- Ndërtimi i maskave.
- Hartimi i grafikave dhe/ose fletëpalosjeve.
- Organizimi i skenës ose mjedisit.
- Këngët dhe / ose muzika etj.

Për secilin grup mund të përcaktohen nxënësit sipas aftësive ose organizohen vetë sipas mundësisë që kanë për të dhënë ndihmesën e tyre.

Kritere për vlerësimin e punës për projektin:

NR.	ELEMENTËT E VLERËSIMIT	PIKËT	VLERËSIMI
	Tema e projektit:	100 PIKË	
1.	MATERIALI	20 PIKË	
	a. Përfshirja e të gjitha çështjeve sipas ndarjes së punës në grup	(5 pikë)	
	b. Materiali i përbashkët për secilin grup	(5 pikë)	
	c. Materiali original i punës në grup	(5 pikë)	
	d. Material i veçantë (special, dokumente, krijime, foto etj.)	(5 pikë)	
2.	PUNA ME MATERIALIN	25 PIKË	
	a. Përpunimi i materialeve të mbledhura	(7 pikë)	
	b. Puna individuale e çdo nxënësi	(6 pikë)	
	c. Përgatitja e veshjeve, skenës, këngëve, maskave	(6 pikë)	
	d. Redaktimi letrar	(4 pikë)	
	e. Redaktimi gjuhësor	(2 pikë)	
3.	PARAQITJA SKENIKE	40 PIKË	
	a. Skenari	(10 pikë)	
	b. Skenografia	(10 pikë)	
	c. Interpretimi	(10 pikë)	
	d. Koreografia	(10 pikë)	
4.	PUNA NË GRUP	15 PIKË	
	a. Pasqyrimi i detajuar i punës së grupit	(5 pikë)	
	b. Ndarja e punës në grupe	(5 pikë)	
	c. Gjithëpërfshirja	(5 pikë)	

Përpara se të realizoni një projekt, është mirë të gjykoni rreth këtyre pyetjeve:

NR.	PYETJET RRETH ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT	PO/JO
1.	A është i mundshëm për t'u realizuar?	
2.	A ka të bëjë tema e projektit me situata nga jeta reale?	
3.	Ai i mundëson nxënësit zbatimin e njohurive të marra në një lëndë të një klase?	
4.	Ai i mundëson nxënësit zbatimin e njohurive të marra në një lëndë në disa klasa?	
5.	Ai i mundëson nxënësit zbatimin e njohurive të marra në disa lëndë?	
6.	A i kërkon nxënësit përdorimin e informacionit jo vetëm nga tekstet shkollore?	
7.	A merr më shumë kohë puna në terren nga puna në klasë?	
8.	A "zgjidh" një problem që ndeshet në jetën e përditshme?	
9.	A zhvillon të menduarit shkencor të nxënësve?	
10.	A zhvillon të menduarit kritik të nxënësve?	
11.	A zhvillon aftësitë komunikuese të nxënësve?	
12.	A zhvillon aftësitë organizuese dhe vetëmenaxhuese të nxënësve?	
13.	A zhvillon aftësitë e nxënësve për punën në grup?	
14.	A zhvillon aftësinë e nxënësve për të prezantuar gjetjet e projektit?	
15.	A vlerësohet rregullisht puna e nxënësit, duke përdorur metodën e portofolit?	

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: • Këngët e dashurisë		Situatat e të nxënit: Dashuria në poezinë popullore	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: - përcakton kuptimin për këngët popullore të dashurisë; - vlerëson rëndësinë e këngëve popullore të dashurisë; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve popullore të dashurisë.		Fjalë kyç: Lirika e dashurisë, dashuria dhe vdekja, vuajtja, konflikti etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • këngë popullore të dashurisë		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Këngët popullore të dashurisë	10 min
2.	Informacioni i ri	Leksioni i përparuar	30 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	15 min
4.	Punë e pavarur	Ditari tripjesësh	20 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	10 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

- **Motivimi:**
- Ora e mësimimit do të përqendrohet te këngët e dashurisë në lirikën popullore. Duke qenë se këto tematika do të zhvillohen për tri javë, sugjerohet që mësuesi të motivojë nxënësit të sjellin në klasë këngë të ndryshme folklorike.
 - Motivimi mund të fillohet përmes këngësh të ndryshme të lirikës popullore, duke shfrytëzuar folklorin e pasur të çdo zone.
 - Ora e mësimimit mund të fillojë edhe me vargjet e një poezie popullore të dashurisë, si ato që përmend edhe Kadare.

**Duro, vashë, të durojmë,
Si duron mali dëborën.**

Përmes këtyre vargjeve mund të zhvillohet bashkëbisedimi rreth konceptit të dashurisë në lirikën

popullore dhe përjetimin e dashurisë në këngët popullore.

- **Kujdes!** Sugjerohet të sqaroni për çdo rast nëse kënga i përket fondit të folklorit apo është thjesht një krijim i dikujt apo këngë e rrymës turbofolk. Për këtë është mirë të studiohet teksti dhe jo muzika.

2. Informacioni i ri:

Leksioni i përparuar

Kjo teknikë zhvillohet në etapën realizimit të kuptimit dhe procedohet në këtë formë:

1. Pjesëmarrësit bashkohen në dyshe.
2. Secila dyshe duhet të bëjë një listë të gjitha gjërave që ata i dinë për problemin (kjo bëhet për këtë, keni 4 minuta kohë).
3. Pas katër minutash, mësuesi u thotë dysheve që t'ua tregojnë edhe të tjerëve në grup ato që kanë gjetur, idetë shkëmbehen brenda grupit.
4. Shkruhet në dërrasë të zezë një listë me mendimet e nxënësve.
Para leximit, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit ta përcjellin listën e ideve dhe të shtojnë ide të reja në të.
5. Fillohet me leximin e pjesës së parë të leksionit (materialit të dhënë në tekst).
6. Mbahet lista përpara kur lexohet.
7. Pas leximit rishikohen listat, nëse ka gjëra që janë lexuar dhe i kemi në listë dhe cilat janë gjërat e reja që janë mësuar, radhiten në listë.
8. Në fund nga grupet kërkohen vullnetarë për të dhënë disa nga idetë e tyre.
Kështu bëhet paraqitja e asaj që është mësuar, duke përfshirë në procesin e të nxënësve pothuajse të gjithë nxënësit.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst në formën e një diskutimi, pasi të jetë lexuar dhe punuar materiali teorik informativ.

Pyetje dhe diskutime

1. Pse ndjenja e dashurisë paraqitet si një konflikt në poezinë popullore shqiptare?

- A është edhe në kohën e sotme kështu?
- Pse? Çfarë e shkakton këtë konflikt?

2. Diskutoni në klasë si shihet dashuria në mjedisin shoqëror ku jetoni ju.

- Cili është mendimi juaj?
- A është problem të dashurosh sot?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur: Ditari tripjesësh

Kjo teknikë është e bazuar në ditarin dypjesësh, por i vetmi dallim te ditari tripjesësh kemi plotësimin e shtyllës së tretë të ditarit.

Tekditari tripjesësh kemi shtyllën e parë, shtyllën e mesme, (të dytë) dhe shtyllën e tretë në të cilën bëhet arsyetimi i mendimit, përgjigjes, bëhet prova e detyrës, bëhet vizatimi, skema etj.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

Pyetja	Përgjigje	Argumenti
<ul style="list-style-type: none"> ◆ Si është dhënë në mënyrë artistike vdekja? ◆ Cili është roli i vargjeve që shërbejnë si refren? ◆ Çfarë efekti ka përsëritja e vargjeve: <i>N'odë të beqarit / Dy qilima shtruar</i> ? 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Vdekja është e pranishme, por askund e përmendur. Ajo që jep atmosferën e vdekjes është <i>oda e beqarit</i> në të cilën janë shtruar qilimat. 	<p><i>N'odë të beqarit</i> <i>Dy qilima shtruar.</i> <i>Më qafë na paçin,</i> <i>Kush na ka kallëzuar.</i></p>

Përmes kësaj teknike do të punohet detyra 3.

5. Reflektim: *Diskutim i lirë*

Dashuria dhe vdekja janë dy përbërësit kryesorë të poezisë popullore.

- Mendoni ju se kjo zgjedhje është rastësore dhe poetike apo e diktuar nga kushtet?

Detyrë shtëpie:

Sillni në klasë këngë të vjetra popullore të dashurisë që mund t'i keni dëgjuar të këndohen në familjen tuaj dhe diskutoni rreth tyre.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: ☰ Këngët e dashurisë		Situatat e të nxënit: Kulti i dashurisë dhe i bukurisë në poezinë popullore	
Rezultatet e të nxënit Nxënësi: - përcakton kuptimin për këngët popullore të dashurisë; - vlerëson rëndësinë e këngëve popullore të dashurisë; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve popullore të dashurisë.		Fjalë kyç: Lirika e dashurisë, kulti i dashurisë, kulti i bukurisë, portretizimi i femrës etj.	
Burimet: • krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • këngë popullore të dashurisë		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Këngët popullore të dashurisë	15 min
2.	Informacioni i ri	Karrigia e autorit	30 min
3.	Punë e pavarur	Diskutim në dyshe	25 min
4.	Reflektim	Shkrimi i lirë	15 min
5.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**• **Motivimi:**

Ora e mësimi sugjerohet të fillojë me diskutime apo leximin e këngëve popullore lirike të dashurisë që nxënësit kanë pasur detyrë shtëpie nga ora e mëparshme. Në rast se nuk kanë gjetur ose nuk kanë sjellë materiale, mund të jetë mësuesi që sjell në klasë këngë folklorike për dashurinë dhe diskuton rreth tyre për konceptet e trajtuara nga ora e kaluar.

2. Informacioni i ri:**Karrigia e autorit**

Kjo orë mësimi mund të realizohet përmes teknikës *“Karrigia e autorit”*, me qëllim nxjerrjen e paranjohurive të nxënësve për një problem:

a. Para nxënësve shtrohet problemi për të cilin ata do të shkruajnë *(Dashuria dhe Bukuria në lirikën popullore)*.

b. Formohen grupet me anëtare çift, 4 apo 6 anëtare ose punohet në çifte.

c. Për kohë të caktuar 10-15 min, ata shkruajnë në mënyrë të lirë për atë çfarë dinë për problemin, duke shkruar një rresht dhe lënë tjetrin rresht të fletës të zbrazët.

d. Pasi të përfundojnë së shkruari, çiftet shkëmbejnë fletoret në mes tyre dhe plotësojnë njëri-tjetrin me ide e informacione të reja.

e. Rikthehen fletoret, shikohet ajo që është shtuar nga shoku/shoqja, rregullohet apo shtohet

diçka nëse është e nevojshme.

f. Më pas, me radhë nga një nxënës nga secili grup, ulet në karrige para nxënësve të tjerë dhe e lexon atë çfarë ka shkruar

g. Më pas, nxënësit e tjerë, bëjnë pyetje apo paraqesin probleme të tjera, të cilat janë me rëndësi, por që nuk janë paraqitur gjatë leximit. Nxënësit që kanë lexuar, i shtojnë (shkruajnë) idetë e të tjerëve në fletoren e tyre.

Për t'u ndihmuar, nxënësve u sugjerohet të përdorin edhe materialin e tekstit mësimor.

ORA E DYTË

3. Veprimtari e pavarur: *Diskutim në çift*

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst në formën e një diskutimi, pasi të jetë lexuar dhe punuar materiali teorik informativ.

Pyetje dhe diskutime

1. Lexoni këngën popullore më poshtë:

*Kur vije rrëzës së malit,
Hajde, hajde, moj Mine,
Sa e bukura që je!
Duke mbajtur frenë e kalit,
Duke dhënë sisë djalit,
Derdhurë florinjte e ballit.*

*Kur vije rrëzës së fushës,
Hajde, hajde moj Mine,
Sa e bukura që je!
Duke mbajtur frenë mushkës,
Duke dhënë sisë çupës,
Derdhurë florinjte e gushës.*

- Gjeni detajet erotiket me të cilat është dhënë portreti i femrës.
- Cili është roli i vargut që shërben si refren në këtë këngë?

2. Analizoni strofat përbërëse të kësaj kënge.

Në secilën prej tyre mjedisi *mali* dhe *fusha* janë në një kundërvënie me njëri-tjetrin.

- Gjeni dhe shkruani detajet me të cilat lidhen këto mjedise me *djalin* dhe *vajzën*.
- Plotësoni tabelën e mëposhtme.

	DETAJET E PËRSHKRIMIT TË PORTRETIT TË FEMRËS
MALI - DJALI	- <i>kali, mali, balli (fjalë që shprehin lidhjen e të qenit mashkull me elementet mashkullore)</i>
FUSHA - ÇUPA	- <i>mushka, fusha, gusha (fjalë që lidhen me konceptin femëror)</i>

4. Reflektim: *Shkrim i lirë*

Dashuria dhe bukuria në poezinë popullore.

- Nxënësit orientohen të shkruajnë një paragraf të shkurtër të kësaj lidhjeje mbështetur në gjithë diskutimin që është zhvilluar në klasë.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: ☰ Studim teksti - lirika e dashurisë		Situatat e të nxënimit: Lirika e dashurisë	
Rezultatet e të nxënimit Nxënësi: - përcakton figurat stilistikore të përdorura në këngët erotike popullore; - vlerëson figuracionin e përdorur në këngët e dashurisë; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve popullore të dashurisë.		Fjalë kyç: Lirika e dashurisë, sakrifica, sfida ndaj realitetit, portretizimi i femrës etj.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • krijime të ndryshme lirike; • libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12); • këngë popullore të dashurisë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Përsëritje e njohurive	10 min
2.	Realizim kuptimi	Ruaje fjalën e fundit për mua	35 min
3.	Veprimtari e pavarur	Shkrim i lirë	35 min
4.	Vlerësimi		10 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- **Përsëritje e njohurive:**

Ora e mësimimit sugjerohet të fillojë në formën e një bashkëbisedimi dhe me leximin e materialeve që nxënësit kanë sjellë rreth këngëve popullore të dashurisë. Gjithashtu mund të lexohen detyrat e realizuara në klasë orën e kaluar ose të përfundohen ato në varësi të ecurisë së procesit të të nxënimit.

2. Realizim kuptimi:***Ruaje fjalën e fundit për mua***

Kjo teknikë krijon mundësi për të diskutuar rreth një teksti të dhënë siç është ai në librin e nxënësit, por nga mësuesit mund të përzgjidhen edhe këngë të tjera karakteristike të zonës.

a. Nxënësit udhëzohen që, gjatë leximit të tekstit, të përcaktohen për një apo më shumë pjesë (vargje) që për ata janë më interesantet ose më të bukurat.

b. Pjesët e zgjedhura dhe numri i vargjeve ku është marrë pjesa shkruhen në një fletë, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citatin (pse e ka zgjedhur atë pjesë, cili është mesazhi, rëndësia etj.).

c. Njëri nga nxënësit tregon vargjet e zgjedhura, i lexon ato, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit.

d. Pas leximit, të tjerët diskutojnë rreth citatit.

f. Në fund të diskutimit, nxënësi, i cili është përcaktuar për pjesën, lexon komentën e tij për atë

citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japin komente shtesë.

g. E njëjta ecure e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe te nxënës të tjerë.

Mësuesi sugjerohet të orientojë këtë veprimtari duke i ndihmuar nxënësit përmes pyetjeve dhe detyrave si më poshtë:

1. Si përjetohet në këtë këngë dashuria: kënaqësi dhe lumturi apo dhimbje dhe shqetësim?

2. Shpjegoni kuptimin e vargjeve të mëposhtme:

Kto qerpikt e syve tu,

Jan mehlemi i zemrës seme.

3. Cili është kuptimi artistik i epitetit “të ngratë”? Pse e quan kështu dashurinë?

4. Komentoni dy vargjet e fundit të këngës.

ORA E DYTË

3. Veprimtari e pavarur: *Shkrim i lirë*

Nxënësit do të punojnë gjatë orës së dytë për të dhënë mendimin e tyre përmes një eseje krahasim-kontrasti të këngës popullore të dashurisë dhe poezisë së Lasgush Poradecit.

1. Krahasoni këngën popullore të mësipërme, me këtë poezi erotike të Lasgush Poradecit.

-Gjeni motivet e përbashkëta dhe veçoritë e secilës prej tyre.

-Ndaluni te koncepti i dashurisë si një *ndjenjë* e pashpjeguar dhe *mall*.

-Pse dashuria shihet si *dhimbje* dhe *vuajtje*?

2. Te të dy krijimet, *dashuria* dhe *fshhtësia* janë të pandara.

-Krahasoni vargjet e fundit të krijimit popullor me strofën e fundit të poezisë së Poradecit.

4. Vlerësimi:

Në përfundim të shkrimit mund të lexohen disa prej krijimeve (komenteve), kurse për nxënësit e tjerë mund të vlerësohen si një detyrë klase me shkrim.

DETYRË PËR PORTOFOL

Mendoni përpara se të shkruani!

Shprehni mendimin tuaj me shkrim rreth temës:

Për të dashur të tjerët duhet para së gjithash të duam vetveten!

Pyetje për ndihmë dhe orientim:

- Si do ta kuptonit ju këtë pohim?
- Ç’përfaqëson për ju dashuria?
- Ç’do të thotë për ju të duash dikë?
- A mund të sakrifkohet gjithçka për dashurinë?

VI. Test, tremujori i parë dhe çelësi i zgjidhjes së tij*Test përmbledhës për folklorin - Folklori dhe Lirika popullore***I. Pyetje me zgjedhje, zgjidhni një prej varianteve të dhëna për çdo pyetje.****1. Folklori përmbledh krijimtarinë:**

- a. letrare të një populli
 b. artistike të një populli
 c. gojore të një populli
 d. muzikore të një populli

2. Karakteri anonim i një krijimi folklorik lidhet me faktin që ai është:

- a. me variante b. pa autor c. kolektiv d. i pavdekshëm

3. Bashkimi i njëkohshëm i disa elementeve në një krijim folklorik i jep atij tiparin:

- a. e kolektivitetit b. e improvizimit c. anonim d. sinkretik

4. Vajet janë këngë folklorike që bëjnë pjesë të :

- a. lirika shoqërore b. epika legjendare c. lirika familjare d. epika historike

5. Vargjet e mëposhtme:

Moj e bukura prej nurit

Si thëllëza moj, e gurit

O e shpejtë si shigjeta,

Ka do të shkojë jeta?

janë shkëputur nga një:

- a. ninullë b. vaj c. këngë dasme d. legjendë

6. Vargjet e mëposhtme:

Iu rritsh nanës e naltë me shtat,

T'u baft shtati si bajrak

E t'u mbushtë ftyra me gjak!

janë shkëputur nga një:

- a. ninullë b. vaj c. këngë dasme d. legjendë

II. Studim teksti:

Lirikë popullore e dashurisë

Syri yt dinaf i zi,

të vështron shajtuar,

aman, se më dogje xhanin,

vajzë e pamartuar-o!

Faqja jote borë e bardhë,

si kartë e pashkruar;

aman, se më dogje xhanin,

vajzë e pamartuar-o!

Buza jote, hoje mjalti,
po për të mëlcuar;
Aman, se më dogje xhanin,
vajzë e pamartuar-o!

Mjekra jote grop' e bardhë,
si filxhan i shkruar - o,
aman, se më dogje xhanin,
vajzë e pamartuar-o!

Gusha jote r Rathë-r Rathë,
me gjerdan mbuluar....!
...aman, se më dogje xhanin,
vajzë e pamartuar-o!

1. Në këtë lirikë është përshkruar me hollësi portreti i femrës.

-Dalloni në këtë lirikë elementet me të cilët është dhënë portreti i vajzës.

(5 pikë)

- a. _____;
- b. _____;
- c. _____;
- d. _____;
- e. _____.

-Cilat janë figurat themelore të stilistikës mbi të cilën është ndërtuar ky portret?

(2 pikë)

2. Përsëritja është një nga tiparet e lirikës popullore.

-Identifikoni vargjet që shërbejnë si refren në këtë këngë.

(1 pikë)

-Cili është funksioni i kësaj përsëritjeje?

(2 pikë)

-Çfarë roli luan metafora e përdorur në të?

(2 pikë)

3. Përmendni disa prej llojeve të lirikës popullore duke shpjeguar shkurtimisht çfarë trajtohet në to. **(6 pikë)**

- a. _____;
- b. _____;

- c. _____ ;
d. _____ ;
e. _____ ;
f. _____ ;

4. Argumentoni me shkrim, përmes një paragrafi argumentues, pse në lirikën erotike popullore *dashuria dhe vdekja* ndërthuren me njëra-tjetrën? (6 pikë)

Vlerësimi:

NOTA	4	5	6	7	8	9	10
PIKËT	0 - 7	8 - 11	12 - 15	16 - 19	20 - 23	24 - 27	28 - 30

Çelësi i përgjigjeve të testit, tremujori i parë**I. Variantet e sakta për çdo pyetje janë:**

- Ushtrimi 1 c.
- Ushtrimi 2 b.
- Ushtrimi 3 d.
- Ushtrimi 4 c.
- Ushtrimi 5 c
- Ushtrimi 6 a.

II. Çelësi i studim teksti:**1. Në këtë lirikë është përshkruar me hollësi portreti i femrës.**

-Dallonin në këtë lirikë elementet me të cilët është dhënë portreti i vajzës.

- a. syri (i zi);
- b. faqja (e bardhë);
- c. buza (e ëmbël);
- d. mjekra (e bardhë);
- e. gusha.

-Cilat janë figurat themelore të stilistikës mbi të cilën është ndërtuar ky portret?

Portretizimi i vajzës është realizuar përmes krahasimit që shërben edhe si figura kryesore e kësaj kënge dhe epitetit.

(si kartë e pashkuar; si filxhan i shkruar; borë e bardhë; gropë e bardhë)

2. Përsëritja është një nga tiparet e lirikës popullore.

-Identifikoni vargjet që shërbejnë si refren në këtë këngë.

*Aman, se më dogje xhanin,
vajzë e pamartuar-o!*

-Cili është funksioni i kësaj përsëritjeje?

Përmes kësaj përsëritjeje krijohet muzikaliteti dhe ritmi i këngës.

-Çfarë roli luan metafora e përdorur në të?

Ndjenja e dashurisë përziehet me dhimbjen, kjo realizohet përmes metaforës “më dogje xhanin”, e cila shpreh njëkohësisht nuancën e lumturisë, kënaqësisë, por edhe hijen e trishtimit dhe pamundësisë.

3. Përmendni disa prej llojeve të lirikës popullore, duke shpjeguar shkurtimisht çfarë trajtohet në to.

- a. këngët e motmotit;
- b. këngët e djepit (ninullat);
- c. këngët e dasmës;
- d. vajet;
- e. këngët e dashurisë;
- f. lirika shoqërore.

4. Argumentoni me shkrim përmes një paragrafi argumentues pse në lirikën erotike popullore dashuria dhe vdekja ndërthuren me njëra-tjetrën.

Për pyetjen ese mund do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI**(2 pikë)**

Mësuesi mund të vlerësojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë kërkesën e pyetjes;
- përcakton argumentet kryesore që lidhen me këtë çështje;
- i mbështet idetë e veta me shembuj ose argumente nga ato që janë trajtuar gjatë diskutimit në klasë.

KRITERI II: ORGANIZIMI I PËRGJIGJEVE**(2 pikë)**

Mësuesi mund të vlerësojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen;
- përdor detaje mbështetëse;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI III: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE**(2 pikë)**

Mësuesi mund të vlerësojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore;
- përdor si duhet shkronjën e madhe;
- përdor si duhet shenjat e pikësimit.

Modele të planifikimit ditor – Letërsi me zgjedhje 12 – Tremujori i dytë

JAVA I

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: • Lirika erotike e Lasgush Poradecit		Situatat e të nxënët: Analizë: <i>Ndikimi i folklorit në krijimtarinë e Poradecit</i>	
Rezultatete e të nxënët: • Nxënësi: - analizon motivet folklorike në krijimtarinë e Poradecit; - vlerëson rëndësinë e lirikës erotike të Poradecit dhe frymën popullore në të;		Fjalët kyçe: <i>Poezia erotike, ndikimi i folklorit, fryma popullore, mall, frymëzimi lirik, etj.</i>	
Burimet: • <i>Krijime lirike të Poradecit;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Fleta e punës për detyrën e portofolit.</i>		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Punë e drejtuar	Organizuesi grafik	20 min
3.	Punë e pavarur	Mendo – Krijë dyshe – Diskuto	15 min
4.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi¹:

• **Motivimi:**

• Ora e mësimimit mund të fillojë me dëgjimin e këngës “Kroj i fshatit tonë” të kënduar nga Tefta Tashko Koço dhe më pas të fillojë diskutimi për atë se çfarë ju pëlqen tek ajo.

• Këtë këngë mund ta shkarkoni në adresën e mëposhtme:

<https://www.teksteshqip.com/tefta-tashko-ko-o/lyric-1873087.php>

• *Lasgush Poradeci* është poeti lirik më i njohur në letërsinë shqipe që trajtoi me shumë forcë temën e dashurisë. Në të ai u mbështet te tradita popullore.

• U kërkohet nxënësve përmes bashkëbisedimit të rikujtojnë disa nga krijimet e tij ku duket më mirë mbështetja në folklor dhe ndikimi nga poezia popullore. Më pas, mësuesi mund të zgjedhë të trajtojë një prej poezive të tekstit ose të organizojë klasën në dy grupe duke punuar secili një prej poezive. Kjo detyrë mund të realizohet edhe si punë në çift/ dyshe.

Shënim:

• ***Në rast se për kushtet e klasës / shkollës apo nivelit të nxënësve nuk është e mundur të sigurohen materialet ndihmëse apo informacionet e kërkuara më lart, mund të punohet me materialin e tekstit mësimor të nxënësit faqe 54. Mësuesi orienton bashkëbisedimin ose e nxit atë duke përgatitur pyetjet e aparatit pedagogjik të tekstit.***

2. Punë e drejtuar:

• Lexohen në heshtje ose mund të dëgjohen edhe të interpretuara këto dy poezi dhe më pas jepen orinetime se si duhet të punohet me secilën prej tyre.

• Duke qenë se klasa do të ndahet në dy grupe (punë me çifte / dyshe), secilit grup i jepen

1. Nxënësit janë njohur me krijimtarinë e Lasgush Poradecit gjatë studimit në programin e letërsisë bërthamë. Gjatë kësaj ore mësimi do të punohet një prej krijimeve të tij ku ndikimi i traditës dhe folklorit është më i dukshëm.

detyra specifike duke shfrytëzuar edhe aparatën pedagogjik të tekstit.

- Përmes organizimit grafik, për secilën poezi ndërtohen skemat sipas tabelave përkatëse.

Kroj i fshatit tonë – punohet detyra 1 faqe 55

Poezia është e ndertuar në tri pjesë, të cilat fillojnë me vargun që i këndohet kroit.

- Gjeni dhe shkruani të gjitha hollësitë me të cilat i këndohet kroit në secilën pjesë.
- Plotësoni me to tabelën e mëposhtme.

	Pjesa I	Pjesa II	Pjesa III
Hollësitë e përshkrimit të kroit	- <i>ujë i kulluar;</i> - <i>dyke murmuruar;</i> - <i>mbushin ujë vashat;</i>	- <i>ngjyrë-ergjendi;</i> - <i>i rrëmbyer;</i> - <i>pinë ujë trimat;</i>	- <i>tetë sylynjarë;</i> - <i>kroj i parë;</i> - <i>s'ka të dytë;</i> - <i>shëron plagët;</i> - <i>shëron sytë;</i>

Baladë – punohet detyra 1 faqe 57

Poezia është e ndertuar në gjashtë pjesë. Në katër pjesët e para jepet imazhi poetik i stinëve.

- Gjeni për secilën pjesë fjalët kyç me të cilat përshkruhen stinët si edhe përjetimin e personazheve lirike

- Plotësoni tabelën e mëposhtme me këto hollësi.

Fjalët kyçe	Pjesa I (Pranvera)	Pjesa II (Vera)	Pjesa III (Vjeshta)	Pjesa IV (Dimri)
	<i>Fryn era, çeli molla, bel i hollë</i>	<i>Vap e rëndë, plasa, kalliri i pjekur</i>	<i>Shkojnë dallëndyshet, venitet zemra,</i>	<i>Fryn veriu, ngriva, duro vashë</i>
Përshkrimi i personazheve lirike	Vashën dhe Trimin tani i lidh një ndjenjë e fortë që ka çelur dhe pret të kurorëzohet me frytet e saj.	Vasha dhe Trimi duket se tani po kurorëzojnë lidhjen e tyre që është pjekur si kalliri i grurit.	Stina e dasmave duket se po i jep fund edhe vuajtjes dhe durimit.	Vasha dhe Trimi në fillimet e njohjes së tyre, ku përmes ndjenjës së të ftohtit përcillet emocioni dhe droja.

Pas kësaj pune, nxënësit ndihmohen për të kuptuar ndikimin e krijimtarisë popullore si edhe elementeve të marra nga tradita. Te poezia e parë, takimi i të rinjve në kroit e fshatit është një motiv që e gjejmë edhe te tradita arbëreshe, le të kujtojmë De Radën me “Këngët e Milosaos”, kurse te poezia e dytë, vetë personazhet e saj, Trimi dhe Vasha të kujtojnë personazhet e këngëve popullore të dashurisë dhe dasmës.

Dashuria paraqitet në një mjedis të identifikuar me ndjenjat e harmonizuara me shenjtërinë e natyrës. Ashtu si edhe në krijimtarinë popullore, një pjesë e madhe e figuracionit të përdorur për të përshkruar Vashën dhe Trimin janë marrë nga natyra.

3. Punë e pavarur:

Gjatë kësaj rubrike do të punohet në mënyrë të pavarur analiza e dy poezive sipas ndarjes së bërë në grupet dyshe.

Grupi i parë: **Kroj i fshatit tonë**

1. Analizoni secilën prej pjesëve të krijimi.

- Përshkruani secilën prej tyre sipas konceptit lirik që kërkon të transmetojë autori.
- Si lidhet *rrjedhja e kroit* me gjendjen emocionale që përshkruhet?

2. Rima dhe melodia e kësaj poezie duke sikur ndjekin rrjedhën e kroit.

- Studioni strukturën metrike të poezisë (*Ilojin e strofës, Ilojin e vargjeve, rimën dhe ritmin e saj.*

Grupi i dytë: **Baladë**

1. Balada ka mjaft nota idilike² të gërshetuara me nota romantike.

- Gjeni vargjet ku duken këto nota.

2. Në baladën popullore tek e cila është mbështetur autori, zotëron toni pikëllues: “Trimi dhe Vasha ikin fshehurazi nga fshati dhe shkojnë në një kishë të vogël në mal , për të vënë kurorë, por kisha s’e pranon lidhjen e tyre. Dera e saj mbyllet dhe ata plasin në prag të saj”; por në ndryshim nga tradita popullore, Lasgushi i ka dhënë baladës tonin optimist në pjesën VI.

- Cili është qëllimi i këtij ndryshimi?

- Si e vlerëson autori dashurinë dhe shenjtërimin e saj përmes martesës?

3. Analizoni përdorimin e foljeve në mënyrën në mënyrën dëshirore.

- Cili është funksioni stilistikor i këtij përdorimi?

4. Përgatitja e punës për detyrën e portofolit:

- Nxënësit do të orientohen se si duhet të përgatitin një skedë për të analizuar një krijim të Poradecit duke u mbështetur edhe te materiali i tekstit.

- Sqarohen nxënësit se si duhet ta përgatisin materialin në formë të shkruar duke vendosur edhe kriteret për të cialt ata do të vlerësohen.

- Nxënësit informohen për mënyrën e vlerësimit të punës së portofolit me pikë sipas tabelës së mëposhtme.

Vlerësimi i punës për portofolin³:

a) Realizimi i detyrës sipas të gjitha kërkesave dhe kriterëve të vendosura: - 25 pikë

b) Respektimi i etikës dhe profesionalizmi në realizimin e detyrës: - 10 pikë

c) Dorëzimi i detyrës në kohën e përcaktuar: - 5 pikë

d) Realizimi me shkrim i detyrës në formën e një eseje shpjeguese - argumentuese: - 10 pikë

Konvertimi i pikëve në nota⁴:

NOTA	4	5	6	7	8	9	10
PIKËT	0 – 12	13 – 22	23 – 28	29 – 34	35 – 40	41 – 44	45 – 50

5. Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen për pjesëmarrjen në orën e mësimit, për mendimet e dhëna si edhe punën dhe bashkëpunimin në çift/dyshe.

Shënim!

Për orën e ardhshme të mësimit, javën tjetër nxënësit orientohen ku të punojnë në tekstin mësimor dhe çfarë do të duhet të parapërgatitin për të sjellë në klasë.

Ata duhet të kërkojnë në burime të ndryshme, internet, libra apo tekste mësimore dhe të sjellin në klasë një informacion rreth Dritëro Agollit dhe krijimtarisë poetike të tij.

2. Idilike ka kuptimin e një krijimi letrar me nota baritore

3. Mësuesi është i lirë të vendosë kriterë të tjera shtesë ose të përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet mundi i çdo nxënësi.

4. Kjo është vetëm një tabelë orientuese, pasi mësuesi mund të zgjedhë vetë se çfarë sistemi vlerësimi mund të përdorë.

JAVA II

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Dritëro Agolli – Poezia e tij dhe mbështetja në lirikën popullore 		Situatat e të nxënit: Analizë-Koment: <i>Ndikimi i krijimtarisë popullore në lirikën e Dritëro Agollit dhe elementet e saj.</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon në tekste të ndryshme poetike veçoritë e lirikës së Dritëro Agollit; - vlerëson rëndësinë e ndikimit nga tradita popullore; - gjykon rreth vlerave të këtyre krijimeve. 		Fjalët kyçe: <i>Lirika e Dritëro Agollit, ndikimi i folklorit, fryma popullore, zakonet dhe vlerat, frymëzimi lirik, etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> <i>Krijime të ndryshme folklorike;</i> <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Vlerësimi i njohurive	Pyetje – përgjigje	15 min
3.	Punë e drejtuar	Lexim i drejtuar	25 min
4.	Punë e pavarur	Punë në dyshe. Diskutim – <i>Elementet e traditës në krijimtarinë e Dritëro Agollit</i>	20 min
5.	Reflektim	Shkrim i lire – ese	20
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- Motivimi:**

Ora e mësimin mund të fillojë me leximin e një pjese nga krijimtaria e Dritëro Agollit ose edhe me diskutimin rreth thënies së tij:

“Unë erdha në poezi nga kënga popullore, nuk erdha nga librat. Pastaj hyra në libra. Poezinë popullore, përrallën, humorin dhe të gjithë kulturën popullore nuk e mësova, por e jetova. Në fillim unë shkruaja si populli.”

- U kërkohet nxënësve të lexojnë materialin mësimor në tekst, faqe 60 dhe të diskutohet rreth tij si edhe për krijimtarinë e autorit.

- Bashkëbisedimi zhvillohet me librin hapur dhe nxënësit mund t'i referohen atij në çdo kohë.

2. Vlerësimi i njohurive:

- Në varësi të detyrave të dhëna gjatë orës së kaluar, kërkohet të lexohen ato nga nxënës të ndryshëm dhe të vlerësohen prej të tjerëve duke dhënë mendime rreth tyre.

- Mësuesi vlerëson kryerjen e detyrës për portofol të dhënë orën e kaluar, e cila mund të vlerësohet

edhe nga vetë nxënësit në formën e një diskutimi duke u mbështetur në kriteret e vendosura.

3. Punë e drejtuar:

Leximi i drejtuar:

- Pas vlerësimit të detyrës, mësuesi kalon në orën e parë tek punimi i poezisë së Dritëro Agollit “I përndjekuri i dashurisë”.
- Poezia lexohet dhe nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale rreth detyrave të dhëna në tekst dduke përdorur edhe fletoren e klasës ose të shënimeve.

- **Punohet rubrika “Kuptojmë tekstin”**

Punohen ushtrimet 1 – 2 faqe 61

Në poezinë e Dritëro Agollit, koncepti popullor për të bukurën shkrihet me të dobishmen.

Gratë janë të bukura për dashurinë të u falin burrave.

- Si përjetohet dashuria në këtë lirikë: *lumturi* apo *dhimbje*?

- Plotësoni tabelën e mëposhtme me këto hollësi.

Identifikoni në këtë lirikë fjalët kyçe që japin imazhin poetik të burgimit.

- Cili është *xhelati i dashurisë*: *dashuria* apo *e dashura*?

- **Punohet rubrika “Analizojmë tekstin” në të cilën punohen detyrat 1,2 dhe 3 faqe 61.**

Gjeni stilemat në lirikën e mësipërme.

- Emërtoni ato sipas llojit

- Komentoni funksionin e kuptimit të figurshëm të tyre.

- Çfarë qëndrimi të autorit shprehin ato?

Pse heroi lirik kërkon “burgimin e përjetshëm”?

Cili është kuptimi simbolik i “të përndjekurit” kundrejt “qelisë”?

Në përfundim të orës së parë, nxënësit mund të pyeten për të dhënë shpjegime e tyre si edhe duke i shënuar ato nga disa nxënës edhe në tabelë apo në fletë letre.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur

Mendo – krijo dyshe – diskuto:

- Gjatë orës së dytë, si vazhdim i tematikës së orës së parë, do të punohet poezia e dytë e dhënë në tekstin mësimor “Poemë për babanë dhe për veten”.
- Kjo poezi do të punohet përmes teksikës së punës dyshe dhe do të fokusohet në ndikimin e vlerave tradicionale dhe frymën popullore që ajo sjell.

Punohen detyrat 1 – 4 rubrika “Kuptojmë tekstin” – faqe 63

Kënga e parë e kësaj poeme përbëhet prej katër pjesësh.

- Përcaktoni për secilën pjesë nga një titull, nisur nga tematika e saj

- Pjesa e parë: *Shkrija e plotë me natyrën*

- Pjesa e dytë: *Përvoja jetësore*

- Pjesa e tretë: *Urtësia popullore e babait*

- Pjesa e katërt: *Kulti i punës (përpyekja për të rritur një brez të ri të zotin – që të mos ia hajë qeni shkopin)*

Identifikoni në pjesën e parë fjalët që lidhen me mjedisin, natyrën.

- Cili është mjedisi që përcaktohet përmes këtyre fjalëve?
- Çfarë përfytyrimi ju krijon ky mjedis?

Në pjesën e dytë jepet portretizimi i babait

- Si e jep autori babanë e tij?
- Çfarë kuptoni me shprehjen: *Udhë i hapte shkencëtari?*
- Cila është *abeceja* që duhet të mësojë së pari njeriu?

Shpjegoni kuptimin dhe rolin e përdorimit të shprehjes frazeologjike:

“Që mos ta hajë qeni shkopin, /Pëllumbi im, o djalë!”

Punimi i këtyre detyrave bëhet individualisht, kurse diskutimi bëhet duke marrë mendimin e të gjithë nxënësve dhe duke përfshirë sa më shumë prej tyre në forma të ndryshme si p.sh.: duke i pyetur nga vendi, duke kërkuar të punojnë në tabelë, duke marrë për të vlerësuar fletoren e shënimeve të klasës etj.

Po me këtë teknikë punohen edhe detyrat 1 – 4 të rubrikës “Analizojmë tekstin”

Figura e babait jep urtinë dhe pastërtinë shpirtërore të popullit.

- Identifikoni vargjet ku duket kjo.
- Ç’rol luan mjedisi ku e ka vendosur ai këtë personazh?

Agolli flet me dashuri dhe nderim për brezin e kaluar, për traditën e shëndoshë të popullit tonë, që, mendon ai, duhet mbajtur gjallë dhe duhet çuar më tej nga brezi në brez.

- Gjeni strofat dhe vargjet ku shprehet ky nderim?
- Çfarë vlere merr përvoja jetësore në këtë vlerësim?

Lexoni edhe njëherë vargjet e mëposhtme:

Pastaj babai në plis mbështetur

Këndonte fill i vetëm,

Sikur përpiquej për ta gjetur

Në këngë të vërtetën:

- Për cilën të vërtetë e ka fjalën autori?
- Ku duhen kërkuar vlerat e vërteta, sipas autorit?

Poezia ngre kultin e punës, e cila është pjesë e vlerave të urtësisë popullore në të cilën mbështetet edhe Agolli.

- Cila është vlere e punës dhe rëndësia e saj?
- Pse duhet nderuar njeriu i punës?
- Cilat vlere të traditës popullore duhen ruajtur, respektuar dhe përcjellë nga brezi në brez?

5. Reflektim**Shkrim i lirë:**

Në pjesën e dytë orës së dytë sugjerohet të punohet rubrika e esesë, por në rast se nxënësit nuk kanë mundur të realizojnë të gjitha detyrat gjatë kësaj orë, vazhdon diskutimi dhe kjo detyrë jepet si detyrë shtëpie dhe vlerësohet si punë me shkrim, rubrika “Shkruajmë” faqe 61. Orientohen nxënësit të shkruajnë një tekst jo më shumë se 300 fjalë.

Ashtu si në lirikën popullore, dashuria është një dhimbje e bukur.

- Krahasoni këtë poezi me një lirikë popullore të dashurisë.
- Çfarë ngjashmërie vini re në përmbajtje?
- Po në ndërtimin e vargjeve?
- Nxënësit do të orientohen se si duhet të përgatitin esenë duke i sqaruar për kriteret e saj.
- Sqarohen nxënësit se si duhet ta përgatisin materialin në formë të shkruar apo elektronike duke vendosur ndoshta edhe një numër të caktuar fjalësh. .
- Nxënësit informohen për mënyrën e vlerësimit të punës së portofolit me pikë sipas tabelës së mëposhtme.

Skema e vlerësimit:

ARGUMENTI	STRUKTURA E ESESË	PASURIA GJUHËSORE	LARMIA SINTAKSORE	SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE	PIKËT TOTALE
30 pikë	10 pikë	20 pikë	20 pikë	20 pikë	100 pikë

6. Përgatitja e punës për detyrën e portofolit¹:

DETYRË PËR PORTOFOL

Lirika e Dritëro Agollit, me karakterin e saj konkretizues krijon imazhe poetike mbresëlënëse.

Mbështetur në këtë këngë të poemës, krijoni një tablo sipas imazhit poetik të mjedisit baritor që përcillet aty duke e shprehur këtë në një prej formave të mëposhtme:

- Ese përshkruese
- Vizatim (grafikë) ose pikturë
- Melodi (duke u mbështetur në bukurtingullimin e saj)
- Aplikacion tjetër vizual

Vlerësimi i punës për portofolin²:

Konvertimi i pikëve në nota:

NOTA	4	5	6	7	8	9	10
PIKËT	0 – 12	13 – 22	23 – 28	29 – 34	35 – 40	41 – 44	45 – 50

1 Kjo detyrë për portofol së bashku me detyrën e radhës së kaluar, analiza koment nga krijimtaria e Dritëro Agollit do të jepen me zgjedhje për nxënësit, duke u lënë atyre, sipas dëshirës të zgjedhin se cilën prej detyrave do të dëshironin të kryenin.

2 Mësuesi është i lirë të vendosë kritere të tjera shtesë ose të përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet mundi i çdo nxënësi.

JAVA III

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Këngët e vajit 		Situatat e të nxëniet: Bashkëbisedim: <i>Koncepti për vdekjen në traditën popullore</i>	
Rezultatete e të nxëniet: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton tiparet dhe formën gjuhësore të vajeve në krijimtarinë popullore; - vlerëson rëndësinë dhe vlerat e vajeve; - gjykon dhe interpreton rolin e këtyre krijimeve në trajtimin e vdekjes në traditën shqiptare. 		Fjalët kyçe: <i>vajet, gjama e burrave, dhimbja, kulti i vdekjes etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme folklorike (vaje dhe gjama);</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Materiale nga interneti</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Psikologjia • Antropologjia 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	10 min
2.	Diskutim	Pyetje – përgjigje për vajtimin dhe traditën e tij	15 min
3.	Informacioni i ri	Leximi i drejtuar	20 min
4.	Punë e pavarur	“Ruaje fjalën e fundit për mua”	25 min
5.	Reflektim	Shkrim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- Motivimi:**

Kjo orë mësimore mund të fillojë me motivimin e nxënësve për të folur dhe diskutuar rreth traditës së vajtimin dhe riteve të vdekjes. Si një prej pjesëve të jetës, edhe vdekja duhet trajtuar si diçka e natyrshme dhe duhet të konceptohet si një vazhdimësi e jetës. Biseda mund të fillojë me zakonet dhe ritet se si zhvillohen ceremonitë mortore në familjet e nxënësve dhe shpjegimin e domethënies së tyre. Por biseda mund të fillojë edhe me materialin “Gjama e burrave” në faqen 69. Përmes tij nxitet diskutimi për të vijuar me tradita të zonës përkatëse nga janë nxënësit.

2. Informacioni i ri:

Në këtë pjesë të orës së mësimin nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale materialin e tekstit duke e lexuar atë fillimisht në heshtje dhe më pas duke diskutuar rreth tij. Kjo pjesë e mësimin lidhet në mënyrë integrale me fillimin e mësimin pa krijuar shkëputje.

Diskutimi i mësimin pasohet edhe me njohuritë rreth traditës së vajtimin dhe kodifikimit të saj në Kanunin e Lek Dukagjinit.

ORA E DYTË

3. Punë e pavarur:

- Teknika “*Ruaje fjalën e fundit për mua*” përdoret për të bërë komentin dhe vlerësimin e gjamës së dhënë në tekst faqe 67.
 - Secili nxënës pasi lexon disa vargje apo gjithë këngën jep mendimin e vet për përmbajtjen, veçoritë stilistikore si edhe elementet e ritit.
 - Në fund, mësuesi ose në rastin më të mirë një nxënës tjetër bën saktësime, sqarime dhe/ose plotësime për mendimet e dhëna dhe njëkohësisht edhe vlerësimin e tyre.
 - Mësuesi drejton punën për përgjigjen e pyetjeve si më poshtë:
 - Si shprehet dhimbja e nënës për bijën e vvarë e vdekur?
 - Çfarë roli luan pyetja retorike?
 - Identifikoni epitetet dhe i komentoni ato.
- Në vargjet e fundit nëna i jep bijës së vdekur disa porosi.
- Çfarë kuptojmë për mënyrën se si shihet vdekja?

4. Shkrim i lirë

Duke i mbështetur në materialin e tekstit, faqe 68 ku janë dhënë disa fragmente nga “Iliada” e Homerit dhe “Epi i Gilgameshit”, nxënësit lihen të lirë të punojnë me shkrim një ese krahasuese për të përshkruar ngjashmërinë dhe të veçantat e vajtimit të shqiptarët, sipas përshkrimit të bërë në Kanunin e Lek Dukagjinit si edhe mënyrave me të cilat është dhënë ky vajtëm në këto krijime nga më të njohurat dhe më të vjetrat e letërsisë botërore. Për të ndihmuar nxënësit mund të jepen edhe disa pika orientimi si më poshtë:

- *Identifikoni atë që vajton*
- *Identifikoni atë që vajtohet*
- *Krahasoni ritet që shoqërojnë vajet*
- *Përshkruani përjetimin e ligjëruesit*
- *Identifikoni mjetet gjuhësore dhe stilistike*
- *Krahasoni konceptin e vdekjes*

Vlerësimi i punës:

Mësuesi është i lirë të vendosë kritere të ndryshme për vlerësimin e punës ose të përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet munda i çdo nxënësi.

JAVA IV

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Andon Zako Çajupi – Lirika e dashurisë 		Situatat e të nxënimit: Analizë: <i>Lirika erotike e Çajupit dhe ndikimi i saj nga folklori; Cikli “Dashuria” dhe “Vajet”.</i>	
Rezultatete e të nxënimit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton veçoritë dhe ndikimin e folklorit në krijimtarinë e Çajupit; - vlerëson ndikimin e folklorit në ciklin “Dashuria” dhe “Vajet”; - gjykon rreth vlerave të lirikës së Çajupit dhe ndikimin e saj nga tradita popullore. 		Fjalët kyçe: <i>Lirika e dashurisë, Çajupi, ndikimi nga folklori, Vajet, etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme folklorike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Cikli “Dashuria”.</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Informacioni i ri	Çajupi dhe lirika e tij	15 min
3.	Punë e drejtuar	Analizë – Koment	25 min
4.	Shkrim i lirë	Ese përshkruese	10 min
5.	Punë e pavarur	“Ditari dy/tri pjesësh”	30 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- **Motivimi:**

Për këtë orë mësimi mësuesi mund të motivojë nxënësit ose të fillojë orën e mësimimit me ndonjë lexim nga lirika e Çajupit ose edhe nga cikli “Dashuria”, fragment apo edhe me një diskutim të shkurtër rreth kësaj vepre.

Në rast se nxënësit nuk e njohin autorin dhe veprën, është mirë të bëhet kjo paraqitje, por pa u ndalur shumë tek hollësi të jetës, vetëm si një kontekst kulturor, historik, letrar dhe social.

2. Informacioni i ri:

Nxënësi orientohet të punojë me materialin e tekstit faqe 70 për të njohur disa prej veçorive kryesore të lirikës së Çajupit. Njëkohësisht nga mësuesi mund të jepet një informacion i përmbledhur i veçorive të lirikës së tij si p.sh.:

- **Tematika** (rimori motive nga folklori)
- **Leksikun** (fjalori i tij me ndikim nga dialekti i jugut)
- **Figuracioni** (figuracioni i folklorit i cili u gjallërua në krijimet e tij)
- **Llojin e rimës dhe vargut** (vargu tetërokësh)
- **Zakone dhe doke** (gjykimi mbi dukuritë shoqërore nga këndvështrimi i filozofisë dhe mendësisë popullore)

- **Konceptin e dashurisë** (reale dhe e preکشme si në krijimet popullore)

3. Punë e drejtuar – *Analizë-Koment*

Në pjesën e dytë të orës së parë do të punohet Studim teksti 1 – faqe 71, “Dashuria” fragmenti i shkëputur nga cikli “Dashuria”.

Mësuesi do të ndihmojë nxënësit për të analizuar dhe komentuar këtë fragment duke u mbështetur edhe nga aparati pedagogjik.

Kuptojmë tekstin

1. Në ciklin “Dashuria”, Çajupi u ndikua nga Naim Frashëri dhe vendos konceptin e *dashurisë* përballë konceptit të *Perëndisë*.

- Çfarë raporti ka dashuria dhe Perëndia tek Çajupi?

Dashuria dhe Perëndia shihen njësoj te ky krijim: (Do të lëvdoj dashurinë / Barabar me Perëndinë)

- Kujt i këndon ai: *ndjenjës së dashurisë në vetvete* apo *përjetimeve të tij konkrete*?

Çajupi është konkret në trajtimin e ndjenjës së dashurisë dhe kështu që ai i këndon përjetimit konkret të kësaj ndjenje.

Digjem, përvëlohem

se të dua shumë,

ditënë mendohem,

natën rri pa gjume

2. Vuajtja nga dashuria shprehet me nota romantike.

- A është dashuria e tij platonike? Pse?

Vuajtja e tij është romantike, pasi ai e përjeton atë konkretisht, por nuk është platoni. Strofa “E” është konkretizimi dhe materializimi i këtij koncepti.

3. Ideali i gruas për Çajupin është gruaja shqiptare, e veçanërisht vajza zagoriote.

- Cilat janë tiparet e saj fizike?

- Me kë portret nga krijimtaria popullore ju përngjason ky përshkrim?

Tiparet fizike i shohim te strofa “E” dhe ky portret duket i ngjashëm me Tanushën e krijimatrixë popullore.

4. Shkrimi i lirë: Identifikoni *krahasimet*, *epitetet* me të cilat është përshkruar gruaja.

- Përshkruani shkurtimisht portretin e saj në një paragraf.

Kjo detyrë realizohet në klasë në përfundim të orës së parë ose, nëse ora është 90 minuta në fund të saj.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

• Teknika “*Ditari dy/ tri pjesësh*” përdoret për të bërë komentin dhe vlerësimin e fragmentit të dhënë në tekst nga “Vajet” – faqe 73 - 73.

• Secili nxënës pasi lexon disa vargje apo gjithë fragmentin jep mendimin e vet për përmbajtje, veçoritë stilistike si edhe ndikimin e saj nga folklori mbështetur tek motivet e dhëna më lart, duke përcaktuar se cili prej këtyre motiveve duket në këtë fragment.

• Nxënësi, çdo nxënës, punon individualisht në tekst duke e ndarë fletën e fletoren në dy pjesë. Në njërin prej tyre shënon komentin e vet, apo mendimin e vet mbështetur në ushtrimet dhe detyrat e tekstit dhe më pas, në pjesën tjetër shënon mendimet, komentet, vlerësimet e dhëna nga shokët të cilët i diskutojnë ato në klasë gjatë orës së dytë të mësimi.

- Në rast se do të përdoret ditari tri pjesësh, në pjesën e tretë do të mbahen shënimet për mendimet apo sugjerimet e dhëna nga mësuesi. Kështu, gjatë kësaj ore nxënësi është përfshirë dhe njëkohësisht ka marrë informacionin e plotë për fragmentin.

- Mësuesi drejton punën për përgjigjen e pyetjeve si më poshtë:

Ditari dy/tri pjesësh:

Mendimet e nxënësit	Sugjerimet dhe mendimet e shokëve	Komenti i mësuesit

Kuptojmë tekstin

1. Cilat janë faktet reale që ngre poeti në këtë poezi?

2. Gjeni dhe nënvizoni vargjet ku shprehet:

- *malli për gruan e vdekur*

*Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam parë,
lotët që kam derdhur s'më janë dhe tharë!
Shumë vjet u bënë, sot u mbushën dhjetë,
që kur më ke lënë dhe s'të shoh në jetë!*

- *rëndësia e dashurisë së nënës për fëmijën*

*Me se rrojnë foshnjat? Ç'i rrit çilimitë?
Dashuria e mëmës dhe përkëdhelitë.*

- *vetëndërgjegjësimi për t'iu përshtatur realitetit*

*Gjith' humbasën gruan, mëmën e babanë,
po ata që mbetën si ti nukë qanë:
të vdekurin lotët s'e bien në jetë,
po lutu dhe falu të rriç djalën vetë.*

3. Vuajtja e heroit lirik është e dyfishtë. Ai vuan:

- dramën e bashkëshortit të mbetur i vetëm*

*O zot, të jam falë, mos më le të mjerë,
dërgom' Evgjeninë ta shoh dhe një herë!*

- dramën e babait të një fëmije jetim*

*O zot i vërtetë, s't'erdhi keq për djalë,
kur i more mëmën dhe më le të gjallë?
Të më keshe marrë, do të qe më mirë
dhe të rronte mëma, të rriste të birë.*

Përkthyeri këtu vuajtje duke e ilustruar mendimin me vargjet përkatëse.

Analizojmë tekstin

1. Elegjitë apo edhe vajet krijohen në çastin kur vdes njeriu i dashur, ndërsa Çajupi këtë cikël e ka krijuar dhjetë vjet pas vdekjes së Evgjenisë, gruas së tij.

- Çfarë tregon kjo për lidhjen e tyre shpirtërore?
- A mund ta quajmë këtë krijim dashurie?

2. Në vargjet e mëposhtme:

*Me se rrojnë foshnjat? Ç'i rrit çiliminjtë?
Dashuri e mëmës dhe përkëdhelitet...*

- Çfarë e shtyn poetin të mendojë kështu?
- *Mendësia e mashkullit*
- *Këndvështrimi i ri nga e sheh gruan*
- ***Dhembshuria për foshnjën që rritet jetim***
- *Dëshira për t'i shpëtuar përgjegjësisë atërore*

3. Në vargjet: Pse s'kuvendon mirë....deri në fund ndihet konflikti ndërmjet zërit të arsyes dhe zërit të shpirtit.

- Cili prej zërave fiton?
- Ç'tregon kjo për natyrën dhe botëkuptimin e poetit?

Në fund të krijimit duket se zëri i arsyes e bën të kthjellohet dhe të mendojë se dhimbja dhe vajtimi nuk janë zgjidhja për të rritur një fëmijë jetim, ndaj ai nuk beson më te mrekullitë apo bestytnitë. Por kjo tregon edhe njëherë për botëkuptimin e tij të drejtë në lidhje me konceptin e vdekjes e cila, edhe pse është një dhimbje shumë e madhe, është pjesë e jetës dhe vazhdimësisë së saj. Koncepti i cili shfaqet edhe në krijimtarinë popullore.

Detyrë shtëpie:

Mësuesi mund të zgjedhë të japë si detyrë shtëpie kërkesën e mëposhtme, nëse kjo nuk mund të realizohet gjatë orës së mësimin në klasë ose të japë kërkesën e dhënë në tekst faqe 73.

Krahasoni ciklin “Bukuria” të Naim Frashërit me ciklin “Dashuria” të Çajupit.

- Cilat janë të përbashkëtat në trajtimin e kësaj teme nga të dy poetët?
- Cili prej tyre është më konkret?
- Ku duket ndikimi i folklorit në secilin prej këtyre krijimeve?

STUDIM HULUMTUES:

Mendoni përpara se të shkruani!

Shprehni mendimin tuaj me shkrim rreth temës:

Lirika erotike e Çajupit dhe lidhja e saj me krijimtarinë popullore

Pyetje për ndihmë dhe orientim:

- ★ Si ka ndikuar folklori në lirikën erotike të Çajupit?
- ★ A mund të themi se ai ka imituar këtë krijimtari?
- ★ Sa ka ndikuar jeta vetjake në këtë krijimtari?
- ★ Në ç'kuptim lirika erotike e Çajupit shtrihet në planin patriotik, shoqëror dhe moral?

Shënim!

Ky punim do të punohet në një orë të veçantë në varësi të planifikimit vjetor dhe kërkesës që ka programi.

Vlerësimi i tij mund të përfshihet në vlerësimin e vazhduar ose edhe në formën e vlerësimit përmbledhës për tremujorin e parë.

Këtë vendim e merr mësuesi në varësi të nivelit dhe mundësive që ofron mjedisi i klasës dhe shkollës.

AVA V

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Epika popullore – Këngët legjandare të murosjes • Studim teksti – Kënga e kalasë 		Situatat e të nxënit: Diskutim dhe analizë: <i>Legjendat dhe këngët epike legjandare</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin për epikën popullore dhe format e saj; - vlerëson rëndësinë e këngëve legjandare të murosjes; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve epike legjandare. 		Fjalët kyçe: <i>Epika popullore, legjendat, këngët e murimit, leximi simbolik, etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Epika legjandare</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi – Krijimet epike folklorike	10 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	10 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	25 min
4.	Punë e pavarur	Ditari dy pjesësh	25 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	15 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- **Motivimi:**

Kjo orë mësimore do të zhvillohet mbështetur në njohuritë nxënësve rreth folklorit të cilat janë trajtuar në klasën X. Mësimi mund të fillojë edhe me leximin e ndonjë fragmenti nga këngët legjandare folklorike apo pjesë të tjera të njohura si edhe mund të kërkohen nga vetë nxënësi të sjellin krijime të tilla.

- Për të nxitur interesin dhe vëmendjen e nxënësve mund të kërkohet prej tyre të japin mendimin se çfarë dinë për epikën popullore dhe veçoritë e këtyre këngëve.

- Mësuesi sugjerohet ta fillojë mësimin me materialin plotësues rreth toponimisë për Kalanë e Rozafës dhe informacionet që nxënësit kanë për të. Duke u nxitur interesi dhe vëmendja kalohet gradualisht në tematikën e re të orës së mësimin.

2. Informacioni i ri:

Në këtë pjesë të orës së mësimin nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme materialin e tekstit faqe 78 duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

„√“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;

„-“ vendoset në fund të informacionit i cili është ndryshe me atë që e dini ju;

„+“ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;

„?“ informacion që për ju është i pa qartë ose doni të dini diçka më shumë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst në formën e një diskutimi pasi të jetë lexuar dhe punuar materiali teorik informativ.

Pyetje dhe diskutime

1. Legjendat dhe këngët legjendare ngjajnë shumë me përrallat, megjithatë, ato ndryshojnë prej tyre.

- Cili është ndryshimi mes legjendave dhe përrallave?
- A vazhdojnë të krijohen edhe sot legjenda? Po përralla?
- Argumentoni përgjigjet tuaja duke konkretizuar me krijime konkrete.

2. Erik From, në veprën e tij “Gjuha e harruar”, shkruan: “Në gjuhën e simboleve, përvojat brendshme, ndjenjat dhe mendimet shprehen si të ishin përvoja shqisash, ngjarje të botës së jashtme.”

- Gjeni një legjendë dhe shpjegoni gjuhën e simboleve të saj.
- Si materializohen në të përvojat e brendshme, ndjenjat dhe mendimet me përvojën shqisore?

3. Nisur nga interpretimi bashkëkohor i legjendës së lashtë të murosjes, studiuesit përdorin ermin “Kompleksi i Rozafës”.

Me këtë koncept përqasin qëndrueshmërinë e institucioneve politike në Shqipëri, në analogji me ndërtimin e kalasë së Rozafës.

Diskutoni në klasë këtë interpretim duke u mbështetur në elementet e më poshtme simbolike të legjendës:

- Nevoja për drejtim dhe vendimmarrje nga një figurë atërore;
- Mungesa e organizimit të tre vëllezërve;
- Inferioriteti i vëllait të vogël;
- Sakrifikimi i figurës së një gruaje.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë do të punohet me studimin e legjendës “Kënga e kalasë” të dhënë në librin e nxënësit faqe 81. Mësuesi është i lirë që të trajtojë edhe ndonjë varian tjetër të kësaj kënge sipas dëshirës apo mundësisë që ka apo edhe materiale që mund t’i kenë sjellë vetë nxënësit.

Kuptojmë tekstin

1. Kjo këngë legjendare flet për një zakon shumë të lashtë, që sot, nuk është më.

- Nga se mendoni ju se mund të ketë lindur një zakon i tillë?
- Si është zëvendësuar sot ky lloj riti? Konkretizoni mendimin me shembuj konkretë nga jeta e përditshme.

2. Këngëtari popullor duke se nuk e miraton këtë zakon barbar.

- Identifikoni vargjet ku del qëndrimi i tij në këtë këngë
- A mendoni se elementi lirik i këtij krijimi është një argument për qëndrimin e autorit?
- Po zgjedhja e flijimit të nënës së re a ka ndikim në këtë qëndrim?

Analizojmë tekstin**1. Përsëritja epike është një karakteristikë e krijimeve popullore.**

- Gjeni vargjet apo fjalët që përsëriten në këtë legjendë.
- Çfarë funksioni luan kjo teknikë rrëfimi?

Kujtojmë se këngët janë kënduar nga rapsodë të cilët duhet t'i mbanin mend të gjitha vargjet.

2. Kënga legjendare e mësipërme është ndërtuar përmes teknikës së zhveshjes së subjektit, d.m.th., pa përdorur shumë hollësi.

- Ku duket kjo në këtë këngë?
- Nëse do të përdornit ju teknikën e pasurimit të subjektit, çfarë hollësi do të shtonit?

3. Bëni analizën metrike të kësaj kënge.

- A janë të gjitha vargjet e saj me rimë?
- A ka raste të rimës së brendshme?

5. Diskutim:

- Riti i flijimit të vajzave është i njohur jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe në letërsinë antike dhe mitologjinë greke. Agamemnoni flijoi Efigjeninë për t'iu prirë e mbara anijeve greke në Luftën e Trojës

- Krahasoni këto dy rite duke treguar ngashmërinë mes tyre dhe të veçantën e legjendës shqiptare.

Shënim!

Ky diskutim sugjerohet të zhvillohet duke pasur parasysh se nxënësit kanë studiuar në klasën X "Iliadën" dhe kanë njohuri për flijimet që përdreshin në antikitet për ta pasur mbarësi apo sukses në një betejë apo luftë dhe për të pasur me vete bekimin e zotave.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

JAVA VI

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Këngët legjendare të rinjohjes (rinjohja e burrit me gruan dhe motrës me vëllain) Studim teksti – Këngë e Ymer Agës dhe Gjon Pretikës 		Situatat e të nxënit: Analizë – Koment: <i>Këngët legjendare të rinjohjes dhe interpretimi i simbolikës së tyre.</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin për këngët legjendare të rinjohjes dhe variantet e tyre; - vlerëson rëndësinë e këngëve epike legjendare dhe llojet e tyre; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve legjendare të rinjohjes. 		Fjalët kyçe: <i>Këngët e rinjohjes, Ymer Aga, Gjon Pretika, incesti i pakryer, simbolike e tyre etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> <i>Këngët legjendare të rinjohjes</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi – Rimarrje e njohurive	5 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	15 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	25 min
4.	Punë e pavarur	Ditari dy pjesësh	20 min
5.	Reflektim	Shkrim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

• **Motivimi:**

Ora e mësimi mund të fillojë duke rimarrë njohuritë e mëparshme rreth këngëve legjendare ose duke diskutuar detyra të lëna nga ora e kaluar. Më pas kalohet gradualisht në tema e re që ka të bëjë me këngët legjendare të rinjohjes.

Nxënësit mund të lexojnë informacionin e ri në faqen 84 dhe faqen 86 që ka të bëjë me këngët e rinjohjes dhe llojet e tyre.

2. Informacioni i ri:

Në këtë pjesë të orës së mësimi nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme materialin e tekstit duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

„√“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;

„-“ vendoset në fund të informacionit i cili është ndryshe me atë që e dini ju;

„+“ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;

„?“ informacion që për ju është i pa qartë ose doni të dini diçka më shumë.

Pas përfundimit të kësaj veprimtarie mësuesi orienton nxënësit se si do të procedohet më tej.

Gjatë orës së parë në vazhdim do të punohet me studim teksti kënga e Ymer Agës, faqe 85 dhe orën e dytë studim teksti kënga e Gjon Pretikës, faqe 87. Por mësuesi mund të organizojë këto dy orë mësimore edhe si punë me grupe duke i ndarë këto dy këngë për studimin e tyre në dy grupe.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë këngën e dhënë në tekst faqe 85 “Ymer Aga” të cilën pasi e lexojnë, përmes bashkëbisedimit ose teknikës pyetje përgjigje, do ta punojnë përmes kërkesave të dhëna në aparatën pedagogjik të teksit si më poshtë.

Kuptojmë tekstin**1. Kjo këngë legjendare e rinjohjes trajton takimin pas shumë vitesh të burrit me gruan.**

- Cili është shqetësimi i i Ymer Agës?
- Si e bind ai krajin për ta liruar?

2. Në këtë këngë si në të gjitha krijimet legjendare, përzihen elementet reale me ato fantastike.

- Identifikoni këto elemente në këngën e Ymer Agos.
- Çfarë funksioni ka përdorimi i tyre?

3. Rinjohja në këngë realizohet përmes disa shenjave.

- Cila është shenja e njohjes në këtë këngë?

Analizojmë tekstin**1. Në këtë këngë legjendare vihen re dy prej vlerave më të rëndësishme kombëtare të shqiptarëve: *fjala e dhënë dhe besnikëria bashkëshortore.***

- Cili është shqetësimi i i Ymer Agës?
- Si e bind ai krajin për ta liruar?

2. Lexoni me kujdes vargjet e pjesës së parë të këngës.

- Si portretizohet në to figura e Ymer Agës?
- Ç’rol luan dialogu i përdorur në të?

3. Disa studiues, duke u bazuar në ngjashmëritë që kanë dy veprat nga ana e subjektit, kanë menduar se kënga legjendare e Ymer Agos, është e lidhur me poemën e Homerit “Odisea”.

- Tregoni ku i shikojnë këto ngjashmëri studiuesit.
- Çfarë të veçante i ka dhënë këngëtari popullor kësaj kënge?

Në përfundim të kësaj veprimtarie që është parashikuar të mbarojë orën e parë, do të kalohet në orën e dytë me studimin e tekstit “Gjon Pretika” faqe 87.

ORA E DYTË**4. Punë e pavarur:**

Gjatë orës së dytë do të punohet me studimin e këngës së Gjon Pretikës. Për këtë do të punohen detyrat e dhëna në tekst duke i lënë më tepër hapësirë mendimit të lirë të nxënësve.

Kuptojmë tekstin**1. Ndonëse kënga është shumë e shkurtër dhe me rrëfim të ngjeshur, autori popull ka ditur të portretizojë protagonistët e saj.**

- Si është dhënë karakteri i Gjon Pretikës?
- Po i motrës së tij?

2. Tregoni si është realizuar në këtë këngë dashuria e motrës për vëllanë.

- Cili është roli që kanë katër vargjet e fundit të këngës?
- Çfarë përjetësojnë mbirja e bimëve?

Analizojmë tekstin**1. Largimi i pjesëtarëve të familjes është një motiv i njohur i këtyre këngeve.**

- Cili mendoni se mund të ketë qenë shkak i ndarjes së Gjonit nga familja?
- Gjeni të dhënat që jepen në këngë për të mbështetur mendimin tuaj.

2. Përmendni disa nga arsytet që mund të largojnë nga njëri-tjetri, njerëzit e një familjeje.

- A ndodh edhe sot një gjë e tillë?
- Çfarë duhet bërë për të mos cenuar në këtë mënyrë familjen shqiptare që tradicionalisht ka qenë dhe është shumë e lidhur?

5. Shkrim i lirë:

- Gjatë kësaj etape mësuesi mund të ndajë detyrat për shkrimin e lirë sipas vështirësisë së reaëizimit të tyre duke u nisur edhe nga niveli i nxënësve.
- Sugjerohet të vendosen kritere të tilla ku secili nxënës dhe jo duke i diferencuar, të zgjedhë cilën prej detyrave do të punojë duke theksuar për secilën prej tyre vlerësimin.

Detyra 1- Rubrika “Shkruajmë” – faqe 85

Shkruani në vetën e parë subjektin e këngës legjendare “Ymer Aga”.

- Vlerësimi: 30 pikë

Detyra 2- Rubrika “Shkruajmë” – faqe 88

Krahasoni me shkrim në formën e një eseje të krahasim – kontrastit

Këngën e Gjon Pretikës me Këngën e Gjino Vakut

Pyetje për ndihmë dhe orientim:

- Ku ngjajnë dhe ku dallojnë ?
- Cila prej tyre ju duket më e bukur?
- Në cilën këngë, çastet psikologjike të përjetimit të personazheve janë trajtuar më mirë?
- Si është trajtuar **incesti** dhe si është shmangur ai në secilën këngë?

- Vlerësimi: 50 pikë

Duke përdorur këtë teknikë, nxënësit nuk diferencohen, por përfshihen dhe ju jepet mundësia të realizojnë një produkt me shkrim sipas aftësive dhe mundësive të tyre.

6. Vlerësimi:

Në përfundim të orës së mësim, mësuesi jep vlerësimin sipas kritereve të përdorura dhe përfshirjes së nxënësve gjatë orës së mësim.

Detyrë për portofol:

- Pasi të lexoni rrëfimin e Mitrush Kutelit për *këngën e Gjon Pretikës*, shkruani edhe ju në prozë *Këngën e Gjino Vakut*. Përpiquni të ruani elementet kryesore të rrëfimit, si dhe të përshtatni dialogun duke e pasuruar rrëfimin me hollësi që nuk janë dhënë në këngë.

JAVA VII

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Këngët legjendare të vëllait të vogël • Studim teksti: Kostandini dhe Dhoqina 		Situatat e të nxënit: Studim teksti – Analizë: <i>Interpretimi simbolik i këngës legjendare të Kostandinit dhe Dhoqinës</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin për këngët legjendare të vëllait të vogël; - interpreton simbolikën e këtyre këngeve; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve dhe simbolikës përkatëse. 		Fjalët kyçe: <i>Këngët e vëllait të vogël, Kostandini dhe Dhoqina, interpretimi simbolik, endogamia, egzogamia etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Kënga legjendare e Kostandinit dhe Dhoqinës</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Diskutimi i detyrave të shtëpisë	10 min
2.	Punë e drejtuar	Motivimi – Video: “Kostandini dhe Doruntina” – Drama e vënë në skenë nga Teatri Kombëtar (fragment i zgjedhur)	20 min
		Bashkëbisedim	15 min
3.	Punë e pavarur	Studim teksti – Koment / Analizë	30 min
4.	Reflektim	Diskutim i lirë	10 min
7.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Hyrje:**

Në fillim të kësaj ore os enë vazhdim të orës së kaluar, mësuesi mund të vlerësojë detyrat e nxënësve ose edhe detyrën për portofol duke zhvilluar një diskutim rreth saj.

Meqënëse tematika është e përbashkët, kalohet gradualisht në temën e re duke bërë një lidhje të natyrshme me këngët legjendare të vëllait të vogël, njohura më shumë si kënga e Kostandinit dhe Doruntinës.

Për këtë mësuesi mund të zhvillojë mësimin në formë më tërheqëse duke paraqitur një fragment nga drama “Kush e sollti Doruntinën” e Ismail Kadarese ose në pamundësi duke zhvilluar një diskutim rreth kësaj kënge legjendare shumë të njohur. Këtë dramë mund ta gjeni ose ta shkarkoni në adresën elektronike të mëposhtme:

<https://www.youtube.com/watch?v=TFQ01yR8FGw>

2. Punë e drejtuar:

• **Motivimi:**

Video: “Kush e solli Doruntinën”

- **Bashkëbisedim:**

- Diskutohet rreth legjendës së Kostandinit dhe Doruntinës/Dhoqinës për temat si:

- Martesa jashtë fisit
- Besa
- Dashuria në familjen shqiptare
- Marrëdhëniet mes anëtarëve të familjes
- Konteksti historik i këngëve etj.

ORA E DYTË

3. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë do të punohet me studimin e tekstit “Kostandini dhe Dhoqina” duke punuar detyrat e dhëna në tekst si më poshtë:

Kuptojmë tekstin

1. Lexoni vargjet nga 1- 18.

- Si është dhënë gjendja shpirtërore e nënës nga këngëtari popullor?

• Gjendja shpirtërore e nënës është shumë e rënduar dhe në një situatë të mjerë. Ajo ka mbetur e vetme, pasi i kanë vdekur të gjithë fëmijët (vargu 10-14)

• Kulmi i kësaj gjendjeje të mjerë arrihet në vargun 15-16, kur nëna mallkon djalë të vogël Kostandinin: *Kostandin të ardhhtë gjëma/martove Dhoqinën larg*

- Në çfarë vete është kryer rrëfimi?

• Rrëfimi kryhet në vetën e parë.

- A e bën kjo rrëfimin më intim dhe lirik?

• Rrëfimi në vetën e parë i jep nota lirike, ndjeshmëri dhe emocion më të madh ndodhisë.

2. Në vargjet e mësipërme identifikoni figurat letrare.

- Cila është atmosfera që ato përshkruajnë?

• Figurat letrare si metafora, epitete etj japin atmosferën e zymtë në shtëpinë e nënës së Dhoqinës.

- Krahasoni këtë atmosferë me atë ku ndodhet Dhoqina.

• Në kundërvënje me atmosferën e mësipërme, ndodhet ajo që shprehet në vargjet 20-22 ku duket se atmosfera është e bukur, e qetë dhe e gëzuar.

- Çfarë vini re?

• Ky kontrast është dhënë për të nxjerrë më në pah dhimbjen dhe tragjizmin e asaj që do të ndodhë, si për të thelluar më shumë mrekullinë apo të jashtëzakonshmen që do të ndodhë më pas.

Analizojmë tekstin

1. Kënga ndahet në disa pjesë sipas rrëfimit të ngjarjes.

- Ndani këngën të pjesët përbërëse sipas rrjedhës së rrëfimit
 - Hyrja – përshkrimi i mjedisit, kohës dhe hapësirës (vargu 1 – 4)
 - Rrëfimi në vetën e parë nga nëna, përsonazhi kryesor (vargu 5 – 19)
 - Rrëfimi në vetën e tretë nga autori/këngëtari popullor (vargu 20 – 24)
 - Dialogu: Kostandin – Dhoqinë (vargu 25 – 34)
 - Dialogu: Vajzë – Nënë (vargu 43 – 54)
 - Mbyllja – rrëfimi i autorit/këngëtarit popullor (vargu 54 – 55)
- Vendosni për secilën pjesë nga një titull
- A vini re ndonjë ndryshim në teknikat e rrëfimit?
 - Teknikat e ndryshme të rrëfimit, jo vetëm që e bëjnë më të larmishme ngjarjen, por i japin edhe emocion, ndjeshmëri dhe lirizëm këtij rrëfimi.

2. Autori popullor përdor në këtë këngë teknikën e vetërrëfimit, rrëfimit dhe dialogut.

- Çfarë funksioni luan secila teknikë?
 - Vetërrëfimi e bën më të ndjerë përjetimin dhe gjendjen psikologjike të nënës.
 - Rrëfimi shërben për të njohur kontekstin dhe jep panoramën më të gjerë të ngjarjes.
 - Dialogu e bën më të gjallë ngjarjen dhe e sjell shumë pranë dëgjuesit/lexuesit.
 - Cilën prej tyre e vlerësoni më lirike?
 - Vetërrëfimi është teknike më lirike, pasi përmes tij përcillet gjendja e rënduar psikologjike e nënës.

3. Përshkruani gjendjen shpirtërore të takimit të nënës me të bijën.

3. Diskutim i lirë:

Gjeni në këtë këngë elementet fantastike dhe argumentoni pse ky krijim mund të quhet legjendë.

Pas këtij diskutimi, nxënësit orientohen për orën e ardhshme, gjatë së cilës do të diskutohet dhe analizohet vepra e Ismail Kadaresë “Kush e solli Doruntinën”.

JAVA VIII

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Ismail Kadare – <i>Kush e solli Doruntinën</i> • Studim teksti – fragmente nga vepra 		Situatat e të nxënit: Analizë dhe studim teksti: <i>Legjenda e lashtë dhe trajtimi i saj në letërsinë bashkëkohore</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: - identifikon ndikimin e legjendës në letërsinë bashkëkohore; - vlerëson ndërtimin e subjektit dhe personazheve; - gjykon rreth vlerave letrare të veprës dhe mesazhit universal që përcjell autori. 		Fjalët kyçe: <i>Legjenda e Kostandinit, dhimbja e nënës, fjala e dhënë, martesat jashtë fisit etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Novela “Kush e solli Doruntinën”</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Di / Dua të di / Mësoj	10 min
2.	Informacioni i ri	Leksioni i përparuar	20 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	15 min
4.	Punë e pavarur	Ditari tripjesësh	20 min
5.	Reflektim	Shkrim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

• **Motivimi:**

• *Ora e mësimit është parapërgatitur që nga java e kaluar/ ora e kaluar, pasi nxënësit janë njohur me legjendën e Kostandinit dhe të Dhoqinës (Doruntinës) dhe kanë folur /parë edhe fragmente nga vepra e Kadaresë e dramatizuar.*

• *Motivimi fillon me shqyrtimin e konceptit të besës, që është një nga vlerat themelore të shqiptarëve e njohur që prej lashtësisë.*

• *Për realizimin e kësaj pjesë, një teknikë e mundshme është edhe Di/ Dua të di/ Mësoj. Përmes saj nxënësit orientohen të marrin pjesë duke dhënë mendimet e tyre, jo vetëm për konceptin në fjalë, por edhe për veprën e Kadaresë në përgjithësi.*

• *Nëse e kanë lexuar këtë vepër, trajtimi i subjektit të saj mund të vazhdohet përmes kësaj teknike, nëse vepra nuk është e njohur prej tyre, mund të kalohet në fazën e dytë të informacionit të ri, përmes teknikës “Leksioni i përparuar”.*

2. Informacioni i ri:

Leksioni i përparuar

Kjo teknikë në zhvillohet në etapën realizimit të kuptimi dhe procedohet në këtë formë:

1. Pjesëmarrësit bashkohen në dyshe
2. Secila dyshe duhet të bëjë një listë të të gjitha gjërave që ata i dinë për problemin (kjo bëhet për këtë, keni 4 minuta kohë).
3. Pas katër minutash, mësuesi u thotë dysheve që t'ua tregojnë edhe të tjerëve në grup ato që kanë gjetur, idetë shkëmbehen brenda grupit.
4. Shkruhet në dërrasë të zezë një listë me mendimet e nxënësve
Para leximit, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit ta përcjellin listen e ideve dhe të shtojnë ide të reja në listë.
5. Fillohet me leximin e pjesës së parë të leksionit (materialit të dhënë në tekst).
6. Mbahet lista përpara kur lexohet .
7. Pas leximit rishikohen listat, nëse ka gjëra që janë lexuar dhe i kemi në listë dhe cilat janë gjërat e reja që janë mësuar, radhiten në listë.

Nëse pjesët e leximit nuk kanë ndonjë shkëputje logjike, vazhdohet kështu me lexime dhe me plotesimin e listës së ideve deri në fund të mësimit. Por nëse kemi problem të ri, shkëputje logjike në njësinë mësimore, atëherë rifillo procesin, duke angazhur perseri çiftet, për te formuar listë të re idesh:

8. Duke punuar në dyshe, ju lutem rendisni ato që dini rreth këtyre çështjeve. Për këtë keni 3 minuta kohë .
9. Pas tre minutash mësuesi u kërkon nxënësve të mos shkruajnë më dhe fton disa prej tyre të flasin për idetë që kanë shënuar.
10. Pastaj mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë me vëmendje pjesën tjetër të leksionit, duke pasur para listen e tyre të ideve.
11. Pas leximit krahasohet lista e ideve me ato që u thanë në lexim.
12. Në fund nga grupet kërkohen vullnetare për të dhënë disa nga idetë e tyre.
Kështu bëhet prezantimi i asaj që është mësuar.

Me këtë teknikë punohet materiali i dhënë në tekst në faqen 93 – 94. Por mësuesi është i lirë të përdorë çfarëdolloj tjetër informacioni që e sheh të nevojshëm, qoftë edhe të sjellë nga nxënësit.

3. Veprimtari e drejtuar:

Gjatë kësaj etape do të lexohet fragmenti i veprës i dhënë në tekst faqe 94 – 95, Studim teksti 1 dhe do të punohen detyrat e dhëna në të.

Kuptojmë tekstin

1. Novela e Kadaresë *Kush e sollë Doruntinën* është krijuar mbështetur në legjendën e Kostandinit dhe Doruntinës.

- Si e ka trajtuar ai këtë legjendë: si përshkrim të saj apo reflektim ndaj saj?
- Çfarë ka marrë nga kjo legjendë?

2. Nëna dhe Doruntina, në këtë pjesë, “flasin” në çastet e fundit të tyre të jetës përmes gjesteve.

- Pse tronditja i ka lënë pa gojë dhe jo pa ndonjë shqetësim tjetër?
- A është kjo teknikë një zgjedhje e autorit apo një hiperbolizim i gjendjes së tyre shpirtërore?

3. Gjeni në paragrafët e fragmentit më lart hollësi me të cilat përshkruhet bukuria fizike e Doruntinës.

- Çfarë efekti fitohet nga kontrasti me atmosferën e fatkeqësisë së tmerrshme ky përshkrim?

analizojmë tekstin

1. Vini re si i përshkruan autori sytë e nënës dhe sytë e Doruntinës.

- Plotësoni tabelën e mëposhtme me hollësitë e këtij përshkrimi.

PËRSHKRIMI I SYVE TË NËNËS	PËRSHKRIMI I SYVE TË DORUNTINËS
-	-
-	-
-	-
-	-

2. Çfarë mund të kërkonin sytë e nënës nga Stresi?

- shpjegimin për atë çudi dhe tmerr që ka ndohur
- të mbrojë emrin dhe nderin e Doruntinës
- ta lërë të vdesë e qetë
- e bën fajtor për këtë fatkeqësi

Argumentoni secilin prej varianteve dhe diskutoni për zgjedhjen tuaj.

3. Interpretoni fjalitë e mëposhtme të shkëputura nga fragmenti i mësipërm dhe thoni pse përsëritet fjala *gjysmë* dhe pse qan Stresi dhe jo Doruntina.

Ishin ca lotë tjetërlluj, gjysmë të dukshëm, gjysmë të preکشëm.

Në atë lotëri fytyra e saj u bë edhe më e largët.

Zgjidhni dhe argumentoni cili prej formulimeve të mëposhtme shpreh mendimin tuaj

- Doruntina nuk ka më lotë, është e tronditur nga trauma
- Doruntina është fizikisht e vdekur, sytë janë portat e fundit që mbyllen me jetën
- Stresi ndien se po e humb përgjithmonë

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur: Ditari tripjesësh

Kjo teknikë është e bazuar në ditarin dypjesësh, por i vetmi dallim tek ditari tripjesësh kemi plotesimin e shtyllës së tretë të ditarit.

Tek ditari tripjesësh kemi shtyllën e parë, shtyllën e mesme, (të dytë) dhe shtyllën e tretë në të cilën bëhet arsyetimi i mendimit, përgjigjes, bëhet prova e detyrës, bëhet vizatimi, skema etj.

Me këtë teknikë do të punohet me fragmentin e dytë nga vepra, Studim teksti 2, faqe 97 – 99.

Në rast se nxënësit nuk kanë arritur që të realizojnë gjatë orës së parë, analizën dhe diskutimin e fragmentit të parë, mund të vazhdohet puna për këtë fragement ose mund të diferencohen nxënësit që e kanë përfunduar detyrën për të kaluar në studimin e pavarur të teksit të dytë duke i orientuar se si të punojnë me tabelën e mëposhtme sipas shembullit të dhënë.

Kuptojmë tekstin

1. Në fillim të këtij fragmenti, Stresi u shkëput nga vendi dhe eci drejt platformës. Kuptimi simbolik i këtyre fjalëve ka të bëjë me vendin – pozicionin zyrtar të Stresit si nëpunës i shtetit të Bizantit, kurse platforma këtu parathotë atë që do të shpалosë Stresi në fjalimin e tij

- Cilat janë hipotezat që parashtron Stresi për mundësinë e ardhjes së Doruntinës?
- Çfarë masash ka marrë ai për ta hulumtuar këtë ngjarje?

Nënvizoni në tekst këto fjali duke përballur me njëra tjetrën për të kuptuar arsyetimin e Stresit në platformën e tij.

Pyetja	Përgjigje	Argumenti
<ul style="list-style-type: none"> Cilat janë hipotezat që parashtrojnë Stresi? 	<ul style="list-style-type: none"> Doruntinën e solli Kostandini.... 	<p>Ja përse unë e shpall dhe e rishpall se Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veçse vëllai i saj, Kostandini, fjala e dhënë, besa e tij. asnjë shpejgim tjetër s'ka e s'mund të ketë ky udhëtim. S'ka rëndësi, u ngrit apo s'u ngrit i vdekuri nga varri për ta kryer vetë atë që duhej të kryente, s'ka rëndësi cili qe kalorësi dhe ç'kalë shaloi ai atë natë të errët kur u nis, ç'krahë mbanin frerin, ç'këmbë shkelnin yzengjitë dhe mbi flokët e kujt binte pluhuri i udhës. Secili nga ne ka pjesën e vet në këtë udhëtim, sepse besa e Kostandinit, ajo që e solli Doruntinën, ka mbirë këtu, midis nesh.</p>

Përmes kësaj teknike do të punohen edhe detyrat e tjera si më poshtë.

2. Pse Stresi thotë se nuk ka rëndësi kush e solli Doruntinën, madje se *duke e sjellë Kostandini, e sollëm të gjithë: unë, ju, të vdekurit tanë që pushojnë atje te kisha?*

3. Pyetjen e titullit të kësaj novele "*Kush e solli Doruntinën*", që është e pranishme gjatë gjithë veprës, çfarë dileme ngre?

- Kush e solli Doruntinën?

- Shpresa
- Fjala e dhënë
- Dashuria e munguar

Analizojmë tekstin

1. Cili është kuptimi i heshtjes në këtë fragment?

Ajo shërben si shenjë:

- Aprovimi
- Kundërvënieje
- Indiference
- Tensioni gati në shpërthim
- Shuarje e botës "së jashtme", për të dëgjuar botën "e brendshme"
- **Argumentoni përgjigjen duke zhvilluar në klasë një diskutim rreth këtyre alternativave.**

2. Rilexoni pjesën ku Stresi flet për rreziqet që i kanosen Arbrit dhe mjetet që duhet të krijojë ai për t'u mbrojtur. - Si i kuptoni ju këto rreziqe për atë kohë dhe për kohën kur u shkrua vepra?

- Po në kohën e sotme, a qëndrojnë rreziqe para kombit shqiptar?

- Cila është vlera aktuale e mesazheve të kësaj novele?

5. Reflektim: *Shkrim i lirë / Diskutim i lirë*

Në pjesën e fundit të orës së mësimin, në varësi të mundësive, nivelit të klasës si edhe ecurisë së saj, mund të punohet përmes teknikës "Shkrim i lirë" rubrika "Shkruajmë" faqe 96 ose detyra 3 faqe 100.

Shkruajmë

- **Besa – kontrata e pashkuar e shqiptarëve.**
- Kujdes! Përdorni argumentet dhe kundërargumentet.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

JAVA IX

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Cikli i Kreshnikëve • Studim teksti “Martesa e Mujit” dhe “Ajuna qan Omerin” 		Situatat e të nxënit: Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kohën dhe vendin e krijimit të këngëve të ciklit; - vlerëson rëndësinë e këngëve dhe personazheve; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve të ciklit. 		Fjalët kyçe: <i>Cikli i Kreshnikëve, Muji dhe Halili, personazhet e këngëve, koha dhe vendi i formimit të këngëve të ciklit etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Këngë e eposit të Kreshnikëve</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Diskutimi për njohuritë paraprake	10 min
2.	Informacioni i ri	Leksioni i përparuar	10 min
3.	Punë e drejtuar	Koment	25 min
4.	Punë e pavarur	Ditari tripjesësh	20 min
5.	Reflektim	Shkrim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

- **Motivimi:**
- *Nxënësit kanë marrë njohuri për këngët e Ciklit të Kreshnikëve në lëndën e Letërsisë, klasa X, ndaj mësimi mund të fillojë me një diskutim rreth njohurive paraprake.*
 - Motivimi mund të fillohet përmes këngësh të ndryshme të këtij cikli si edhe me personazhet e tij.
 - Ora e mësimi mund të fillojë edhe me vargjet e ndonjë kënge apo fabulën e ngjarjeve të saj.
 - Përmes këtyre vargjeve mund të zhvillohet bashkëbisedimi rreth njohurive që kanë nxënësit për këngët e ciklit.
 - Çfarë trajtojnë këngët e Ciklit të Kreshnikëve?
 - Cilët janë personazhet kryesorë të këngëve të këtij cikli?
 - Ku zhvillohen ngjarjet e këngëve të këtij cikli?
 - Cila është origjina e këngëve të këtij cikli?

Pas këtij diskutimi, nëse njohuritë e nxënësve janë të sakta dhe nuk nuk kanë nevojë për më tepër trajtim, kalohet te studimi i tekstit “Martesa e Mujit”, ku nëpërmjet pyetjeve dhe komentit dalin në pah edhe veçoritë letrare.

Në rast se ka nevojë për më tepër informacion apo saktësim të tij, punohet me materialin e tekstit faqe 101 – 103, ose edhe me materiale të tjera të sjella nga nxënësit ose mësuesi.

2. Informacioni i ri:

Leksioni i përparuar

Kjo teknikë mund të kombinohet edhe me diskutimin e informacioneve të tjera që kanë sjellë nxënësit në klasë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Studim teksti 1 – “Martesa e Mujit”

Gjatë kësaj pjese të orës së mësimit, nxënësit, pasi të kenë lexuar fragmentin e këngës në faqen 104, do të flasim rreth fabulës së saj (subjektit të këngës) dhe do të punojnë pyetjet e rzbrikave dhe detyrave të tekstit nëpërmjet një bashkëbisedimi, ku mësuesi do të japë mendimin përfundimtar, pasi të ketë dëgjuar përgjigjet, komentet dhe saktësimet apo mendimet e ndryshme të nxënësve.

Kuptojmë tekstin

1. Martesa e Mujit është një nga këngët qendrore të Ciklit të Kreshnikëve ku del në pah figura e Mujit dhe përballja me Zanat.

- Ku ndryshojnë zanat si qenie mitologjike nga zanat si figura artistike¹ (personazhe të eposit të kreshnikëve)?

- Si paraqitet Muji në këtë këngë?

2. Në këtë rapsodi vihet re përzierja e elementit fantastik me atë real.

- Gjeni vargjet ku duken këta elementë

- Si veprojnë ata me njëri-tjetrin?

3. Si në të gjitha eposet, në hyrje të tyre shërbejnë formulat e gatshme, zakonisht lutjet drejtuar Zotit ose muzave që ato t’i frymëzojnë dhe t’i ndihmojnë që të këndojnë sa më bukur.

- Nënvizoni vargjet hyrëse të kësaj kënge.

- Krahasoni këtë thirrje me atë të poemave të tjera si: “Iliada”, “Odisea”, “Eneida” apo “Istori e Skënderbeut”

nga Naim Frashëri ose “Lahuta e Malcisë” nga Gjergj Fishta.

-Çfarë ngjashmëri vini re?

Analizojmë tekstin

1. Karakteristikë e këngëve epike dhe e eposit tonë është përsëritja (*anafofa, epifora dhe epanastrofeja*).

- Identifikoni dhe nënvizoni rastet e përdorimit të këtyre llojeve të përsëritjes.

- Cili është funksioni i tyre?

Kujtoni se këto këngë këndoheshin nga rapsodi duke i mësuar të gjitha vargjet përmendësh.

2. Lexoni të plotë këngën në fund të tekstit dhe përgjigjuni pyetjeve:

- Cili është plani që thuri Muji me nusen e vet për të çliruar dasmorët?

- A ka në këtë këngë më shumë elementë përrallorë, paganë sesa realë?

3. Nisur nga njohuritë që keni për ritet dhe zakonet e martesës, identifikoni në këtë këngë këto rite dhe krahasojini me ato që përshkruhen në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

- Vini re ngjashmëri mes tyre?

- A ka ndryhime me ritet e sotme?

- Nëse po, ku i shihni ato?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur: *Ditari tripjesësh*

Gjatë orës së dytë të mësimit do të punohet studim teksti 2 “Ajkuna qan Omerin”.

Kjo pjesë punohet në formën e një komenti dhe mund të përdoret teknika *Ditari tripjesësh*.

1. Për të realizuar këtë detyrë, nxënësit mund të lexojnë materialin plotësues të dhënë në tekst te rubrika “Zgjeroni më tej njohuritë tuaja”, faqe 115 – 116.

Kjo teknikë është e bazuar në ditarin dypjesësh, por i vetmi dallim tek ditari tripjesësh kemi plotësimin e shtyllës së tretë të ditarit.

Tek ditari tripjesësh kemi shtyllën e parë, shtyllën e mesme, (të dytë) dhe shtyllën e tretë në të cilën bëhet arsyetimi i mendimit, përgjigjes, bëhet prova e detyrës, bëhet vizatimi, skema etj.

Në tabelën e mëposhtme, si shembull të punës me teknikën e mësipërme, mund të punohen detyrat e dhëna në faqen 107, si më poshtë.

Kuptojmë tekstin

1. Figura e Ajkunës të kujton vende-vende Hekubën e trojanëve me madhështinë e saj, me heshtjen dhe durimin e saj, me forcën e ndjenjave si nënë.

- Cilat janë disa prej cilësive të saj që shfaqen në këtë këngë?
- Çfarë roli merr në këtë këngë fjala “qyqe”?

Pyetja	Përgjigje	Argumenti
<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë disa prej cilësive të Ajkunës? 	<ul style="list-style-type: none"> • Dhimbja epike e nënës që shtang edhe drurët e gurët e malit dhe i bën edhe natyrën t’i dhimbset <i>nana e padjalë</i>. • Dashuria për djalin 	<i>Kanë lanë kangën zogjt e malit, Kanë lanë kangën me veshtrue! Orët e bjeshkës ma s’und p’e ndiejnë, Fjalën n’gojë po ja këthejnë dalë, Zemrën s’rrahmi ja kanë ndalë, Lott ndër sy mirë po ja krijnë, Ftyrën lotsh mirë po ja shijnë, Vetë e bajnë e e çojnë n’Jutbinë.</i>

2. Humbja e një njeriu është një fatkeqësi, për këtë ai vajtohet me dhimbje dhe vuajtje të madhe.

- Ç’rol luan natyra në dhimbjen e nënës?
- Identifikoni vargjet ku natyra merr pjesë në këtë vajtje.
- Çfarë ndjesish përcjell tek ju ky shpirtëzim i natyrës?

3. Ashtu si në çdo këngë vaji, Ajkuna përmend karakteristikat e Omerit.

- Si portretizohet ai?
- Çfarë kërkon ajo prej tij?

Përmes kësaj teknike do të punohen edhe detyrat e rubrikës Analizojmë tekstin, faqe 107.

Analizojmë tekstin

1. Shpjegoni ku duket fryma heroike në këtë këngë dhe rolin e elementeve lirike.

2. Gjeni mjetet stilistike më të përdorura në këtë këngë.

Shpjegoni rolin dhe funksionin e tyre në krijimin e atmosferës së dhimbjes në këtë këngë.

3. Formula hyrëse është karakteristike për çdo këngë epike.

- Komentoni dy vargjet e para nistore të kësaj kënge.
- Analizoni vargjet e mëposhtme:

Drita â dalë e dritë s’po ban,
Ka le dielli e nu’ po xe!

- Si na përgatitin këto vargje për ngjarjen që do të ndodhë?

5. Reflektim: Shkrim i lirë

Në pjesën e dytë të orës së mësimin, nëse analiza e fragmenteve është realizuar, nxënësit mund të punojnë të pavarur detyrën me shkrim, faqe 105.

Shkruajmë

Duket qartë se kjo këngë, ashtu si shumë këngë të eposit, është përdorur teknika e pasurimit të rrëfimit. Ka më shumë përshkrime dhe hollësi.

- Duke përdorur teknikën e zhveshjes, shkruani në fletore motërzimin e zhveshur të kësaj pjese.

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Cikli i Kreshnikëve dhe origjinaliteti i tij • Studim teksti “Gjergj Elez Alia” 		Situatat e të nxënësve: Diskutim: <i>Cikli i Kreshnikëve dhe rëndësia e tij</i>	
Rezultatet e të nxënësve: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kohën dhe vendin e krijimit të këngëve të ciklit; - vlerëson rëndësinë e këngëve dhe personazheve; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve të ciklit. 		Fjalët kyçe: <i>Cikli i Kreshnikëve, Muji dhe Halili, personazhet e këngëve, koha dhe vendi i formimit të këngëve të ciklit etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • Krijime të ndryshme lirike; • Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12) • Këngë e eposit të Kreshnikëve 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Diskutimi për njohuritë paraprake	10 min
2.	Informacioni i ri	Leksioni i përparuar	10 min
3.	Punë e drejtuar	Koment	25 min
4.	Punë e pavarur	Ditari tripjesësh	20 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- **Motivimi:**

Kënga 3 Gjergj Elez Alisë, është shumë e njohur dhe e trajtuar edhe në nivele të tjera të shkollës, ndaj procesi mësimor mund të fillojë duke u mbështetur tek njohuritë që nxënësit kanë marrë edhe më parë. Gjithashtu, gjatë kësaj ore do të punohet me materialin e ri i cili do të shërbejë për të parë në një këndvështrim kritik dhe vlerësues këto këngë.

Materiali i faqes 112 – 113 mund të lexohet nga nxënësit në mënyrë të pavarur dhe më pas të kalohet në diskutimin e tij, kurse orën e dytë në analizën dhe komentin e këngës së Gjergj Elez Alisë.

2. Informacioni i ri:**Leksioni i përparuar**

Kjo teknikë mund të kombinohet edhe me diskutimin e informacioneve të tjera që kanë sjellë nxënësit në klasë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Studim teksti 3 – “Gjergj Elez Alia”

Gjatë kësaj pjese të orës së mësimin, nxënësit, pasi të kenë lexuar fragmentin e këngës në faqen 108 - 110, do të flasim rreth fabulës së saj (subjektit të këngës) dhe do të punojnë pyetjet e rubrikave dhe detyrave të tekstit nëpërmjet një bashkëbisedimi, ku mësuesi do të japë mendimin përfundimtar, pasi të ketë dëgjuar përgjigjet, komentet dhe saktësimet apo mendimet e ndryshme të nxënësve.

Kuptojmë tekstin

1. Për të kuptuar më mirë përmbajtjen e këngës ndajeni atë në pjesë. Pjesa e parë ndahet në katër grupe vargjesh.

- Vendosni nga një titull për secilën pjesë.

Pjesa I – (vargu 1 – 12) – Parashtrimi dhe hyrja e këngës na njeh me personazhet dhe gjendjen e tyre.

Pjesa II – (vargu 13 – 25) – Lajmi për ardhjen e bajlozit të zi.

Pjesa III – (vargu 26 – 83) - Dialogu motër – vëlla.

Pjesa IV – (vargu 84 – 121) – Përballja me nallban probatinin dhe nallban jaranin.

- Tregoni shkurtimisht se çfarë rrëfëhet në secilën pjesë.

2. Gjergj Elez Alia ka nëntë vjet që lëngon në shtrat me nëntë plagë në trup.

- Ku i ka marrë ai këto plagë?

- Edhe pse nuk thuhet në këngë, nënkuptohet që këto plagë janë marrë në beteja dhe lufta të ndryshme. Këtë e kuptojmë përmes epitetit *trim mbi trima* që përdoret që në fillim, që le të kuptohet se bëhet fjalë për një trim luftëtar.

- Ç'tregon kjo për figurën e kreshnikut?

- Kjo e lartëson figurën e luftëtarit dhe e bën atë të ngjashme me një kreshnik, figurë madhështore dhe heroike.

- Cila është domethënia e përdorimit të numrit 9?

- Përdorimi i numrit 9 është një element simbolik i traditës popullore dhe epikës heroike, por njëkohësisht merr vlerën e një hiperbolizimi, për të lartësuar figurën heroike të Gjergjit.

3. Si është dhënë në këtë këngë lidhje motër – vëlla?

- Përmes dialogut motër-vëlla, në pjesën e parë të këngës, vihet re lidhja e ngushtë dhe tepër e fortë mes vëllait dhe motrës. Në të shihen tipare të familjes tradicionale shqiptare, ku roli i vëllait është ai i mashkullit të parë të shtëpisë, pas vdekjes së prindërve i cili duhet të kujdeset për motrën e tij dhe anasjelltas, motra që zëvendëson nënën dhe përfaqëson figurën femërore në këtë familje. Ajo duhet të kujdeset për shtëpinë dhe vëllanë. Kjo lidhje e ngushtë, shprehet edhe në vargjet anaforikë:

A thue s'pate me ngranë e me pi?

A t'la keq ty vllau për veshë e mbathë?

A mos t'u randue ndojherë me fjalë?

Përmes këtyre vargjeve shprehet koncepti i rolit të vëllait dhe detyrimeve të tij ndaj motrës.

4. Lexoni vargjet e mëposhtme:

"Ç'je kan thue, bre burrë, goja t'u thaftë!

Jam kanë nisë tu dera e probatinit,

qe nandë vjet qi gjogu ksajt s'ka ra,

m'fal se ndeshkjam derën e magjupit!

Se kta syj nji herë unë ua kam falë

tats' e nans'qi kalben për nan dhe,

Gjergjit tem qi kalbet varrsh' mbi dhe!"

- Kujt ia drejton këto fjalë motra e Gjergjit?

- Cila është domethënia e këtyre fjalëve?

- Çfarë cilësish të motrës dalin përmes tyre?

Pse ajo nuk jepet me një emër të përveçëm?

- Në këto vargje jepet portreti moral dhe ngrihet në kult ideali femëror i shqiptares, e cila nuk mund t'i jepet kujdo, madje as nuk përulet para provokimeve të tilla të ulëta. Ajo i është përkushtuar familjes dhe vëllait të saj. Ky përkushtim e lartëson atë si një figurë femërore përfaqësuese të

idealit femëror të shqiptarit. Kjo shprehet edhe me faktin që nuk përmendet me emër, një tregues i përgjithësimi popullor të figurës së saj.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur: *Ditari tripjesësh*

Gjatë orës së dytë të mësimit do të punohet studim teksti 3 “Gjergj Elez Alia” – rubrika “Analizojmë tekstin.

Kjo pjesë punohet në formën e një komenti dhe mund të përdoret teknika *Ditari tripjesësh*.

Kjo teknikë është e bazuar në ditarin dypjesësh, por i vetmi dallim tek ditari tripjesësh kemi plotësimin e shtyllës së tretë të ditarit.

Tek ditari tripjesësh kemi shtyllën e parë, shtyllën e mesme, (të dytë) dhe shtyllën e tretë në të cilën bëhet arsyetimi i mendimit, përgjigjes, bëhet prova e detyrës, bëhet vizatimi, skema etj.

Analizojmë tekstin

1. Veprimi është karakteristika kryesore e këngëve epike. Dyluftimi në këtë këngë përbën edhe pikën kulmore të saj.

- Si është dhënë nga rapsodi dyluftimi mes këtyre dy luftëtarëve?
- Pse ata ndeshen fillimisht me fjalë?
- Po ironia çfarë vlere ka në këtë betejë?

2. Hiperbola është figurë qëndrore e këngëve epike. Rapsodi e përdor këtë figurë për të përforcuar edhe më tepër përshtypjen, për të vënë në dukje më mirë figurën.

- Gjeni disa nga hiperbolat e përdorura në këtë këngë.
- Ç’përshtypje artistike krijojnë ato?
- Shpjegoni përdorimin e figurës së hiperbolën në dyluftimin me armë të Gjergji dhe Balozit.

3. Te vargu “A dalë zani e paska marrun dhenë”, kemi përdorimin e foljes në mënyrën habitore. Me këtë, rapsodi duket sikur do të na flasë për një mrekulli.

- Nënvizoni në pjesën e dytë të këngës foljet e përdorura në mënyrën habitore.
- Çfarë funksioni kryejnë ato?

4. Analizoni figurën e Balozit.

- Si është përshkruar ai?
- Çfarë roli luan epiteti “i zi”?
- Po lidhja me detin, çfarë ndikimi ka në këtë këngë?

5. Reflektim: *Shkrim i lirë*

Në pjesën e dytë të orës së mësimit, nëse analiza e fragmenteve është realizuar, nxënësit mund të punojnë të pavarur detyrën me shkrim, faqe 111. Kjo detyrë mund të realizohet edhe si detyrë shtëpie, pasi njohuritë nga lënda e letërsisë bazë, kanë trajtuar edhe analizën e “Lahutës së Malcisë”

Shkruajmë

Në poemën “Lahuta e Malcisë” të Gjergj Fishtës, kënga e Tringës mbështetet në modelin e këngës së Gjergj Elez Alisë. :

- Gjeni të përbashkëtat dhe të veçantat:
- në subjekt
- në lidhjen vëlla-motër
- në mesazh
- Cilat janë motivet që e shtyjnë Tringën të qëndrojë deri në fund?
- A janë të ngjashme me motivet që e shtyjnë Gjergj Elez Alinë?

Për orën e ardhshme nxënësit orientohen të punojnë për detyrën kërkimore hulumtuese e cila mund të trajtohet gjatë një ose dy orëve mësimore të javës në vazhdim.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

JAVA XI

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Punë kërkimore – hulumtuese • Përsëritje e njohurive 		Situatat e të nxënit: Diskutim – Analizë: <i>Punë kërkimore</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kohën dhe vendin e krijimit të këngëve të ciklit; - vlerëson rëndësinë e këngëve dhe personazheve; - gjykon rreth vlerave letrare të këngëve të ciklit. 		Fjalët kyçe: <i>Cikli i Kreshnikëve, Muji dhe Halili, personazhet e këngëve, koha dhe vendi i formimit të këngëve të ciklit etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Këngë e eposit të Kreshnikëve</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

- Cilat janë tezat e prejardhjes dhe origjinës së këngëve të Ciklit të Kreshnikëve?
- Cila është koha e formimit të tyre?
- Çfarë afrie shihni mes eposit të kreshnikëve dhe eposeve evropiane të mesjetës?
- Çfarë ndikimi kanë elementët mitologjike dhe paganë në epos?

Gjatë kësaj ore nga mësuesi mund të punohet me detyrat e realizuara nga nxënësit, puna e tyre kërkimore e ndërthurur kjo edhe me përsëritjen e njohurive rreth Ciklit të Kreshnikëve, epikës popullore dhe materialeve të trajtuara gjatë tremujorit të dytë, në varësi kjo të mënyrës se si është trajtuar lënda gjatë kësaj periudhe. Për vlerësimin e punës hulumtuese sugjerohet të përdoret një format i tillë i kriterëve si më poshtë.

VLERËSIMI:

Nr.	Kriteret e vlerësimit të punimit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar	Mesatar	I arrirë	I avancuar
	Trajtimi i argumentit – 30 pikë	4	6	8	10
1.	a) Idetë dhe organizimi i tyre				
	b) Përdorimi i burimeve të ndryshme				
	c) Shpjegimi dhe argumentimi i fakteve, opinioneve etj.				
2.	Struktura e punimit – 10 pikë				
	a) Struktura dhe koherenca e pjesëve përbërëse të saj				
3.	Gjuha e shkrimit të punimit – 20 pikë				
	a) Saktësia gjuhësore				
	b) Shumëllojshmëria e fjalive				
4.	Organizimi tërësor i punimit – 30 pikë				
	a) Mbështetja e ideve me hollësi dhe shembuj				
	b) Zotërimi i teknikave të kërkimit				
	c) Përdorimi i teknikave për të mbështetur bindjet, mendimet, opinionet, emocionet etj.				
5.	Drejtpërdrejti – 10 pikë				
	a) Përdorimi i saktë dhe korrekt i gjuhës standarde				

Tabela e konvertimit të pikëve në nota:

Pikët	0 – 24	25 – 44	45 – 54	55 – 64	65 – 74	75 – 84	85 – 100
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Test përmbledhës për tremujorin e dytë
 Test përmbledhës për Lirika dhe Epika popullore
 Studim teksti:

Gjergj Elez Alija - (fragment)

Sa ka nisun drita me zbardhë majet,
 n'fushë t'mejdanit trimat konkan dalë,
 keq me fjalë trimat shoshojnë po rrekin:
 "P'a prej vorrit, Gjergj, ti konke çue?
 Pse me m'qitë, bre burrë, n'kët fushë
 t'mejdanit?"

Sa mirë trimi i ka përgjegjë Balozit:
 " Të lumtë goja, Baloz, mirë po thue,
 qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit,
 pak pa mrrijtë, Baloz, ti m'ke dredhue:
 m'ke lypë motrën para se mejdanin,
 m'ke lypë berrat para se çobanin,
 e jam dredhë n'kët log për me t'kallxue
 se ne t'parit' nji kanu na kanë lanë:
 armt' me dhanë përpara e mandej gjanë,
 kurr Balozit motrën mos m'ia dhanë,
 për pa u pre n'at fushën e mejdanit!
 Por shtrëngohu, Baloz, se t'ka ardhë dita,

se ktu i thonë-o Gjergj Elez Alija!"
 E i kanë ba dy gjogat tim për tim
 e n'topuz Balozit e ka shinue:
 n'dy gjujt gjogu Gjergjit te i ka ra,
 përmbi kryet topuzi i ka fjurue;
 dymbdhetë pash n'ledinë u ngul topuzi,
 dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni.
 At'herë Gjergjit rendi te i ka ardhë,
 sa mirë trimi n'topuz qi ka dredhë,
 lik përmjet Balozit te i ka ra.
 A'trandë fusha kur a'rrxue Balozit.
 Mejherë trimi shpatën ma ka xjerrun,
 kryet me neje trupit ia ka damun,
 zhag për kambet trupin e ka ngrehun,
 me gjith at m'nji bunar e ka mbytur.
 Të tanë lumën gjaku e ka tërzue,
 për tri vjet krejt vendin e ka qelbun.

Për pyetjet 1-11 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Kënga e Gjergj Elez Alisë bën pjesë në: 1 pikë
 A) këngët legjendare të rinjohjes. B) këngët e ciklit të kreshnikëve.
 C) këngët legjendare të murosjes. D) këngët legjendare të vëllait të vogël.
2. Fjalët kyç: *trim, shpatë, topuz, gjak, mejdan* krijojnë imazhin se në këtë fragment: 1 pikë
 A) ndodh një dyluftim i ashpër. B) debatohet mbi llojet e armëve.
 C) lidhet një vëllazëri e përjetshme. D) ekzekutohet një rit i vjetër pagan.
3. Prania e Balozit në këtë këngë tregon: 1 pikë
 A) vlera të padiskutueshme njerëzore. B) harmoni mes së mirës dhe së keqes.
 C) ekzistencën e kundërshtarit përbindësh. D) kundërvënien e njeriut me Perëndinë.
4. Folja në vargun "*n'fushë t'mejdanit trimat konkan dalë*" është në mënyrën: 1 pikë
 A) kushtore B) dëftore C) lidhore D) habitore
5. Anafora në vargjet: 1 pikë
"Dymbdhetë pash n'ledinë u ngul topuzi/ dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni" është fjalë:
 A) e prejardhur B) e përbërë C) e përngjitur D) e parme
6. Vargu që sjell rrjedhën e ngadaltë të kohës, përmes simbolikës popullore, është: 1 pikë

TEST, TREMUJORI I DYTË DHE ÇELËSI I ZGJIDHJES SË TIJ

- A) sa ka nisun drita me zbardh majet. B) qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit.
C) n'fushë t'mejdanit trimat konkan dalë. D) por shtrëngohu, Baloz, se t'ka ardhë dita.

7. Dyluftimi në këtë fragment ju sjell ndër mend skenën e famshme të ndeshjes së: **1 pikë**

- A) Akilit me Hektorin. B) Skënderbeut me Ballabanin.
C) Makbethit me Makdabin. D) Orestit me Egistin.

8. Gjergj Elez Alia është personazhi që lufton për: **1 pikë**

- A) të ruajtur traditën e këngëve popullore B) pasuri
C) atdhe dhe familje D) të sunduar vende të tjera

9. Këngëtari popullor thotë: *trim mbi trima Gjergj Elez Alia*, sepse vlerëson: **1 pikë**

- A) faktin që Gjergji kishte kohë pa luftuar
B) fjalët që Gjergji u thotë shokëve të tij
C) vdekjen e menjëhershme të vëllait dhe të motrës
D) mbijetesën e Gjergjit në raport me vuajtjen dhe angazhimin

10. Në këtë këngë është hiperbolizuar fakti që: **1 pikë**

- A) Gjergji del në betejë nga dashuria për të motrën
B) Gjergj Elez Alia fiton me Bajlozin megjithëse ka 9 plagë
C) Gjergjit ia kërkojnë dyluftimin
D) Gjergji edhe mund të vdesë duke luftuar

11. Subjekti i kësaj kënge karakterizohet nga: **1 pikë**

- A) zhveshja nga ngjarje të parëndësishme
B) zhveshja nga figuracioni
C) dhënia e disa linjave paralele subjektore
D) dhënia me imtësi e çdo ngjarjeje të subjektit

12. Toni me të cilin Baloz i drejtohet Gjergjit në vargjet e mëposhtme shpreh: **1 pikë**

A prej vorrit Gjergj, ti konke çue?

Pse me m'qitë, bre burrë, në këtë fushë t'mejdanit?

- A) ironi; B) nervozizëm; C) keqardhje; D) seriozitet.

13. Në vargun: "*Pse me m'qitë, bre burrë, në këtë fushë t'mejdanit?*", shprehja *push t'mejdanit* ka kuptimin: **1 pikë**

- A) sheshi i fshatit; B) sheshi i luftimit;
C) luginë mes malesh; D) zona në kufi mes dy vendeve.

14. Fjalët e mëposhtme, të shkëputura nga fragmenti, i shkruani në gjuhën standarde. **2 pikë**

- a) *përgjegjë*: _____ b) *dredhue*: _____

15. Në vargun: "*të lumtë goja, Baloz, mirë po thue*" shprehja *të lumtë goja* krijon efekt për shkak të kuptimit të veçantë me të cilin është përdorur. Cili është ky kuptim dhe me cilën figurë të fjalës realizohet?

- a) kuptimi: _____ **1 pikë**
b) figura: _____ **1 pikë**

16. Në këngët e epikës legjendare, peshën kryesore figurative e mban hiperbola. Gjeni në pjesën e mësipërme dy të tilla dhe interpretoni rolin e tyre në funksion të brendisë.

a) hiperbola 1: _____ **2 pikë**

hiperbola 2: _____

b) interpretimi: _____ **1 pikë**

17. Në fragment kemi rima foljore dhe emërore. Gjeni nga një shembull për secilin rast dhe shpjegoni efektin e tyre.

a) rimë foljore: _____ **1 pikë**

b) rimë emërore: _____ **1 pikë**

c) efekti: _____ **1 pikë**

18. Evidentoni tre momente kyç të brendisë së fragmentit, duke ndjekur rendin kronologjik të ngjarjes. **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

19. Gjergji i drejtohet Balozit duke i dhënë arsyen përse ndodhet përballë tij. Cila është kjo? Në cilin kod moral mbështetet? Interpretoni vargun që e jep këtë.

a) arsyeja: _____ **1 pikë**

b) kodi moral: _____ **1 pikë**

c) vargu: _____ **1 pikë**

d) interpretimi: _____ **1 pikë**

Vlerësimi :

NOTA	4	5	6	7	8	9	10
PIKËT	0 – 7	8 – 11	12 – 15	16 – 19	20 – 23	24 – 27	28 – 30

Çelësi i përgjigjeve:**Gjergj Elez Alija****Përgjigjet e pyetjeve me alternative:****Pyetja 1 B 1 pikë****Pyetja 2 A 1 pikë****Pyetja 3 C 1 pikë****Pyetja 4 D 1 pikë****Pyetja 5 C 1 pikë****Pyetja 6 B 1 pikë****Pyetja 7 A 1 pikë****Pyetja 8 C 1 pikë****Pyetja 9 D 1 pikë****Pyetja 10 B 1 pikë****Pyetja 11 A 1 pikë****Pyetja 12 A 1 pikë****Pyetja 13 C 1 pikë****Përgjigjet e pyetjeve me shtjellim:****Pyetja 14 - 2 pikë**

a) përgjigjur

b) dredhuar

2 pikë, nëse nxënësi i shkruan saktë të dy fjalët në përputhje me formën e përdorimit në fragment..**1 pikë**, nëse jep saktë vetëm njëren fjalë.**0 pikë**, nëse nuk jep asnjërën ose jep përgjigje të gabuar.**Pyetja 15 - 2 pikë**

a) kuptim i kundërt me atë që ka shprehja në fragment.

b) ironia.

2 pikë, nëse nxënësi jep kuptimin dhe figurën.**1 pikë**, nëse nxënësi jep vetëm njërin.**0 pikë**, nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 16 - 3 pikë**a) **hiperbolat:**

- qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit,....

- dymbdhetë pash n'ledinë u ngul topuzi,

- dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni.

- të tanë lumën gjaku e ka tërzue,

- për tri vjet krejt vendin e ka qelbun.

- A'trandë fusha kur a'rrxue Balози.

b) përdoren për të bërë përshtypje të madhe, për të vënë në dukje më mirë figurën dhe veprimet e heroit, tregon madhështinë e tyre në përmasa të çuditshme.

3 pikë, kur nxënësi gjen dy hiperbola dhe shpjegon funksionin e tyre.**2 pikë**, kur nxënësi gjen vetëm dy hiperbolat ose një hiperbolë dhe shpjegon funksionin e saj.

1 pikë, kur gjen vetëm një rënë hiperbolë.

0 pikë, kur jep përgjigje të gabuara ose asnjë përgjigje.

Pyetja 17 - 3 pikë

a) konke çue/ po thue/ m'ke dredhue/ m'ke kallzue/ kanë lanë/ia dhanë, ka shinue/ka fjurue/ka ardhë/ka dredhë, ka xjerrun/ka damun/ ka ngrehun/ ka mbytun/ ka qelbun/ .

b) mejdanin/çobanin/, topuzi/pluhni, mejdanit/vorrit/ dita/Alija/ .

c) krijojnë muzikalitet.

3 pikë, nëse nxënësi gjen nga një rimë për secilin rast dhe jep efektin që ato shkaktojnë.

2 pikë, nëse gjen një rimë dhe jep efektin, ose gjen vetëm dy rimat.

1 pikë, nëse nxënësi gjen vetëm një rimë.

0 pikë, nëse përgjigja nuk përshtatet me kërkesat ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 18 - 3 pikë

Pikat kyç të brendisë në këtë fragment, sipas kronologjisë së ngjarjes janë:

- nisja e ditës së re.

- dalja e trimave në fushë

- ndeshja me fjalë

- ndeshja me armë

- vdekja e Balozit

- triumfi i Gjergjit

Nxënësi do të rendisë në mënyrën e tij të të shprehurit tre nga momentet e mësipërme.

3 pikë, kur jep me rend kronologjik tre nga momentet.

2 pikë, kur jep dy nga momentet, ose jep tre.

1 pikë, kur jep vetëm njërin.

0 pikë, për përgjigje që nuk kanë lidhje me përgjigjet më lart ose nuk shkruan fare,

Pyetja 19 - 4 pikë

a) Gjergji ndodhet përballë Balozit, sepse ai i ka kërkuar motrën. Gjergji kërkon më parë të ndeshet me të.

b) Kodi është kanuni i të parëve.

c) Vargu: *se ne t'parit nji kanu na kanë lanë*.

d) Ky varg shpreh thelbin e zakoneve dhe traditave tona, mbi vlerat, konceptin e nderit dhe familjen. (përgjigja e nxënësit, e cila është shprehur në mënyrë individuale, duhet të përmbajë këtë ide).

4 pikë, kur nxënësi jep të gjitha përgjigjet e mësipërme.

3 pikë, kur nxënësi jep 3 nga përgjigjet më lart.

2 pikë, kur nxënësi jep dy nga përgjigjet më lart.

1 pikë, kur nxënësi jep vetëm një rënë nga përgjigjet më lart.

0 pikë, për përgjigje të gabuar, ose kur nuk shkruan fare.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

Modele të planifikimit ditor – Letërsi me zgjedhje 12 – Tremujori i tretë

JAVA I

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Gjergj Fishta – Lahuta e Malcisë Punim hulumtues 		Situatat e të nxënit: Analizë: <i>Ndikimi i folklorit në eposin kombëtar “Lahuta e Malcisë”</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - analizon motivet folklorike në veprën e Fishtës; - vlerëson rëndësinë e traditës popullore në të; - gjykon rreth vlerave të epikës popullore në veprën e Fishtës. 		Fjalët kyçe: <i>Eposi kombëtar, ndikimi i folklorit, Ali Pashë Gucia, amaneti, orët dhe zanat, etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> Krijime lirike të Porradecit; Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12) Teksti i nxënësit (Letërsia 12) Lahuta e Malcisë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	10 min
2.	Punë e drejtuar	Organizuesi grafik	15 min
3.	Punë e pavarur	Mendo – Krijë dyshe – Diskuto	15 min
4.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi¹:

• **Motivimi:**

Ora e mësimi mund të fillojë me dëgjimin e këngës “Ali Pashë Gucia” të interpretuar nga aktori i njohur Reshat Arbana. Këtë fragment mund ta shkarkoni në adresën e mëposhtme: <https://www.youtube.com/watch?v=5QIlgXo-sEeE>

• *Gjergj Fishta* është poeti epik i njohur si Homeri i Shqipërisë i cili me veprën e tij “Lahuta e Malcisë” krijoi eposin kombëtar të “Lahuta e Malcisë”, një poemë epike e cila ka një mbështetje të dukshme në eposin e kombëtar dhe epikën popullore.

• U kërkohet nxënësve përmes bashkëbisedimit të rikujtojnë disa nga veprat e tjera të tij ku duket më mirë mbështetja në folklor dhe ndikimi nga poezia popullore. Më pas, do të punohet me këngën VIII “Ali Pashë Gucia”, faqe 118..

Shënim:

• Në rast se për kushtet e klasës / shkollës apo nivelit të nxënësve nuk është e mundur të sigurohen materialet ndihmëse apo informacionet e kërkuara më lart, mund të punohet me materialin e tekstit mësimor të nxënësit faqe 117. Mësuesi orienton bashkëbisedimin ose e nxit atë duke përgatitur pyetjet e aparatit pedagogjik të tekstit.

1 . Nxënësit janë njohur me krijimtarinë e Gjergj Fishtës gjatë studimit në programin e letërsisë bërthamë. Gjatë kësaj ore mësimi do të punohet një prej këngëve të këti eposi që ndoshta nuk është trajtuar gjatë zhvillimit të analizës së veprës në lëndën e letërsisë bërthamë. Për këtë mësuesi mund të zgjedhë edhe këngë të tjera nëse kjo që është trajtuar në tekst mund të jetë e njohur për nxënësit.

2. Punë e drejtuar:

- Pasi kanë dëgjuar të interpretuar këngën nga artisti R. Arbana, nxënësit do e lexojnë atë në heshtje për të kuptuar rrëfimin e ngjarjes duke u ndihmuar për të kuptuar fjalorin dhe pasurinë gjuhësore të saj.

- Duke qenë se klasa do të ndahet në dy grupe (punë me çifte / dyshe), secilit grup i jepen detyra specifike duke shfrytëzuar edhe aparatën pedagogjik të tekstit.

Kuptojmë tekstin**1. Vargu i parë i kësaj kënge, ashtu si edhe në eposin e kreshnikëve, fillon me formulën hyrëse.**

- Cili është kuptimi i këtij vargu?

- Për çfarë na parapërgatit ai?

- Krahasojeni me vargun e këngës këngës *Martesa e Halilit: "Fort po shndrit njaj djell e pak po nxeh!"*

- Vargu i këngës është tipik për krijimet epike. Ai shërben si një hyrje e shkurtër për ngjarjen që do të pasojë dhe na parapërgatit se këto ngjarje do të jenë të papritura, nëse kemi parasysh se Ali Pasha është nisur për udhë dhe në këtë udhëtim ai do të ndeshet me Orën e Shqipërisë e cila do t'i dëftojë për fatin e vendit.

2. Ndani këtë fragment të këngës në tri pjesë sipas personazheve: Ali Pashë Gucia; Nëna; Nusja

- Identifikoni vargjet për secilën pjesë.

- Vendosni nga një titull sipas brendisë së tyre.

- Pjesa I- (vargu 1 – 14) – Përgatitja për rrugë

- Pjesa II – (vargu 15 – 30) – Amaneti për nënën

- Pjesa III – (vargu 31 – 59) – Porositë për gruan

3. Lexoni me kujdes vargjet: e mëposhtme nga Kënga VIII.

- Përcaktoni mjetet stilistike që ka përdorur autori në krijimin e përfytyrimit të Orës së Shqiptarisë.

- Parafrazojeni këtë përshkrim.

Kur qe shef logut tue ardhë

Nji si hije veshë në t' bardhë,

Si nji vashë qi fat vë s' parit,

Shterngue ijet me 'i shogë arit,

Edhë zhdredhun flokët giate shtatit 115

Si ato rrezet krës s' njaj shpatit

kur ban dielli per me lé

Neper brymë të nadjes s' ré.

Ardhun shtatit si breshana,

Si ajo vera e si ajo Zana, 120

Bite shpatit tue flakue,

Dér qi vjen e zen mbi krue,

Vjen e zen fill nder ylbera

Qi ndermjet t'stomeve t' blera

E per rreth t' argjente t' currilit 125

I trajtote rrezja e diellit.

Analizojmë tekstin**1. Para se të largohet nga shtëpia, Ali Pashë Gucia i le nënës së tij porositë e fundit.**

- Çfarë porosish i lë ai nënës së tij?

- Si shprehen në këto porosi vlerat tradicionale të shqiptarëve?

- Porositë që i le Ali Pashë Gucia, nënës së tij, janë disa nga vlerat kombëtare shqiptare të cilat Fishta kërkon t'i përcjellë si një mesazh për çdo lexues. Për këtë, është e rëndësishme që mësuesit të fokusohet në këtë drejtim të analizës dhe komentit të këngës, pasi për vlerat e tjera letrare dhe

gjuhësore, nxënësit janë fokusuar gjatë studimit të veprës në letërsinë bërthamë.

Porositë:

- Nderimi i miqve
- Mbështetja për të dobëtit (të varfërit)
- Të kujdeset për djalin e tij (vargu 19)

2. Në porositë që i lë nuses së vet, bie në sy dëshira e tij për djalin.

- Çfarë karakteristikash dëshiron ai të ketë djali i tij?
- Përshkruani shkurtimisht si e dëshiron Ali Pashë Gucia të bëhet djali i vet.

Karakteristikat për djalin:

- Bujar (fisnik)
- Shqiptar (në kuptimin e vlerave dhe karakteristikave)
- Kuvendar (do të thotë i fjalës dhe që di të kuvendojë)
- Luftëtar për adheun
- Besnin i zakoneve (kanunit)
- Prijës i zoti

3. Analizoni vargjet e mëposhtme:

*Ma mirë n' vorr m' u kja per mall,
Se nen Shkja me ndejë per t' gjallë!*

- Cili është kuptimi i tyre?
- Me cilin aforizëm popullor ju duket i ngjashëm?
- Kuptimi: *Më mirë i vdekur, sesa nën robëri*
- Ky varg është një parafrzim i fjalës së urët: *Më mirë një orë në liri se shekuj në robëri.*

3. Punë e pavarur:

Gjatë kësaj rubrike do të punohet në formën e një diskutimi detyra e dhënë në tekst:
Diskutim mësimor:

Duke rikujtuar gjithçka dini për epikën popullore, sidomos për ciklin e Mujit dhe Halilit, baladat dhe legjendat, bëni një ballafaqim ndërmjet tyre dhe poemës madhore “ Lahuta e Malcis” për të vërtetuar atë që thotë kritika se Fishta, si i fundmi rapsod vigan i Veriut, e ngriti epikën popullore në maja të reja të larta artistike.

Diskutimin organizojeni duke e përfshirë në temën: Foklori dhe Fishta

ORA E DYTË

4. Përgatitja e punës kërkimore:

- Nxënësit do të orientohen se si duhet të përgatitin punën kërkimore duke ju dhënë burimet e informacionit si edhe duke u mbështetur te materiali i tekstit.
- Sqarohen nxënësit se si duhet ta përgatisin materialin në formë të shkruar duke vendosur edhe kriteret për të cialt ata do të vlerësohen.
- Nxënësit informohen për mënyrën e vlerësimit të punës kërkimore duke i orientuar sipas sugjerimit të hënë me pikë në tabelën e mëposhtme.

Vlerësimi i punës hulumtuese:

- Realizimi i detyrës sipas të gjitha kërkesave dhe kriterëve të vendosura: - 50 pikë
- Respektimi i etikës dhe profesionalizmi në realizimin e detyrës: - 20 pikë
- Dorëzimi i detyrës në kohën e përcaktuar: - 10 pikë
- Realizimi me shkrim i detyrës në formën e një eseje shpjeguese - argumentuese: - 20 pikë

Konvertimi i pikëve në nota²:

NOTA		4	5	6	7	8	9	10
PIKËT		0 – 24	25 – 44	45 – 54	55 – 64	65 – 74	75 – 84	85 – 100

2. Kjo është vetëm një tabelë orientuese, pasi mësuesi mund të zgjedhë vetë se çfarë sistemi vlerësimi mund të përdorë.

JAVA II

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: • Epika historike		Situatat e të nxënës: Analizë – Koment: <i>Këngët e epikës historike dhe konteksti i tyre.</i>	
Rezultatete e të nxënës: • Nxënësi: - identifikon në tekste të ndryshme veçoritë e epikës historike; - vlerëson rëndësinë letrare dhe historike të këtyre këngëve; - gjykon rreth vlerave të këtyre krijimeve.		Fjalët kyçe: <i>Epika historike, epizmi, fryma heroike, karakteri realist, Skënderbeu, etj.</i>	
Burimet: • <i>Krijime të ndryshme folklorike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i>		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Vlerësimi i njohurive	Pyetje – përgjigje	20 min
2.	Informacioni i ri	Bashkëbisedim	10 min
3.	Punë e drejtuar	Analizë – Koment	15 min
4.	Punë e pavarur	Diagrami i Venit	20 min
5.	Reflektim	Shkrim i lirë	20
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Vlerësimi i njohurive:**

- Në varësi të detyrave të dhëna gjatë orës së kaluar, sugjerohet të lexohen ato nga nxënësit të ndryshëm dhe të vlerësohen prej të tjerëve duke dhënë mendime rreth tyre.

- Mësuesi vlerëson kryerjen e detyrës për portofol të dhënë orën e kaluar, e cila mund të vlerërohet edhe nga vetë nxënësit në formën e një diskutimi duke u mbështetur në kriteret e vendosura.

2. Informacioni i ri :• **Motivimi:**

• *Ora e mësimit mund të fillojë në formën e një bashkëbisedimi rreth epikës dhe ndarjeve të saj, duke u ndalur te epika popullore.*

• Epika legjendare

• Epika Historike

• U kërkohet nxënësit të lexojnë materialin mësimor në tekst, faqe 121 - 123 dhe të diskutohet rreth tij si edhe për krijimtarinë epike historike.

• Bashkëbisedimi zhvillohet me librin hapur dhe nxënësit mund t'i referohen atij në çdo kohë.

• Punohet detyra 1 e rubrikës pyetje dhe diskutime.

1. Këngët epike historike, ashtu si edhe këngët epike legjendare kanë në themel të tyre rrëfimin.

- Ku dallohen këngët historike nga ato legjendare?

- A ndërtohet njëllë dhe a kryejnë të njëjtin funksion hiperbolat dhe personifikimet në epikën historike dhe atë legjendare?

• Sillni shembuj të ndryshëm të këtyre këngëve dhe konkretizoni mendimin.

Këngët e epikës historike legjendare	Këngët e epikës historike
- ngjarjet nuk kanë bazë historike - personazhet janë imagjinarë - rol të rëndësishëm ka elementi fantastik - përdorimi i hiperbolës - mungojnë referimet konkrete të vendeve dhe kohës - karakterizohen nga fryma heroike e rrëfimit	- këngët i referohen një ngjarjeje historike - personazhet përgjithësisht janë realë - lidhjet me ngjarjet historike janë të drejtpërdrejta - fryma heroike e rrëfimit

3. Punë e drejtuar:

Analizë – koment:

- Pas vlerësimit të detyrës, kalohet në punimin dhe diskutimin e detyrave të dhëna në tekstin mësimor, faqe 123 në të cilën nxënësit do të punojnë të drejtuar nga mësuesi këngën “Skënderbeu dhe Ballabani”
Punohen ushtrimi 2 faqe 123 duke përdorur teknikën e diagramit të Venit ose tabelës së koncepteve, si më sipër.

2. Krahasoni këngën *Skënderbeu dhe Ballabani* me këngën *Gjergj Elez Alia*.

- Çfarë afrish dhe çfarë dallimesh ka mes tyre?
- Si janë portretizuar heronjtë?
- Cili është roli i hiperbolës dhe të jashtëzakonshmes në secilën prej tyre?

Skënderbeu dhe Ballabani	Gjergj Elez Alia

Në punimin e kësaj detyre, nxënësit i referohen tabelës së punuar më lart, veçorive të këngëve epike legjendare dhe këngëve epike historike.

Detyra punohet me ndihmën e mësuesit i cili udhëheq dhe orienton nxënësit në përgjigjet e tyre.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur

Mendo – krijo dyshe – diskuto:

- Gjatë orës së dytë, si vazhdim i tematikës së orës së parë, do të punohet detyra 3 faqe 124.

3. Krahasoni këngët historike të periudhës para pushtimit osman dhe ato të periudhës së pushtimit osman.

- Çfarë të veçante ka në to?
- Cila është figura kryesore e tyre?

5. Reflektim - Shkrim i lirë:

Në pjesën e dytë orës së dytë sugjerohet të punohet detyra 4 faqe 124.

4. Nga mënyra e ndërtimit këngët historike, zakonisht, paraqiten kështu:

- *Ekspozicioni i shkurtër* (me të dhëna për kohën, vendin, personazhet)
- *Zhvillimi i veprimit* (që zë vendin kryesor)
- *Vlerësimi* (i shkurtër i hapur ose i nënkuptuar i personazhit apo ngjarjes)

Analizoni këtë këngë të shkurtër historike mbështetur tek kjo skemë dhe rindërtoni ngjarjen në formën e një rrëfimi në prozë.

JAVA III

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Llojet dhe përmbajtja e përrallave Arti dhe vlerat e përrallave 		Situatat e të nxënimit: Diskutim: <i>Përrallat dhe vlerat e tyre</i>	
Rezultatete e të nxënimit: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> përcakton tiparet dhe formën gjuhësore të përrallave në krijimtarinë popullore; vlerëson rëndësinë dhe vlerat e përrallave; gjykon dhe interpreton rolin e këtyre krijimeve në trajtimin e të jashtëzakonshmes dhe imagjinatës. 		Fjalët kyçe: <i>përrallat, karakteristikat e përrallave, vlera e përrallave, funksionet e Propit etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> Krijime të ndryshme folklorike (vaje dhe gjama); Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12) Materiale nga interneti 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Psikologjia Antropologjia 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	10 min
2.	Diskutim	Pyetje – përgjigje për karakteristikat e përrallave	15 min
3.	Informacioni i ri	Leximi i drejtuar	20 min
4.	Punë e pavarur	Tabela e koncepteve	25 min
5.	Reflektim	Analizë me shkrim	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- Motivimi:**

Kjo orë mësimore mund të fillojë me motivimin e nxënësve për të folur dhe diskutuar rreth përrallave të cilat janë shumë të njohura dhe pjesë e jetës së çdo individi.

- Bashkëbisedimi mund të ndihmohet nga pyetje si më poshtë:
- Çfarë janë përrallat dhe ç'probleme trajtohen në to?
- Përmend disa nga personazhet e përrallave që ju njihni ose mbani mend.
- Përse përrallat janë ende të pëlqyera jo vetëm për fëmijët, por edhe për të rritur?

2. Informacioni i ri:

Pas këtij bashkëbisedimi, procesi i mësimin kalohet te materiali i tekstit faqe 128 – 129 (Llojet dhe përmbajtja e përrallave) dhe faqe 132 – 133 (Arti dhe vlerat e përrallave).

Ndonëse nxënësit kanë njohuri rreth përrallave, informacioni i ri ka të bëjë me disa njohuri të cilat do të ndihmojnë nxënësit të analizojnë dhe vlerësojnë, jo vetëm veçoritë e këtyre krijimeve, por edhe vlerat dhe funksionet e tyre. Informacioni i ndihmon të krijojnë një mendim kritik për to, duke kaluar nga faza e një leximi për t'u argëtuar, në një lexim për t'i vlerësuar dhe parë në

këndvështrimin kritik këto krijime të mrekullueshme.

Pas leximit të materialit, procedohet duke shpjeguar informacionin dhe duke u mbështetur te këto çështje:

- Karakteristikat e përrallave
- Përmbatja e përrallave
- Zanafilla e tyre
- Interpretimi i përrallave (disa prej teorive)
- Klasifikimi i përrallave
- Arti i përrallave
- Vlerat e përrallave

ORA E DYTË

3. Punë e pavarur:

Orën e dytë, pasi nxënësit të kenë diskutuar dhe njohur informacionin teorik rreth përrallave, do të punojnë në një analizë detyrat e dhëna në tekstin mësimor, faqe 130.

1. Këngët epike legjendare ngjajnë shumë me përrallat, megjithatë, ato ndryshojnë prej tyre.

- Cila është ndryshimi mes këngëve epike dhe përrallave?
- Ku duken ngjashmëritë e përrallave fantastike me këngët epike legjendare?
- Argumentoni përgjigjet tuaja duke konkretizuar me krijime konkrete.

2. Fantazia e përrallave bazohet në jetën shoqërore.

- Argumentoni këtë tezë duke u mbështetur tek një përrallë që ju e njihni mirë.

4. Shkrim i lirë

Duke i mbështetur në materialin e tekstit, faqe 130 – 131 “Zgjeroni njohuritë tuaja”, nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur me shkrim një analizë të një përralle që ata mbajnë mend ose dëshirojnë të analizojnë ose mund të punojnë me përrallat që janë sugjeruar në tekst.

3. Kujtoni përrallën “*Bukuroshja e fjetur*” ose përrallën “*Kësulëkuqja*” apo ndonjë përrallë tjetër që ju njihni më mirë

- Përcaktoni strukturën narrative të përrallës sipas skemës së Propit.
- A vini re ndonjë ndryshim?
- Diskutoni rreth kësaj skeme dhe funksionit të saj në përrallë.

Vlerësimi i punës:

Mësuesi është i lirë të vendosë kritere të ndryshme për vlerësimin e punës ose të përshtatë ato sipas specifikave të klasës. E rëndësishme është të motivohet nxënësi, të nxitet dëshira për punë dhe të respektohet mudi i çdo nxënësi.

JAVA IV

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Studim teksti “Valltarja me fustanellë” • Përsëritje e njohurive 		Situatat e të nxënit: Analizë – Studim teksti i një përralle mbështetur në informacionin e marrë.	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton veçoritë dhe karakteristika e përrallës; - vlerëson artin dhe vlerat e një përralle; - gjykon rreth funksionit të përrallës dhe vlerës morale të saj. 		Fjalët kyçe: Valltarja me fustanellë, heroi i përrallës, simbolika e saj, personazhet, etj.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • Krijime të ndryshme folklorike; • <i>Libra</i>, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin; • Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12) • Përralla shqiptare. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Bashkëbisedim	5 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar	10 min
3.	Punë e drejtuar	Analizë – Koment	30 min
4.	Punë e pavarur	Tabela e koncepteve	20 min
5.	Përsëritje e njohurive		20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Bashkëbisedimi:**

- **Motivimi:**

Ora e mësimit është vazhdim i temës së kaluar ku në qendër të saj trajtohen përrallat dhe vlerat e tyre.

Sugjerohet të diskutohen çështjet e orës së kaluar si edhe të bashkëbisedohet për gjëra apo koncepte të cilat mund të kenë mbetur pa u trajtuar.

2. Informacioni i ri:**Leximi i drejtuar**

Nxënësi orientohet të punojë me leximin e përrallës së dhënë në tekst faqe 134 – 135.

Ndonëse në tekst është dhënë kjo përrallë, mësuesi dhe nxënësit janë të lirë të punojnë përralla të ndryshme shqiptare të cilat mund t’i kenë sjellë me vete në klasë.

3. Punë e drejtuar – Analizë-Koment

Në pjesën e dytë të orës së parë do të punohet Studim teksti – faqe 135.

Mësuesi do të ndihmojë nxënësit për të analizuar dhe komentuar këtë fragment duke u mbështetur edhe nga aparati pedagogjik.

Kuptojmë tekstin

1. Kjo përrallë, përveç kënaqësisë dhe argëtimit, ka për qëllim të përcjellë disa vlera dhe mesazhe.

- Cila është domethënia e aventurave të vëllait të madh?
- Çfarë qëllimi ka ai? Çfarë simbolizon Valltarja me fustanellë?
- Pse vëllai i vogël ia doli të ngadhnjejë ndaj vështirësive dhe sfidave?
- Çfarë mesazhi përcillet përmes kësaj përralle?

2. Në përrallë vihet re mungesa e përshkrimit të gjerë, si të personazheve, ashtu edhe të situatave apo mjediseve.

- Si mendoni ju, kjo është diçka pozitive apo negative për këtë përrallë?
- Pse rrëfimtari popullor nuk e ka përdorur këtë teknikë?
- Ç’ndikim ka kjo tek imagjinata e lexuesit / dëgjuesit të përrallës?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

- Teknika “*Tabela e koncepteve*” përdoret për të bërë komentimin dhe vlerësimin e përrallës së dhënë në tekst.
- Përmes kësaj teknike, nxënësi punon individualisht duke u mbështetur te detyrat e rubrikës “Analizojmë tekstin” faqe 136.

Analizojmë tekstin

1. Mbështetur në tabelën e mëposhtme të personazheve të përrallës, sipas funksioneve të tyre, analizoni përrallën e dhënë më lart duke përshkruar shkurtimisht, për secilin personazh funksionin e tij si edhe veprimet e tyre konkrete në përrallë.

- *Kujtojmë se jo në të gjitha përrallat, funksionet dhe karakteret mund t’i gjejmë ashtu siç e ka përshkruar Propi.*

	Karakteri i përrallës sipas funksionit të tij	Personazhi konkret në përrallë që paraqet këtë karakter	Veprimet, qëndrimet apo sjellja e tij në përrallë
1.	HEROI I PËRRALLËS – <i>Personazhi që merr aventurën</i>	Vëllai i vogël	Të shpëtojë vëllanë e madh
2.	KUNDËRSHTARI OSE KEQBËRËSI – <i>Personazhi që i krijon pengesa heroit</i>	Plaka që rrinte nën arë	Të pengojë vëllezërit në realizimin e misionit

3.	NDIHMËSI – <i>Ndihmon heroin me fuqi magjike</i>	Plaka, bijtë e së cilës kishin frymë të mbinatyrshme.	Ndihmon vëllain e vogël të realizojë detyrën
4.	DHURUESI – <i>Përgatit heroin, pasi e ka testuar</i>	Bukëtari	Ndihmon vëllezërit të kuptojnë fuqinë e tyre
5.	DËRGUESI – <i>Shtyn heroin atë drejt aventurës</i>	Motra	Shtyn vëllezërit të gjejnë valltaren me fustanellë
6.	HEROI I REMË – <i>Përfiton nga heroi ose i veprimet e tij</i>	Vëllai i madh	Ai nuk arrin të realizojë detyrën që merr përsipër
7.	PRINCESHA OSE SHPËRBLIMI – <i>Çmimi apo synimi i heroit</i>	Valltarja me fustanellë	Çliron vëllain e madh dhe gjithë burrat e tjerë nga mallkimi

2. Pasi të keni plotësuar tabelën e mësipërme, përpikuni të analizoni si është ndërtuar përralla e dhënë.

- A është ndërtuar përralla sipas kësaj skeme?
- Çfarë ndryshimesh kini vënë re në të?
- Pse mendoni se rrëfimtari popullor i ka bërë këto ndryshime?

3. Mbështetur në këtë skemë, zgjidhni një përrallë tjetër dhe analizoni sipas kësaj skeme.

- A funksionoi skema?
- Ç'tregon kjo për mënyrën e ndërtimit të përrallave? **DETYRË PËR PORTOFOL**

Zgjidhni një përrallë të cilën e pëlqeni më shumë dhe sipas mundësive dhe aftësive tuaja, analizoni atë duke zgjedhur një prej formave të mëposhtme.

- a) Duke skicuar secilin personazh me anë të një grafike ose pikturë;
- b) Duke realizuar ilustrimin e saj me forografi apo aplikacione të ndryshme;
- c) Duke dramatizuar përrallën;
- d) Duke përshkruar me shkrim secilin personazh ose personazhin që ju pëlqeni më shumë.

Shënim! Detyra mund të realizohet në mënyrë individuale ose si punë në grup. Gjithashtu, për paraqitjen e saj mund të zhvilloni edhe një veprimtari argëtuese dhe zbavitëse në klasë, konkurs, dramatizim, ekspozitë etj.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

JAVA V

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Mitrush Kuteli – Studim teksti 1 – Rinë-Katerinëza • Studim teksti 2 – Furrxhiu i hapsanikëve 		Situatat e të nxënët: Analizë – Koment: <i>Rrëfimet dhe rrëfenjat e Mitrush Kutelit</i>	
Rezultatete e të nxënët: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin për rrëfimet dhe rrëfenjat; - vlerëson ndikimin e krijimtarisë popullore në prozën e Kutelit; - gjykon rreth vlerave letrare të krijimeve të Mitrush Kutelit. 		Fjalët kyçe: <i>Mitrush Kuteli, rrëfimet, rrëfenjat, ndikimi nga krijimtaria e folklorit, etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Rrëfime dhe rrëfenjat e Mitrush Kutelit</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi – Rrëfimet dhe rrëfenjat	10 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	10 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	25 min
4.	Punë e pavarur	Ditari dy pjesësh	25 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	15 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

• Motivimi:

• *Kjo orë mësimore mund të zhvillohet duke mbështetur në njohuritë nxënësve rreth autorit, Mitrush Kutelit të cilat janë trajtuar në klasën IX. Mësimi mund të fillojë duke kujtuar krijime të tij si edhe fakte nga jeta dhe krijimtaria e Mitrush Kutelit, në mënyrë sa më të përmbledhur.*

Mitrush Kuteli është pseudonim i Dhimitër Paskos. Ai u lind në Pogradec më 13 shtator 1907. Së pari ndoqi një kolegji tregtar në Selanik të Greqisë dhe më pas shkoi në Bukuresht të Rumanisë, në Akademinë e Shkencave Ekonomike, ku u diplomua për ekonomi më 1931 dhe në vitin 1934 mori gradën “Doktor i Shkencave Ekonomike” në fushën e çështjeve bankare. Në këtë kohë bashkëpunoi me gazetën shqiptare “Shqipëria e re” që botohej në Kostancë. Në vjeshtën e vitit 1942 u kthye në Shqipëri. Pas Çlirimit u emërua drejtor i Bankës së Shtetit Shqiptar. Më 1944 u bë bashkëthemelues i periodikut “Revista letrare”. Ishte anëtar themelues i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Gjatë regjimit komunist u përdoq dhe u burgos (1947-1949) për pikëpamjet e tij antijugosllave. Më pas, për afër 15 vjet, punoi si përkthyes letrar në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”. Vdiq më 4 maj 1967 në Tiranë. Mitrush Kuteli, bashkë me Ernest Koliqin, është themelues i prozës moderne shqiptare dhe njëri nga autorët më të njohur të letërsisë moderne shqiptare. Pas vdekjes, Mitrush Kuteli u dekorua me Urdhrin “Mjeshtër i Madh i Punës” Veprat e tij janë: *Netë shqiptare* (Kostancë, 1938; Tiranë, 1944); *Ago Jakupi e të tjera rrëfime* (Tiranë, 1943); *Kapllan Aga i Shaban Shpatës* (Tiranë, 1944); *Shënime letrare* (Tiranë, 1944); vëllimi me vjersha e poema *Sulm e lotë* (Tiranë, 1944); përmbledhja folklorike *“Këngë dhe britma nga qyteti i djegur”* (1944); vëllimi me pamflete *“Havadan më havadan”* (1944); *Dashuria e barbarit Artan* (1944); *Pylli i gështenjave* (1958); *Xinxifillua* (1962); *Tregime të moçme shqiptare* (1965). Pas vdekjes janë botuar: *Tregime të zgjedhura* (1972); *Baltë nga kjo tokë* (1973); *Në një cep të Ilirisë së Poshtme* (1983); *Net me përralla në fshatin e Qepëve*. Dhimitër Pasko njihet si ndër

përthyesit shqiptarë më prodhues. Ai bëri përkthime të shquara duke sjellë në shqip veprat më të njohura: *Frymë të vdekura* dhe *Tregimet e Petërburgut* të Nikolla Gogolit, *Tregimet e një gjahtari* të Ivan Turgenievit, *Fabula* të Ivan Krilovit, *Zotërinjtë Gollovliovë* dhe *Përralla* të Mikhail Sallitkov Shçedrinit, *Tregime të zgjedhura* dhe *Përrallat e Italisë* të Maksim Gorkit, *Rruga e mundimeve* të Aleksej Tolstoit, *Si u kalit çeliku* të Nikollaj Ostrovskit, poezi të Mihail Emineskut, Mihail Sadoveanut, Pablo Nerudës, Pol Eluarit etj.

2. Informacioni i ri:

Lexim i drejtuar

Në këtë pjesë të orës së mësimi nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme rrëfenjën “Rinë-Katerinëza” faqe 138-141 duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

- „**V**“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;
- „**-**“ vendoset në fund të informacionit i cili është ndryshe me atë që e dini ju;
- „**+**“ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;
- „**?**“ informacion që për ju është i pa qartë ose doni të dini diçka më shumë.

Gjatë kësaj veprimtarie, punohet detyra 1 – faqe 141.

1. Pasi të keni lexuar gjithë rrëfenjën, nënvizoni fjalët që e keni pasur vështirë për t'i kuptuar.

- Mundohuni të gjeni kuptimin e tyre duke shfrytëzuar fjalorët e gjuhës shqipe, ose duke pyetur më të rriturit.

- Përpiloni një fjalorth me to duke dhënë edhe sinonimet përkatëse ose shpjegimin.

Fjalor ndihmës:

- a- nuk kish kujt t'i **truhej** – nuk kish kujt t'i qahej, lutej, përgjerohej
- b- **unj** – trajtë dialektore për foljen “u”
- c- **çip** – trajtë dialektore për “cep, qoshe, kënd”
- d- **mandile** – shami
- e- **qivur** – trajtë dialektore për “arkivol, arkëmort”
- f- opinga **telanike** – oponga me lëkurë viçi (këtu: shumë të shtrenjta)
- g- **ruspi** – qenie mitologjike përfytyrohej si një grua e bukur, magjepsëse
- h- **shpes** – trajtë dialektore për “shpendë”
- i – **shërëmtiu** – tingëlloi fort
- j- **kurm** – trup
- k- **kopile** – këtu: shërbëtores

2. Pasuria e fjalorit dhe gjuha e kësaj rrëfenje është një nga vlerat e krijimtarisë së Kutelit.

- Gjeneri në tekst shprehjet frazeologjike të përdorura.
- Jepni sinonimet për secilën prej tyre.

3. Përshkrimi i personazheve në këtë rrëfenjë, shërben për të krijuar një atmosferë sa më të gjallë dhe reale.

- Si janë përshkruar dy personazhet kryesore, **Rina** dhe **Kirololoi**?
- Cilat cilësi ka theksuar më tepër autori: *fizike* apo *morale*?
- Plotësoni tabelën e mëposhtme për këto përshkrime.

RINA	KOROLLOI
<ul style="list-style-type: none"> • Jetime • Fatkeqe • _____ • _____ • _____ • _____ 	<ul style="list-style-type: none"> • Bandill • I bukur • _____ • _____ • _____ • _____

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst duke zhvilluar bashkëbisedim me ta ose mes tyre.

ANALIZojmë tekstin

1. Tregimin e mësipërme, ashtu siç e thotë edhe vetë autori, e ka ndërtuar mbi bazën e një rrëfenje popullore.

- Çfarë elementesh të përrallave popullore vini re në këtë rrëfenjë?
- Gjeni në të rastet e përdorimit të numrit tre.
- Identifikoni në tekst rastet e përdorimit të përsëritjes, ashtu siç edhe në krijimtarinë popullore.

2. Në rrëfenjë trajtohet motivi i fatit të keq të vajzës jetime dhe i marrëdhënieve të saj me njerikën.

- Gjeni motive të tjera në këtë prozë.
- Klasifikoni vargjet e ndërthurura në këtë prozë sipas funksionit të tyre dhe ngjashmërisë me ninullat, këngët e vajit etj.

3. Fantastikja është një kategori letrare në të cilat bota reale i lë vendin paraqitjes së botëve të tjera imagjinare, ku e arsyeshmja është zëvendësuar nga fantazia.

- Përcaktoni cilat janë në këtë rrëfenjë elementet fantastike.
- Përshkruani atmosferën në të cilën zhvillohet takimi i vashës me trimin.

4. Përqendrohuni në pjesët e tekstit ku Kuteli përshkruan “botën e përtejme”.

- Për ç’botë e ka fjalën ai?
- Si e përshkruan ai atë?

Kuptojmë tekstin

1. Titulli i këtij fragmenti është vënë për arsye studimi.

- Sa i përshtatshëm është titulli i këtij fragmenti?
- Shpjegoni përgjigjen tuaj duke argumentuar mendimin me hollësi nga teksti.
- Diskutoni mendimet tuaja në klasë duke mbajtur një qëndrim të caktuar.

2. Rrëfimi është një lloj proze e shkurtër të cilat trajtojnë tema sociale.

- Identifikoni disa prej temave sociale që dalin në këtë rrëfim.
- Ç’kohe historike i përkasin këto tema?
- Çfarë dallimi ka mes rrëfimit dhe rrëfenjës?

3. Gjyshi është personazhi kryesor i këtij fragmenti, përmes të cilit shtjellohen temat dhe ngjarjet.

- Përse i ndihmonte gjyshi të burgosurit?
- Cili është qëllimi i udhëtimit të tij?
- Si i gjykoni sjelljet dhe qëndrimet e gjyshit?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë do të punohet me studimin e fragmentit “Furxhiu i hapsanikëve” të dhënë në librin e nxënësit faqe 143-146. Mësuesi mund të vazhdojë edhe orën e dytë me trajtimin e rrëfenjës, nëse koha e orës së parë nuk është e mjaftueshme.

Për të analizuar këtë tregim, nxënësit do të punojnë në mënyrë të pavarur, duke bërë edhe dallimin mes rrëfimit karakteristik të kësaj proze dhe rrëfenjës në prozën e parë.

Analizojmë tekstin**1. Rrëfimi i këtij tregimi bëhet në vetën e tretë.**

- Cili është rrëfimtari në të?
- Çfarë raporti ka ai me personazhet?
- A ka ngjashmëri me rrëfimtarin e përrallave? Ku duket kjo?

2. Vini re me kujdes kohën e rrëfimit në këtë tregim.

- A ndryshon ajo gjatë rrëfimit?

- Si ndodh ky ndryshim dhe për çfarë arsye?

3. Karakteret në këtë tregim, mund të konsiderohen “të mësuara nga jeta”.

- Duke punuar në çift, ilustroni dallimet midis njohurive “të mësuara nga jeta” dhe atyre “të mësuara nga shkolla”.
 - Çfarë ndryshimi ka mes tyre?
 - Çfarë na mëson jeta dhe çfarë shkolla?
- Diskutoni dallimin e të mësuarit nga jeta në personazhin kryesor të këtij tregimi.

5. Diskutim:

Diskutimi në fund të orës së mësimi mund të zhvillohet edhe në ndarje me grupe.

DISKUTOJMË**1. Mitrush Kuteli është një nga përfaqësuesit më të mirë të prozës së shkurtër shqiptare.**

- Cilat janë disa prej veprave të tij?
- Çfarë keni lexuar ju prej veprave të tij?
- A ke elementë të jetës së autorit në krijimtarinë e tij?

2. Në krijimtarinë popullore, por edhe në letërsinë e shkruar, ka edhe raste të tjera të komunikimit mes dy botëve.

- Jepni disa shembuj të këtyre krijimeve.
- Diskutoni rreth këtyre krijimeve.

Analizojmë tekstin**1. Rrëfimi i këtij tregimi bëhet në vetën e tretë.**

- Cili është rrëfimtari në të?
- Çfarë raporti ka ai me personazhet?
- A ka ngjashmëri me rrëfimtarin e përrallave? Ku duket kjo?

2. Vini re me kujdes kohën e rrëfimit në këtë tregim.

- A ndryshon ajo gjatë rrëfimit?
- Si ndodh ky ndryshim dhe për çfarë arsye?

3. Karakteret në këtë tregim, mund të konsiderohen “të mësuara nga jeta”.

- Duke punuar në çift, ilustroni dallimet midis njohurive “të mësuara nga jeta” dhe atyre “të mësuara nga shkolla”.
 - Çfarë ndryshimi ka mes tyre?
 - Çfarë na mëson jeta dhe çfarë shkolla?
- Diskutoni dallimin e të mësuarit nga jeta në personazhin kryesor të këtij tregimi.

DETYRË PËR PORTOFOL

Mendoni përpara se të shkruani!

A jeni ndodhur ndonjëherë në një situatë ku të keni ndihmuar dikë që ju ka kërkuar ndihmë?**Përshtuani situatën.**

- Përse duhej ndihmuar personi?
- Çfarë ju shtyu ta ndihmonit atë?
- Çfarë bëtë? A e ndihmuat apo jo?
- Përse vendosët përfundimisht ta ndihmonit ose jo?
- Si u ndjetë pas marrjes së vendimit?

Çfarë ndikimi pati kjo për ju?

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

JAVA VI

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Ernest Koliqi – Studim teksti 1 – <i>Nusja e mrekullueshme</i> Studim teksti 2 – <i>Kërcimtarja e Dukagjinit</i> 		Situatat e të nxënit: Analizë dhe koment: <i>Proza moderne e Koliqit dhe ndikimi nga folklori</i>	
Rezultatet e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin për veçoritë e prozës moderne të Koliqit; - vlerëson ndikimin e krijimtarisë popullore në prozën e Koliqit; - gjykon rreth vlerave letrare të krijimeve të Ernest Koliqit. 		Fjalët kyçe: <i>Ernest Koliqi, proza moderne, ndikimi nga krijimtaria e folklorit, etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> <i>Hija e Maleve – Ernest Koliqi</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Motivimi – Rrëfimet dhe rrëfenjat	10 min
2.	Informacioni i ri	Lexim i drejtuar (INSERT)	10 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	25 min
4.	Punë e pavarur	Ditari dy pjesësh	25 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	15 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

• Motivimi:

Kjo orë mësimore mund të zhvillohet duke mbështetur në njohuritë nxënësve rreth autorit, Ernest Koliqi të cilat janë trajtuar në klasën IX. Mësimi mund të fillojë duke kujtuar krijime të tij si edhe fakte nga jeta dhe krijimtaria e Mitrush Kutelit, në mënyrë sa më të përmbledhur.

Ernest Koliqi u lind më 20 maj 1903 në qytetin e Shkodrës. Në vitet 1918-1922 studioi në një kolegji në Bergamo (Itali). Kthehet në Shqipëri në vitin 1924 dhe bëhet anëtar i shoqërisë “Bashkimi” të Avni Rustemit. Për rreth 5 vjet, ai do të largohet në Jugosllavi ku do të njihet drejtpërdrejt me letërsinë dhe shkrimtarët e gjuhës serbo-kroate. Në vitin 1929 rikthehet në Shkodër. Në vitet 1930-1933 do të punojë si mësues në Vlorë dhe Shkodër. Studimet e larta për letërsi i kreu në Padova në vitet 1933-1937 duke i përfunduar në mënyrë të shkëlqyer. Në vitin 1939 Ernest Koliqi emërohet ministër i Arsimit në qeverinë e kohës. Si ministër ai organizoi në Tiranë “Kongresin e Studimeve Shqiptare”, i cili themeloi “Institutin e Studimeve Shqiptare”. Në vitin 1942 largohet nga Ministria e Arsimit dhe bëhet president i këtij instituti.

Në vitin 1943 vendoset në Romë ku punon si profesor i albanologjisë në katedrën e gjuhës shqipe në Universitetin e Romës. Nga viti 1957 dhe deri në fund të jetës, për 18 vite me rradhë, botoi revistën “Shejzat”. Ernest Koliqi vdiq më 15 janar 1975.

2. Informacioni i ri:

Lexim i drejtuar

Në këtë pjesë të orës së mësimi nxënësit drejtohen të lexojnë në mënyrë të vëmendshme prozën “Nusja e mrekullueshme” faqe 149-151 duke i orientuar se si të punojnë me tekstin përmes teknikës së leximit të drejtuar.

Për këtë mund të përdoren kodet e mëposhtme:

- „√“ vendoset në fund të informacionit që për ju ka qenë i njohur;
- „-“ vendoset në fund të informacionit i cili është ndryshe me atë që e dini ju;
- „+“ informacioni që për ju është i ri, keni mësuar diçka të re;
- „?“ informacion që për ju është i pa qartë ose doni të dini diçka më shumë.

3. Veprimtari e drejtuar:

Nxënësit do të punojnë detyrat e dhëna në tekst duke zhvilluar bashkëbisedim me ta ose mes tyre.

Kuptojmë tekstin

1. Tregimi është ndërtuar nga disa pjesë përbërëse rrëfimtare ku ndërthuret rrëfimi i jashtëzakonshëm dhe përshkrimi i mrekullueshëm.

- Ndani tregimin në pjesët përbërëse sipas rrjedhës së rrëfimit.
- Vendosni për secilën prej pjesëve që keni identifikuar, nga një titull të përshtatshëm.
- Dalloni në secilën prej tyre pjesët rrëfimtare nga ato përshkruese.

2. Rrëfimi, si edhe në përrallat e legjendat popullore, ndërthur elementet reale me ato fantastike.

- Renditni disa prej elementeve (motiveve) fantastike të këtij tregimi.

Elementët fantastikë:

3. Ashtu si edhe në rrëfimin e Kutelit, në këtë tregim kemi rrëfimin për rrëfimin.

- Në çfarë vete është realizuar rrëfimi?
- Cili është rrëfimtari në këtë tregim?
- Çfarë rol luajnë ndërhyrjet në rrëfim të Don Markut?
- A ka ngjashmëri me rrëfimin në krijimet popullore?

ANALIZOJMË TEKSTIN

1. Trajtimi i mitit të dashurisë së Lekës me Shtojzavallen përfton disa elemente të mitit të Narcizit.

- Gjeni dhe lexoni mitin e Narcizit.
- Cilat janë motivet e ngjashme me të?
- Çfarë ndryshimesh ka bërë autori në tregimin e tij?

2. Sjellja dhe qëndrimi i Lekës, pas natës së parë të takimit me Shtojzavallen, ka ndryshuar krejt.

- Nënvizoni në tekst fjalitë ku duken këto qëndrime dhe sjellje të tij.
- Çfarë ju bie në sy në sjelljen e tij?
- A ju ka ndodhur ndonjëherë të ndiheni kështu? Kur?
- A është reale dhe e natyrshme kjo sjellje? Si motivohet ajo?

3. Analizoni dialogun e Lekës me nënën.

- Identifikoni në të disa prej bestytive dhe paragjykimeve.
- A ekzistojnë edhe sot të tilla bestytini dhe supersticione?
- Përse mund të kenë shërbyer apo shërbejnë edhe sot ato?

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur:

Gjatë orës së dytë do të punohet me studimin e fragmentit “Kërcimtarja e Dukagjini” të dhënë në librin e nxënësit faqe 154-155.

Kuptojmë tekstin

1. Është një nga tregimet më të arrira të Koliqit, ku vëmendja e autorit përqendrohet në theksimin e bukurisë fizike dhe shpirtërore të femrës shqiptare.

- Si e përshkruan Koliqi portretin fizik të turkeshës?
- Si harmonizon lëvizjet e trupit me gjendjen shpirtërore të vajzës shqiptare?
- Pse tek turkesha përshkruhet trupi, kurse tek Lulja natyra e saj?

2. Në tregim trajtohet motivi i shndërrimit të vajzës një një zanë.

- Cilat janë disa nga elementët etnikë që e bëjnë vashën të ngjashme me Zanën e Malit?
- Çfarë ndikimi ka fakti që vajzën autori e përcakton si mbesë të Lekë Dukagjinit?

analizojmë tekstin

1. Koliqi në këtë tregim përdor dendur mbiemrin.

- Plotësoni tabelën e mëposhtme me mbiemrat që përdor autori në përshkrimin e dy vajzave.

TURKESHA	LULJA
-shtat-hjedhun	-e drejtë (si curril)
-	-
-	-
-	-
-	-

- Krahasoni këto dy përshkrime duke vënë në pah imazhin që krijojnë ato.

2. Rrëfimi në këtë tregim është një nga veçoritë e stilit të Koliqit që e bën këtë tregim shumë të ngjashëm me krijimtarinë popullore .

- Në çfarë vete ndodh rrëfimi?
- Çfarë raporti vendos rrëfimtari me lexuesin?
- Cili është reagimi i personazheve në fund të fragmentit?

3. Një nga veçoritë e stilit të Koliqit është se ai i sheh i sheh personazhet e tij nga një këndvështrim i veçantë.

Bota e tyre shpjegohet me ndryshimet që ndodhin duke lidhur veprimet me gjendjet, duke i parë ata të funksionojnë në bazë të lidhjeve shkak-pasojë ose nga brenda – jashtë.

- Argumentoni këtë përfundim duke analizuar personazhin e Lules, veprimet dhe gjendjen e saj në këtë fragment.

5. Diskutim:

Diskutimi në fund të orës së mësimi mund të zhvillohet edhe në ndarje me grupe.

DISKUTOJMË

Rrëfimtari (autor) në fund të historisë pyet:

A i beson prifti ndodhjes qi â tue më kallzue?

Po ky Malsuer i ri, në syt e të cilin veton një inteligencë natyrore e jashtëzakonshme, a është viktimë i një alucionacioni a po vërte hero i ksaj aventure të pandëgjuese?

- Kujt ia drejton ai këtë pyetje?
- Po ju a i besoni kësaj historie?

Çfarë mendoni se mund të fshihet pas veshjes fantastike dhe të jashtëzakonshme?

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsia me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Studim teksti: <i>Plaku i Ylynecit</i> 		Situatat e të nxënit: Analizë – Koment: <i>Interpretimi alegorik i tregimit. Ndërthurja e reales me irealen.</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimin për këtë prozë alegorike; - interpreton simbolikën e saj; - gjykon rreth vlerave letrare të prozës dhe ndërthurjen e reales me të jashtëzakonshmen. 		Fjalët kyçe: <i>Plaku i Ylynecit, realja dhe irealja, interpretimi simbolik, vlerat dhe antivlerat, koha dhe rrjedha e saj etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> <i>Lumo Skëndo “Or’ e fundit”</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> Gjuha shqipe Historia Sociologjia Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Diskutimi i detyrave të shtëpisë	10 min
2.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim Studim teksti	20 min
3.	Reflektim	Diskutim i lirë	10 min
4.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË**1. Hyrje:**

Në fillim të kësaj ore mësuesi mund të vlerësojë detyrat e nxënësve ose edhe detyrën për portofol duke zhvilluar një diskutim rreth saj.

Kjo veprimtari mund të rishihet në varësi të ecurisë së procesit mësimor gjatë orës së kaluar. Më pas kalohet në leximin dhe studimin e tekstit të dhënë “Plaku i Ylynecit”

2. Punë e drejtuar:

- Lexim i drejtuar:**

Tregimi: “Plaku i Ylynecit” – faqe 157 – 160

Në këtë tregim të Lumo Skëndos ndihet shkrirja e teknikave krijuese, bashkëekzistenca e reales me të jashtëzakonshmen në një botë konkrete.

Kalimi nga dimensionimi real në atë fantastik bëhet në mënyrë të pakuptueshme dhe pa u ndier. Kur e pranon dje bisedon normalisht me të.

Në këtë prozë ndërthuret koha konkrete me tejkohësinë. Rrëfimtari shkëputet nga realja dhe kalon në një dimension fantastik. Dimensionimi kohor ku shfaqet Plaku i Ylynecit që është vetë simbol i kohës, është tejkohësi. Aty e shkuara dhe e tashmja shkrihet në një.

- Bashkëbisedim:

- Në vijim të punës analizuese për këtë tregim do të përqendrohet studimi i tekstit të zërbërthimit i kuptimit të tij alegorik.

- Përshkrimi i tablove reale
- Rrëfimi ireal
- Ndërthurja me fantastiken
- Kuptimi filozofik i kohës
- Simbolika e kontekstit historik

Gjatë këtij bashkëbisedimi do të punohet pyetjet e aparatit metodik të tekstit, faqe 160.

Kuptojmë tekstin

1. Tregimi i mësipërm, edhe pse nuk ka një subjekt të mirëfilltë, është ndërtuar në disa pjesë.

- Ndani tregimin në pjesët përbërëse sipas kuptimit të tyre.

• **Përshkrimi realist**

(nga fillimi deri tek paragrafi: *Oh, jeta, jeta, kjo jetë që na lidh kaqë shumë në vuajtjet, në mundimet, në lodhjet, jeta për të cilën durojmë të gjitha të këqijat edhe që i ndaheni me aqë tmerr, me aqë hidhërim!*)

• **Rrëfimi ireal**

(deri në paragrafi: *Shkëmbi u mbyll përnjëherë dhe nuk mbeti veçse faq' e ftohtë dhe'e fortë e tij.*)

- Ndërthurja me historinë dhe meditimi

- Cila është gjendja shpirtërore e rrëfimtari?

• Gjendja shpirtërore e tij pasqyron shqetësimin dhe frikën për fatet e këtij vendi i cili në mënyrë simbolike jepet me djepin i cili është në tëhun e një brisku: *(Po, o tmerr! Ahere vure re se djepeja ish vënë mbi një mur të hollë si katrë, si presë brisku: mënjane të murit ish ay vënt' i shkretuar i vdekjes, dhe n'anë tjetër luadh i bukur i rrojtes. Edhe djepeja po tundesh në të dy anët, si një zemberek sahati.)*

- Çfarë e shkakton këtë gjendje?

• Kjo gjendje shkaktohet nga të papriturat e historisë dhe enigmës së madhe që lind në mendjen e rrëfimtari për ardhmërinë e vendit të tij.

2. Fantastikja dhe realja ndërthuren në këtë tregim duke krijuar imazhet fantastikes, si një veçori kjo edhe e prozës popullore.

- Identifikoni paragrafët ku përshkruhet natyre shqiptare.

- Çfarë përshtypje krijon ky përshkrim të ju?

- Me çfarë mjetesh letrare realizohet ajo?

- A ndodh natyrshëm kalimi nga realja të irealja?

3. Punë e pavarur:

Gjatë pjesës së dytë do të punohet me studimin e tekstit "Analizojmë tekstin" duke punuar detyrat e dhëna në tekst si më poshtë:

analizojmë tekstin

1. Bota ireale është ndërtuar në këtë tregim alegorik si një imazh dantesk i Ferrit dhe Parajsës.

- Si është paraqitur secila prej këtyre botëve?

- Plotësoni tabelën e mëposhtme me hollësi nga tregimi.

	FERRI	PARAJSA
MJEDISI	- - - - - -	- - - - - -
NJERËZIT		

- Çfarë raporti krijohet mes këtyre mjediseve?

2. Ky tregim është shkruar në vitin 1913, vite të mbarsura me shumë rreziqe për Shqipërinë dhe shqiptarët.

- Nisur nga ky kontekst historik, shpjego kuptimin simbolik të imazhit që përcillet përmes fjalëve të të gdhendura në djep

- Çfarë simbolizon “djepi”?

- Pse ai tundet mes “jetës” dhe “vdekjes”?

- Nga kush varet fati i foshnjës në djep që qëndron mes jetës dhe vdekjes?

3. Diskutim i lirë:

Në pjesën e fundit të mësimit do të diskutohet duke iu përmbajtur kërkesës së ushtrimit 3 faqe 161.

Tregimi i mësipërm ndërthur realen dhe irealen, fantastiken dhe të jashtëzakonshmen, ashtu si edhe në përrallat popullore apo krijimet legjendare.

- Çfarë ngjashmërie dhe çfarë dallimi vini re mes tij dhe një krijimi popullor?

- Cili është funksioni i të jashtëzakonshmes dhe fantastikes në këtë tregim? Po tek përrallat apo legjendat?

- Ku ndryshon letërsia e kultivuar nga krijimet popullore?

JAVA VII

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: • Studim teksti: <i>Dranja</i>		Situatat e të nxënit: Analizë – Koment: <i>Interpretimi alegorik i madrigaleve.</i>	
Rezultatete e të nxënit: • Nxënësi: - përcakton kuptimin për veprën dhe madrigalin; - interpreton simbolikën e madrigaleve; - gjykon rreth vlerave letrare të kësaj vepre.		Fjalët kyçe: <i>Dranja, interpretimi simbolik, madrigali, ndikimi nga mitologjia dhe krijimtaria folklorike etj.</i>	
Burimet: • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Martin Camaj “Dranja”</i>		Lidhja me fushat e tjera: • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Diskutimi rreth veprës dhe autorit	10 min
2.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim Studim teksti	20 min
3.	Reflektim	Diskutim i lirë	10 min
4.	Vlerësimi		5 min

ORA E DYTË

1. Hyrje:

Në fillim të kësaj ore mësuesi mund të zhvillojë një bisedë për Camajn duke pasur parasysh se informacionet dhe trajtimin që nxënësit kanë bërë për këtë autor dhe veprën e tij në lëndën e letërsisë bërthamë. Meqënëse trajtimi veprës poetike të autorit është realizuar në lëndën e letërsisë bërthamë, sugjerohet të trajtohet studim teksti i veprës në prozë “Dranja”.

Nxënësit mund të lexojnë informacionin e dhënë në faqen 164.

2. Punë e drejtuar:

• **Lexim i drejtuar:**

Madrigalet: “Si doli emni prej gurit” dhe “Në mitologjinë popullore – faqe 165

- **Bashkëbisedim:**

Gjatë këtij bashkëbisedimi do të punohet pyetjet e aparatit metodik të tekstit, faqe 166.

Kuptojmë tekstin

1. Rrëfenjëzat e librit “Dranja” kanë në thelb të tyre nga një ngjarje apo rrëfim.

- Identifikoni ku ndodh ngjarja në rrëfenjzën e parë.

- Ngjarja ndodh në bjeshkë, vendi i zanave dhe orëve të mitologjisë shqiptare.

- Çfarë u ka ndodhur kositisve të barit?

- Ata kanë gjetur ashtin e një breshke.

- Cila është frika e tyre më e madhe? Pse?

- Frika më e madhe është ajo nga gjarpri, i cili është simbol i së keqes. Gjarpri është një kafshë për të cilën ka kulte në shumë kultura. Ai është një figurë shumë e rëndësishme edhe në mitologjinë

shqiptare me prejardhje që nga ilirët

- Me çfarë lidhet kjo frikë?

2. Në rrëfenjëzat e mësipërme autori na jep disa interpretime mitologjike dhe folklorike të legjendave për breshkën.

- Cilat janë këto mite apo legjenda për breshkën?

- A keni dëgjuar ndonjë prej tyre?

- Nëse po, ritregojeni në klasë.

3. Në themel të veprës poetike, *udha dhe udhëtimi*, janë nusja e ngurosur, është kali mitik që çon të ringjallurin shtatë male kaptuar etj.

- Si janë dhënë në mënyrë simbolike, te rrëfenjëzat (madrigalet) e mësipërme këto motive?

- Plotësoni tabelën e mëposhtme duke ju referuar të dy rrëfenjézave (madrigaleve).

Motivet mitologjike / Folklorike	Referimi në tekst (fjalia / fjalitë përkatëse)	Kënga legjendare ku hasen këto motive
Motivi i ngurimit	Mirë - thanë ata - na e dimë qëmoti se nema e Orëve ndërron në shkamb çdo gja, edhe bariun me tufë përpara,	Këngët e Ciklit të Kreshnikëve – Zana nguron krushqit e Mujit që nuk kanë respektuar këshillën që ju dha Muji.
Motivi i ringjalljes	Në një përrallë ajo na del pula e dreqit, me shtrigën kaluer mbi shpinë.	Kujtojnë se kjo skenë e përshkruar në këtë legjendë është e ngjashme me legjendën e Kostandinit dhe Doruntinës. Ku varri bëhet kalë, ashtu si ashti i breshkës mbart në shpinë gjarprin e ngurosur.

3. Punë e pavarur:

Gjatë pjesës së dytë do të punohet me studimin e tekstit “Analizojmë tekstin” duke punuar detyrat e dhëna në tekst si më poshtë:

Analizojmë tekstin

1. Figurën e *gërresës* dredha dredha si udhë që përshkon gjysmën e globit, mbi rrashtën e breshkës, pa gjarprin mbi të, poeti e lidh me përjetimin e izolimit dhe kërkon shteg të dalë, të arratiset.

- Përmendni disa prej çasteve kryesore të jetës së autorit që lidhen me këtë imazh poetik.

- A mendoni se autori përmes kësaj simbolike, kërkon të sfidojë izolimin e vendit të vet?

- Si është dhënë në mënyrë simbolike ky izolim?

- A është vetëm izolim i vendit apo edhe i vetë autorit?

2. Përmes figurës mitologjiko-realiste të Dranjës, autori koncentron një varg simbolesh që konvergojnë tek mesazhi i përsosjes morale dhe shpirtërore.

- Përmendni disa prej cilësive që autori i atribuon breshkës Dranja.

- Çfarë sjellje tregon ai për të?

- Kujt i referohen këto cilësi, breshkës apo njerëzve?

3. Diskutim i lirë:

diskutojmë

Në përfundim të këtij libri, autori duket se kërkon të përcjellë mesazhin sa vlen një mbijetesë që ka si kusht një qenie të papërkryer, sa vlejnë vlerat e kryehershme nëse ato bëhen pengesë për qytetërimin, sa vlen qëndresa pa zhvillim, sa vlen jeta pa kuptim, sa vlen vetmia pa qëllim.

Diskutoni rreth këtyre çështjeve në klasë duke iu referuar realitetit të sotëm.

MODELE TË PLANIFIKIMIT DITOR

JAVA VIII

Fusha: Gjuhë dhe komunikim	Lënda: Letërsi me zgjedhje 12	Shkalla: VI (e gjashtë)	Klasa: 12
Tema mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Proverbat dhe gjëgjëzat • Folklori dhe e qeshura (anekdotat) 		Situatat e të nxënit: Bashkëbisedim: <i>Urtësia popullore në krijimin e proverbase dhe humorit.</i>	
Rezultatete e të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon urtësinë popullore në interpretimin e proverbase, gjëgjëzave dhe anekdotave; - vlerëson mjetet e krijimit të komikes dhe shprehjes së filozofisë popullore; - gjykon rreth vlerave dhe mesazhit universal që përcjellin proverbat, gjëgjëzat, humorin. 		Fjalët kyçe: <i>proverbat, gjëgjëzat, anekdotat, humori, filozofia popullore, lojërat zbavitëse etj.</i>	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Krijime të ndryshme lirike;</i> • <i>Libra, artikuj enciklopedie, shkrime të tjera për folklorin;</i> • <i>Teksti i nxënësit (Letërsia me zgjedhje 12)</i> • <i>Krijime folklorike: fjalë të urta, gjëgjëza, anekdota</i> 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • Gjuha shqipe • Historia • Sociologjia • Arti 	

Metodologjia:

Nr.	Veprimtaritë	Metodat	Koha
1.	Hyrje	Di / Dua të di / Mësoj	10 min
2.	Informacioni i ri	Leksioni i përparuar	20 min
3.	Punë e drejtuar	Bashkëbisedim	15 min
4.	Punë e pavarur	Lojëra zbavitëse	20 min
5.	Reflektim	Diskutim i lirë	20 min
6.	Vlerësimi		5 min

ORA E PARË

1. Bashkëbisedimi:

• **Motivimi:**

• *Ora e mësimimit mund të fillojë përmes teknikës “Di / Dua të di/ Mësoj e cila konsideron të njohura shumë prej informacioneve dhe njohurive që nxënësit kanë rreth Proverbave – Gjëgjëzave – Anekdotave.*

• Mësuesi sugjerohet që gjithë orën e mësimimit ta konceptojë si një veprimtari zbavitëse mësimore duke kërkuar fillimisht të dijë çfarë njohuri kanë nxënësit rreth këtyre krijimeve folklorike, sa të qartë e kanë konceptin si edhe dallimin mes secilit krijim.

• Për këtë ai ndërton pyetjet ose fillon me shembuj konkretë duke pyetur ndoshta një gjëgjëzë, duke kërkuar shpjegimin e kuptimit të një proverbi apo duke treguar edhe një anekdotë.

• Më pas, për të saktësuar, përforcuar dhe sqaruar të plotë konceptet mund t’i referohet tekstit mësimor në faqet 167 për Proverbat; 168 për Gjëgjëzat; 171 – 173 për anekdotat dhe krijimin e të qeshurës. Kjo veprimtari mësimore realizohet përmes teknikës “Leksioni i përparuar”.

2. Informacioni i ri:

Leksioni i përparuar

Kjo teknikë në zhvillohet në etapën realizimit të kuptimi dhe procedohet në këtë formë:

1. Pjesëmarrësit bashkohen në dyshe

2. Secila dyshe duhet të bëjë një listë të të gjitha gjërave që ata i dinë për problemin

(kjo bëhet për këtë, keni 4 minuta kohë).

3. Pas katër minutash, mësuesi u thotë dysheve që t'ua tregojnë edhe të tjerëve në grup ato që kanë gjetur, idetë shkëmbehen brenda grupit.

4. Shkruhet në dërrasë të zezë një listë me mendimet e nxënësve

Para leximit, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit ta përcjellin listën e ideve dhe të shtojnë ide të reja në listë.

5. Fillohet me leximin e pjesës së parë të leksionit (materialit të dhënë në tekst).

6. Mbahet lista përpara kur lexohet .

7. Pas leximit rishikohen listat, nëse ka gjëra që janë lexuar dhe i kemi në listë dhe cilat janë gjërat e reja që janë mësuar, radhiten në listë.

8. Duke punuar në dyshe, ju lutem rendisni ato që dini rreth këtyre çështjeve. Për këtë keni 3 minuta kohë .

9. Pas tre minutash mësuesi u kërkon nxënësve të mos shkruajnë më dhe fton disa prej tyre të flasin për idetë që kanë shënuar.

10. Pastaj mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë me vëmendje pjesën tjetër të leksionit, duke pasur para listen e tyre të ideve.

11. Pas leximit krahasohet lista e ideve me ato që u thanë në lexim.

12. Në fund nga grupet kërkohen vullnetare për të dhënë disa nga idetë e tyre.

3. Veprimtari e drejtuar:

Gjatë kësaj etape do të punohet rubrika “Pyetje dhe diskutime” faqe 168¹.

Pyetje dhe diskutime

1. Fjalët e urta (proverbat) si krijime të përfshira në prozën popullore nuk kanë të zhvilluar një subjekt.

- A mund të ketë fjalë të urta pas të cilave të fshihet ndonjë “histori”?

- Nëse po, përpiquni të kujtoni ndonjë prej tyre.

- Çfarë historie mund të fshihet pas proverbit: *“Dhelpra që nuk i arrin rrushtë, thotë janë të pabërë”*?

2. Më poshtë janë dhënë disa fjalë të urta.

- Analizoni kuptimin e fjalës së urtë numër 8.

- Identifikoni mjetet stilistike të përdorura tek fjalët e urta numër 22, 28.

- Shpjegoni karakterin përgjithësues të fjalëve të urta numër 25 dhe 28.

1. **Shënim!** Mësuesi duhet të tregohet i kujdesshëm në trajtimin e kuptimit dhe shpjegimit të fjalëve të urta. Ato janë krijuar në epoka të ndryshme historike dhe në to pasqyrohet mendimi filozofik dhe urtësia popullore që shpreh këtë kontekst, ndaj duhen interpretuar duke respektuar këtë kontekst historik dhe kulturor. Le të kujtojmë këtu proverbin: *Ai që ndërton me djersë, mbron me gjak*. Ndonëse duket si një proverb që shpreh vlerën e punës (djersës), në kontekstin e sotëm ai shpreh një koncept që bie ndesh me parimet e së drejtës, pasi në një shoqëri të civilizuar konfliktet dhe mosmarrëveshjet zgjedhen me drejtësi dhe jo me hakmarrje. Kjo është edhe arsyeja, që këto krijime duhen parë me një sy kritik dhe vlerësues duke iu referuar kontekstit historik, social dhe kulturor të kohës.

ORA E DYTË

4. Punë e pavarur: Lojëra zbavitëse

Kjo teknikë është e përshtatshme në këtë fazë të orës së mësimit, pasi nxënësit kanë trajtuar dhe sqaruar konceptet për tematikën dhe kanë shpjeguar përmbajtjen e këtyre krijimeve.

Në këtë fazë ata mund të punojnë duke u ndarë edhe në grupe ose punë në çift, duke zhvilluar, ndoshta edhe konkurs në klasë.

Loja mund të zhvillohet si konkurs me gjëgjëza dhe anekdota si edhe shpjegim të ndonjë proverbi. Mund të shërbejnë për këtë edhe gjëgjëzat lojë në faqen 170.

1. – Ku vini ore burr' e grua?

- M'i març të keqen këtij e mua,
se nuk jemi burr'e grua,
po imë tëmën e këtij e ka vjehërë. (babai dhe vajza)

2. –Puna mbarë, o burr' e grua!

- Neve s'jemi burr' e grua,
e ëm' e këtij është e vjehrra e burrit tim. (motër dhe vëlla)

3. – Mori çikë, mori lopare ,
njqind lop' ku i pate?

-More djal' nuk janë njqind,
me kanë edhe q'aq,
edhe çerek i tyne,
e unë me to,
bahen njqind. (ajo ka 44 lopë)

4. Janë ca pula dhe një pemë,
kur pulat hipin mbi degët e pemës dy e nga dy
mbetet një degë pa gjë;
kur hipin një e nga një mbetet një pulë në shesh.
Sa pula janë, sa degë ka pema? ()

5. Reflektim: Diskutim i lirë

Në pjesën e fundit të orës së mësimit, në varësi të mundësive, nivelit të klasës si edhe ecurisë së saj, mund të punohen detyrat e rubrikës “Pyetje dhe Diskutime” faqe 173.

JAVA IX

Test përmbledhës për tremujorin e tretë
 Test përmbledhës për Prozën popullore

Studim teksti:**Rinë-Katerinëza - (fragment)**

Aq fort e deshi Kirolo Katerinëzën, sa desh ta bënte mollë ta mbante në gji.

- Ç'do deshe të bëhesh ti, o im zot?
- Qipariz, o vasha ime.
- Edhe un driz' e bardhë...

Sa të lumtur ishin që të dy! Rrinin mbi gurë të varrit e u dukej sikur bridhnin nëpër qiell, ne zonja Hënë, ne Kashta e zotit Kumtër e më tej, mal mbi mal e fushë mbi fushë.

Vonë fort Kirololoi hapi gojën e foli:

- Si do që ta lidhim besën, moj ftujza ime? A vjen ti në atë jetë, a të vij unë këtunë?
- Rinë- Katerinëza rrinte e mejtuar.

Vështronte hënë në lart, ujërat poshtë, bar e pemë rreth e rrotull...

Kaq bukuri anembanë, o zot i madh! - Si të ndahesh nga kjo botë?

E meqë ish muaji maj e meqë ish shoshur që lart një re udhëtare, s' di se nga vinte një erë e ëmbël unapi-kaq e ëmbël, sa të bënte të mbyllje sytë. Tjetër gjë më të ëmbël as që ka, përveç vdekjes.

- Tink- tink-tink! Një zile përtej, ciu-ciu! Një shpesh nëpër gjumë, fësh-fësh, era nëpër fletë.

Edhe Kirololoi si rusp'i bukur, aty pranë.

Foli trimi:

- Atje ku jam unë, muaji maj s'ka të sosur, jargavani s'e shkund lulen, shpesi s'ka të ikur. Atje jo vetëm dheri, po edhe qielli është yni, ngjitemi e zbresim mbi krahë fluturash të bardha, vemë e vijnë e gazi s'ka të sosur, në jetën e jetës!

Foli vasha:

- Nuk e di si është atje, o im zot, se as syri më ka parë, as këmba më ka shkelur. Po se ma thua ti, s'ka se qysh mos të jetë e bukur. Dhe unë...

Në atë çast ku vendosej jeta për këtej a për andej, më ç'u ngrit nga fletët një këngë shpesi kaq e ëmbël, kaq zotëronjëse, sa edhe vetë Kirololoi që kish dëgjuar shpeshët-mjeshtër, përtej, mbajti veshin edhe dëgjoji.

Rinë- Katerinëza duke dëgjuar filomelën, hodhi një sy nga varri i hapur, ku duhej të hynte së bashku me Kiroloin, për të zbritur tej, shërëmtiu sa kumboi vendi i gjithë edhe iu afrua më fort kurmit të të zot.

Ish e ngrohtë nata e muajit maj, po më i ngrohtë kurmi i Rinë Katerinëzës.

Shkopsiti gjirin që ta rrahë era.

Dhe çudi e zotit ish gjiri i saj.

Erë ftoi e mjaltë blete!

Iu derdhën flokëzat mbi supe. Flokëza të arta mbi supe si bora.

U drodh Kirololoi, i vdekuri nga kaq bukuri. Anoi kryet e puthi flokët, mbeti pastaj i mekur midis dy botësh.

-Përse dridhesh ftujëz e bardhë?

-Nga e ftohta, o im zot.

Po e ftohta që e bënte vashën të dridhej nuk ish tjetër, po e ftoht' e varrit të hapur. E si i pushtoi mesin me krahn' e majtë, e si i anoi kryet në kraharuar, i foli:

- Për këtu ta lidhim besën, o im zot!

Dhe u ngrit edhe lidhën besën, aty ne varri i s'ëmës, ndënë dritën e zonjës Hënë.

E askush s' duhej të dinte besën e martesës së tyre!

Kjo ishte e lidhura që lidhen.

Dora e së vdekurës u këmbëu unazat.

Filomela u këndoi mbi krye.

Zonja Hënë u dëshmoi bashkimin.

Dhe kur zonja Hënë u dëshmonte bashkimin për jetën e jetës, Rinë-Katerinëza më t'u gjend e veshur me ncilonë nusërie, me linjë të lindë e me krahët të mëndafshtë.

Trëndafil të bardhë mban në krye.

Me ar e me argjend ish qëndisur krez' e saj, me ar e me argjend krahët, me ar e me argjend ncilona.

E gjelbër është fleta e dhrizës, i gjelbër është bari i prillit, po më i gjelbër villusi i krezës së Rinë-Katerinëzës

Dhe ish e bukur si më e bukura Fatë.

Dhe mbetën burrë e grua; ajo e gjallë, ai i vdekur...

E më s'kish helm Rinë-Katerinëza!

As fjala e njerks-nepërkë nuk e bënte të lotojë. Se shpirtin e kish plot me gazin e netëve të Kiroloit.

*Për pyetjet 1-7 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

1. Vetë Kuteli, këtë krijim e quante:

1 pikë

A) tregim. B) ngjarje. C) rrëfenjë. D) përrallë.

2. Midis ngjarjes dhe lexuesit, autori luan rolin e:

1 pikë

A) rrëfyesit. B) konstatuesit. C) vlerësuesit. D) ndërmjetësit.

3. Informacioni që na jep pyetja retorike "Si të ndahesh nga kjo botë?", shpreh:

1 pikë

A) dëshirën e Rinës për të qenë në botën tjetër.
B) dilemën e saj për të zgjedhur midis dy botëve.
C) pendesën për fjalën që i kishte dhënë Kiroloit.
D) aftësinë për të gjykuar bukurinë e natyrës.

4. Çfarë ideje të krijon koha artistike e rrëfimit?

1 pikë

A) Idenë e së ardhmes. B) Idenë e tejkohësisë.
C) Idenë e së shkuarës. D) Idenë e të sotmes.

5. Subjekti i kësaj proze, ka në qendër mjedisin:

1 pikë

A) e një bote tjetër. B) e fshatit shqiptar.
C) e një vendi të huaj. D) e një familjeje shqiptare.

6. Lidhja e veçantë që krijohet midis Rinës e Kiroloit (midis të gjallit dhe të vdekurit), ngjason më shumë me lidhjen midis personazheve:

1 pikë

A) Kostandin dhe Doruntinë. B) Halil dhe Tanushë.
C) Helenë dhe Parid. D) Romeo dhe Zhuljetë.

7. Dëshmitarët që marrin pjesë në martesën e Rinës me Kiroloin, janë:

1 pikë

A) udhëtarët e natës. B) të gjallët dhe të vdekurit.
C) të afërmit e Rinës. D) Zonja Hënë dhe mëma.

8. Kuteli na jep informacion për gjendjen shpirtërore të Rinës. Ndër të tjera edhe që ishte e menduar. Shkruaj dy arsye pse Rina rrinte e menduar. **2 pikë**

9. Kirolloi i drejtohet Rinës me shumë kujdes dhe dashuri. Gjej dy shprehje, të cilat shërbejnë si provë e dashurisë dhe kujdesit të Kirolloit ndaj saj. **2 pikë**

a) _____

b) _____

10. Shiko me vëmendje fragmentin nga: “*në atë çast ku vendosej jeta*”, deri te “*Zonja Hënë u dëshmoi bashkimin*”. Cili është detaji më i rëndësishëm këtu?

Pas kësaj, mendo dhe shkruaj një titull vetëm për këtë pjesë. **2 pikë**

a) _____

b) _____

11. Kuteli konsiderohet si shkrimtar që u mbështet dhe e shfrytëzoi mjaft folklorin.

Gjej tri elemente folklorikë që autori ka përdorur në këtë fragment. **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

12. Muaji maj është shoqëruar i gjithë ngjarjes. Në ç’mënyrë autori na jep lidhjen midis muajit maj dhe Rinës? Jep një shembull për këtë. **2 pikë**

13. Studiuesi rus, Vladimir Prop përcaktoi 31 funksione të përrallave. Kujto të paktën dy prej tyre dhe i shpjego ato. **4 pikë**

Funksioni:

a) _____; b) _____;

Përshkrimi:

a) _____

b) _____

Çelësi i përgjigjeve:**Rinë Katerinëzë**

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë

Pyetja 8 2 pikë

- Rina e kishte të vështirë të vendoste, për kërkesën e Kiroloit, ishte në dilemë.
- Ajo nuk kishte informacion për botën tjetër.
- Joshej nga përshkrimi i Kiroloit.
- Ishte e dashuruar.
- Nuk kuptonte ndryshimin midis dy botëve.
- I vinte keq të largohej nga kjo botë (bukuria e Majit).

1 pikë Nëse trajton vetëm bukurinë e kësaj bote, vetëm dilemën e Rinës ose nëse trajton vetëm dashurinë e saj.

0 pikë Nëse shpjegon gabim gjendjen e Rinës.

Pyetja 9 2 pikë

- 9/a** - Vasha ime
- 9/b** - Ftujza ime, ftujzë e bardhë
- 1 pikë** Kur thotë njëren prej tyre
- 0 pikë** Kur nuk gjen asnjëren.

Pyetja 10 2 pikë

- 10/a** Detaji i rëndësishëm: martesë, lidhja e besës, bashkimi, këmbimi i unazave,
- 10/b** Titulli të japë idenë e martesës, bashkimit, këmbimit të unazave,
- 1 pikë** Kur thotë vetëm detajin ose vetëm titullin.
- 0 pikë** Kur jep përgjigje të gabuar(p. sh bukuria e Rinës, ndryshimi midis dy botëve,etj).

Pyetja 11 3 pikë.

- 11/a** - Motivi i dashurisë.
- Motivi i të vdekurit që martohet me të gjallin.
- 11/b** - Fjalori popullor(emrat e personazheve; vashë, trim,shprehjet ftujza ime)
- Tradita shqiptare (lidhja e besës, dëshmitarët në martesë, roli i nënës, figuracioni ; epitetet, krahasimet, përshkrimi i bukurisë hyjnore të Rinës, paralelizmi me bukurinë e natyrës)etj.
- 11/c** - Llojin e prozës, quhet rrëfenjë dhe elemente të rrëfenjës;formulat klishe, ku futen nisja e frazës me lidhëza(dhe ish e bukur), hëna si shoqëruese, filomela- zogu që këndon, biseda e të gjallit me të vdekurin, figura e njerks së keqe.
- 3 pikë .** Nxënësi i merr pikët e plota nëse thotë për secilin variant nga një mundësi.
- 2 pikë** Nëse nxënësi thotë nga një mundësi për dy nga kërkesat.
- 1 pikë** Nëse i përgjigjet vetëm njëres kërkesë.

0 pikë Nëse jep përgjigjet, të cilat nuk afrojnë me mundësitë e kërkesave.

Pyetja 12 2 pikë

- Lidhja midis Rinës dhe muajit maj jepet nëpërmjet paralelizmit; natyrë-vashë. Në maj lulëzon natyra, në maj lind dashuria e Rinës.

- Shembulli; ish e ngrohtë nata e muajit maj, por më i ngrohtë kurmi i Rinës.

1 pikë Kur gjen vetëm lidhjen, jep ngjashmërinë, paralelizmin ose vetëm shembullin

0 pikë Kur nuk përgjigjet fare, ose kur jep përgjigje të tjera.

Pyetja 13 4 pikë

Për përgjigjet e kësaj pyetjeje referoju faqes 130 – 131 në rubrikën “Zgjeroni më tej njohuritë tuaja” ku bëhet fjalë për funksionet narrative të përrallave sipas V. Prop

Pyetja 14 8 pikë

13/a Shtjellimi i idesë 2 pikë . Duhet të kihet parasysht:

- Fokusimi në temë (të jetë mbyllje rrëfenje ose përralle, të jenë po ato personazhe dhe ajo temë, por përzgjedhja e mbylljes është e lirë).

- Ruajtja e motiveve të martesës, dashurisë, vdekjes, bashkimit, ndarjes, përjetësisë, etj.

- Renditja e ideve, përshtatja me qëllimin.(fundi t’i shkojë për shtat vetë rrëfenjës, nëse flitet për dy të rinj dhe në fund të flitet përsëri për ta).

1 pikë. Kur jep mbyllje duke ndjekur logjikën e rrëfenjës.

0 pikë. Kur shkruan diçka që nuk ka lidhje me çfarë është thënë më lart.

13/b Organizimi dhe struktura 2 pikë . Duhet të kihet parasysht:

- Pjesët përbërëse(mbyllje e qartë).

- Kronologjia(në këtë rast mbyllja të realizohet pas hyrjes dhe zhvillimit që ka dhënë autori).

- Logjika(të ketë lidhja me çfarë është thënë më lart).

- Kalimet e kuptimshme (edhe nëse mbyllja është ndryshe nga ajo e autorit, duhet të lidhet me pjesën më lart).

- Përzgjedhja(mbyllja të jetë e pranueshme).

1 pikë. Kur jep një mbyllje të çfarëdoshme, të lexueshme dhe të pranueshme.

0 pikë. Kur fundi nuk ka lidhje me ngjarjen.

13/c Stili dhe origjinaliteti. 2 pikë. Duhet të kihet parasysht:

- Shprehjet origjinale (figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).

- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues. (me rrjedhshmëri , të ketë efekt)

- I qartë.

- Jo imitues,(të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij).

1 pikë . Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.

0 pikë . Kur nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

13/d Saktësia gjuhësore(sintaksa dhe drejtshkrimi). 2 pikë. Duhet të kihet parasysht:

- Trajta e duhur e fjalëve.

- Fjali të sakta.

- Shenjat e pikësimit.

- Shkronja e madhe.

1 pikë. Kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.

0 pikë. Kur gabimet e shumta deformojnë, ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

Ndërtimi dhe vlerësimi i portofolit të të nxënës

Portofoli është një nga përbërësit kryesorë të procesit të të nxënës dhe planifikimit të kurrikulës në arsimin bazë dhe atë të mesëm. Në këtë këndvështrim merr një rëndësi puna për ndërtimin dhe vlerësimin e tij.

Në tekstin e nxënësit për lëndën “Letërsia me zgjedhje 12”, janë dhënë disa detyra për portofolin e të nxënës të cilat plotësojnë arritjen e kompetencave dhe rezultateve të të nxënës në këtë lëndë.

Mësuesi është i lire të zgjedhë nga këto punë për t’i vlerësuar nxënësit ose mund të krijojë dhe zhvillojë detyra portofoli më krijuese apo më të përshtatshme, nisur nga niveli i klasës, interesi i nxënësve, mundësia e realizimit etj.

Mbështetur në detyrat e dhëna në tekst po japim modelin e ndërtimit të portofolit të të nxënës sipas tremujorëve.

Tremujori i parë:

Nr.	Detyra për portofol	Vlerësimi me pikë	Treguesit e kriterëve
1.	Mbledhja e folklorit – faqe 10	40 pikë	a) Realizimi i detyrës sipas të gjitha kërkesave dhe kriterëve të vendosura: - 20 pikë
			b) Respektimi i etikës dhe profesionalizmi në realizimin e detyrës: - 5 pikë
			c) Dorëzimi i detyrës në kohën e përcaktuar: - 5 pikë
			d) Realizimi i shkrimit reflektues për ndikimin e detyrës: - 10 pikë
2.	Ese krahasim-kontrasti – faqe 15 ose Ese përshkruese – faqe 36	30 pikë	Argumenti – 10 pikë
			Struktura – 3 pikë
			Pasuria gjuhësore – 6 pikë
			Larmia sintaksore – 6 pikë
			Saktësia drejtshkrimore – 5 pikë
3.	Ese shpjeguese – faqe 53	30 pikë	Argumenti – 10 pikë
			Struktura – 3 pikë
			Pasuria gjuhësore – 6 pikë
			Larmia sintaksore – 6 pikë
			Saktësia drejtshkrimore – 5 pikë
Totali i pikëve		100	

Konvertimi i pikëve në nota¹:

NOTA	4	5	6	7	8	9	10
PIKËT	0 – 24	25 – 44	45 – 54	55 – 64	65 – 74	75 – 84	85 – 100

¹ Kjo është vetëm një tabelë orientuese, pasi mësuesi mund të zgjedhë vetë se çfarë sistemi vlerësimi mund të përdorë.

TEST, TREMUJORI I TRETË DHE ÇELËSI I ZGJIDHJES SË TIJ

Tremujori i dytë:

Nr.	Detyra për portofol	Vlerësimi me pikë	Treguesit e kriterëve
1.	Ese-koment – faqe 59 ose Imazhi poetik i poezisë së Dritëro Agollit – faqe 64	50 pikë	a) Realizimi i detyrës sipas të gjitha kërkesave dhe kriterëve të vendosura: - 15 pikë
			b) Originaliteti në trajnimin e tematikës: - 10 pikë
			c) Dorëzimi i detyrës në kohën e përcaktuar: - 5 pikë
			d) Realizimi i me shkrim i detyrës (esesë/ krijimit/ produktit) sipas të gjitha kriterëve të hartimit të një eseje: - 20 pikë
2.	Shkrimi në prozë i këngës së “Gjino Vakut” - faqe 89	20 pikë	Rrëfimi dhe përmbajtja – 6 pikë
			Stili dhe origjinaliteti – 3 pikë
			Ruajtja dhe realizimi i dialogut – 3 pikë
			Përshtatja gjuhësore në gjuhën standarde – 5 pikë
			Saktësia drejtshkrimore – 3 pikë
3.	Ese argumentuese – faqe 100	30 pikë	Argumenti – 10 pikë
			Struktura – 3 pikë
			Pasuria gjuhësore – 6 pikë
			Larmia sintaksore – 6 pikë
			Saktësia drejtshkrimore – 5 pikë
Totali i pikëve		100	

Konvertimi i pikëve në nota:

NOTA		4	5	6	7	8	9	10
PIKËT		0 – 24	25 – 44	45 – 54	55 – 64	65 – 74	75 – 84	85 – 100

Tremujori i tretë:

Nr.	Detyra për portofol	Vlerësimi me pikë	Treguesit e kriterëve
1.	Analiza e përrallës sipas funksioneve të Prop – faqe 136	50 pikë	a) Realizimi i detyrës sipas të gjitha kërkesave dhe kriterëve të vendosura: - 15 pikë
			b) Originaliteti në trajnimin e tematikës: - 10 pikë
			c) Dorëzimi i detyrës në kohën e përcaktuar: - 5 pikë
			d) Realizimi i me shkrim i detyrës (esesë/ krijimit/ produktit) sipas të gjitha kriterëve të hartimit të një eseje: - 20 pikë
2.	Ese përshkuese – faqe 147	30 pikë	Argumenti – 10 pikë
			Struktura – 3 pikë
			Pasuria gjuhësore – 6 pikë
			Larmia sintaksore – 6 pikë
			Saktësia drejtshkrimore – 5 pikë
Totali i pikëve		100	

Projekti lëndor i paraqitur në tremujorin e parë do të vlerësohet me 100 pikë sipas kriterëve që janë dhënë.

Kritere për vlerësimin e punës për projektin

NR.	ELEMENTËT E VLERËSIMIT	PIKËT	VLERËSIMI
	Tema e projektit:	100 PIKË	
1.	MATERIALI	20 PIKË	
	a) Përfshirja e të gjitha çështjeve sipas ndarjes së punës në grup	(5 pikë)	
	b) Materiali i përbashkët për secilin grup	(5 pikë)	
	c) Materiali i origjinal i punës në grup	(5 pikë)	
	d) Material i veçantë (special,dokumente,krijime,foto etj,)	(5 pikë)	
2.	PUNA ME MATERIALIN	25 PIKË	
	a) Përpunimi i materialeve të mbledhura	(7 pikë)	
	b) Puna individuale e çdo nxënësi	(6 pikë)	
	c) Përgatitja e veshjeve, skenës, këngëve, maskave	(6 pikë)	
	d) Redaktimi letrar	(4 pikë)	
	e) Redaktimi gjuhësor	(2 pikë)	
3.	PARAQITJA SKENIKE	40 PIKË	
	a) Skenari	(10 pikë)	
	b) Skenografia	(10 pikë)	
	c) Interpretimi	(10 pikë)	
	d) Koreografia	(10 pikë)	
4.	PUNA NË GRUP	15 PIKË	
	a) Pasqyrimi i detajuar i punës së grupit	(5 pikë)	
	b) Ndarja e punës në grupe	(5 pikë)	
	c) Gjithëpërfshirja	(5 pikë)	

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të përfshijë vlerësimin e detyrave të portofolit si edhe vlerësimin e projektit kështu vlerësimi përfundimtar i nxënësit për portofolin do të jetë si më poshtë:

Tremujori i parë dhe i dytë do të kenë vetëm vlerësimin e detyrave të dhëna, kurse në tremujorin e tretë, vlerësimi do të përmbledhë totalin e pikëve të detyrave për portofol si edhe totalin e pikëve të projektit sipas tabelës së konvertimit në nota.

Konvertimi i pikëve në nota:

NOTA	4	5	6	7	8	9	10
PIKËT	0 – 24	25 – 44	45 – 54	55 – 64	65 – 74	75 – 84	85 – 100

Për vlerësimin e nxënësve mund të përdoren kriteret të ndryshme, por në tabelën e mëposhtme, sugjerohet një model vlerësimi.

Pikët ose vlerësimi me shprehje / Nota	Përshkrimi i rezultateve të arritjes
Shumë mirë / 9 -10	<ul style="list-style-type: none"> Jep shembuj specifike në diskutimet në klasë; Sjell shembuj të krijimeve të ndryshme folklorike në klasë; Gjen tiparet dalluese të një krijimi folklorik; Realizon gjatë orës së mësimi detyrën e klasës me shkrim;
Mirë / 7 – 8	<ul style="list-style-type: none"> Ndihmon me të paktën një shembull në diskutim në klasë; Jep të paktën një citim të përshtatshëm për fletën e veprimtarisë; Përfundon veprimtarinë me shkrim në klasë;
Mjaftueshëm / 5 -6	<ul style="list-style-type: none"> Merr pjesë në diskutimin në klasë duke u përpjekur të japë mendimin e vet për temën dhe diskutimin; Citimet nga teksti në fletën e veprimtarisë nuk janë të përshtatshme dhe nuk mbështetin temën e përcaktuar;
Dobët / 4	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ndihmon me shembuj në diskutimet dhe nuk merr pjesë në zhvillimin e procesit të të nxënit;